



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË

2017-2021

Prishtinë, korrik 2016

Parathënie



Është hera e dytë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) harton një plan strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin e arsimit në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit në periudhën 2017-2021, në mënyrë që arsimi të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Si i tillë, Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 paraqet vazhdimësi të planit aktual, PSAK 2011-2016, i cili tani ka hyrë në vitin e fundit të zbatimit të tij. Vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016 ka qenë pikënisja e planifikimit të ri për periudhën

5-vjeçare vijuese, sepse kemi konsideruar se duhet t'i marrim parasysht sukseset që janë arritur gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, por edhe të nxjerrim mësim nga dështimet.

Jo rastësisht, fjalë kyçe të planit të ri strategjik janë: *gjithëpërfshirja, cilësia dhe llogaridhënia*.

Gjithëpërfshirja ka qenë në qendër të vëmendjes të PSAK-ut 2011-2016 dhe, në këtë fushë, janë arritur suksese të pamohueshme. Kosova mund të krahasohet me secilin vend të rajonit, madje edhe me shumë vende të zhvilluara evropiane, në aspektin e përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Megjithatë, gjatë pesë viteve të ardhshme do ta punojmë që të përmirësohet përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor, pasi kjo është periudhë jetësore shumë e rëndësishme për zhvillimin e personalitetit. Pastaj, do të punojmë që të shtohet përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe e pjesëtarëve të grupeve shoqërore të marginalizuara, siç janë: të varfëritë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.

Ne kemi obligim të ndërtojmë një sistem arsimor që ofron *cilësi*, sepse duam që Kosova të jetë një shoqëri e cila zhvillimin e vet e bazon në dije, ndërsa qytetarët e saj të posedojnë njohuri dhe shkathtësi që i bëjnë të punësueshëm, si në vend ashtu edhe jashtë tij. Përmes cilësisë ne e zhvillojmë ekonominë tonë, krijojmë vende pune dhe, në përgjithësi, bëhemi konkurrentë në rajon dhe në botën globale. Prandaj, duhet të fillojmë zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, t'i pajisim shkollat me teknologji të informacionit dhe mjete të konkretizimit, ta përmirësojmë cilësinë e teksteve mësimore dhe, mbi të gjitha, ta përmirësojmë cilësinë e mësimdhënies në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Ndërkaq, në arsimin e lartë do t'i fuqizojmë mekanizmat e sigurimit të cilësisë, duke i zbatuar me përpikëri kriteret dhe procedurat e akreditimit, por edhe duke i ndihmuar institucionet e arsimit të lartë që t'i përbushin standardet e cilësisë.

Funksionimi i *llogaridhënies* është parakusht për mirëfunksionimin e sistemit të arsimit. Përderisa MASHT-i është përgjegjës për ndërtimin e politikave, kurrikula, inspektim dhe, në përgjithësi, për krijimin e kushteve optimale për punë në shkollë, komunat janë përgjegjëse për performancën e shkollave. Ndërkaq, shkolla dhe personeli i saj janë përgjegjëse, para komunitetit, për suksesin e fëmijëve. Prandaj, bashkë me komunat do të ndërtojmë një sistem i cili ofron llogaridhënie funksionale në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit, duke përfshirë përmirësimin e menaxhimit të shkollës, funksionalizimin e sistemit për licencimin e mësimdhënësve, vlerësimin e performancës së shkollës, si dhe rritjen e besueshmërisë së testeve kombëtare që kanë për qëllim vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve.

Ky dokument është rezultat i punës ekipore të udhëhequr nga MASHT-i, por me pjesëmarrje të gjerë të gjitha palëve me interes, si: autoritetet lokale, institucionet arsimore, partnerët zhvillimorë, organizatat e shoqërisë civile, e të tjerë. Të gjithëve u jemi shumë mirënjohës për kontributin e tyre. Një falënderim i veçantë i takon Projektit të GiZ për Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin Themelor (GIZ-CDBE), kompanisë gjermane PEM dhe Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) që kanë mbështetur procesin e planifikimit nga fillimi deri në përfundimin e tij të suksesshëm.

Prishtinë, korrik 2016

Prof. Dr. Arsim Bajrami, *ministër*

Falënderime

MAShT dëshiron të shpreh mirënjohje për Projektin e GIZ për Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin Themelor (GIZ-CDBE) i cili mbështeti hartimin e këtij dokumenti; për kontributin e Grupit Bërthamë të MAShT-it, të anëtarëve të Grupit Plenar dhe të anëtarëve të grupeve punuese, për kontributin e partnerëve zhvillimorë, si dhe të shumë palëve të tjera që i kushtuan kohë dhe energji zhvillimit të strategjisë; si dhe për punën e zellshme të ekipit PEM-KEC, të cilët kanë mbështetur të gjithë procesin. Po ashtu, MAShT shpreh mirënjohje për mbështetjen nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”, i cili ka mbështetur me ekspertizë punën e dy grupeve punuese në kuadër të procesit të zhvillimit të strategjisë.

Lista e shkurtesave

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AD	Arsimi në Diasporë
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AL	Arsimi i Lartë
ANV	Arsimi me nevoja të veçanta
ARr	Arsimi për të Rritur
ASVPRr	Agjencia për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet e Rregulluara
DKA	Drejtoritë Komunale për Arsim
Dh&T	Dhunti dhe Talente
ENQA	Asociacioni Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsim të Lartë
EPMPB	Ekipet për reagim ndaj mos regjistrimit dhe parandalim të braktisjes
FE	Fakulteti i Edukimit
GIS	Sistemi i Informatave Gjeografike
GIZ-CDBE	Projekti i GIZ-it për Ndërtim të Kapaciteteve në Arsimin Fillor
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
ISCED	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
KAAPARr	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE	Këshillat e Etikës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KI	Këshillat Industrial
KKK	Korniza e Kurrikulit të Kosovës
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KZh	Kërkimi Shkencor
LLL	Mësimi gjatë gjithë jetës
M&E	Monitorimi dhe Vlerësimi
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MC	Menaxhimi i Cilësisë
MF	Ministria e Financave
MH	Moshat e hershme
MM	Materialet mësimore
MP	Marrëveshja e Performancës
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim
N/A	Jo valid
PEST	Politikë, Ekonomikë, Social, dhe Teknikë
PIA	Plani Individual për Arsim
PKSh	Programi Kombëtar i Shkencës
PKZh	Programi Kombëtar për Zhvillim
OS	Objektiv strategjik

PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
PZhSh	Plan Zhvillimor i Shkollës
QeK	Qendrat e Kompetencës
QeK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QNS	Qasja Ndër-Sektoriale
QZhSh	Qendra për Zhvillim të Karrierës
SA	Stafi akademik
SC	Sigurimi i Cilësisë
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SMIAL	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim të Lartë
SP	Standardet e Profesionit
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, dhe Rreziqet
SHITP	Shërbimi për Informatat e Tregut të Punës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TP	Tregu i Punës
TP	Treguesit e Performancës
UA	Udhëzim Administrativ
UD	Udhëheqësit e Departamenteve
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Përmbledhja ekzekutive

Ky plan strategjik është dokumenti bazë për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë në periudhën 2017-2021. Procesi i zhvillimit të këtij dokumenti filloi në qershorin e vitit 2015 kur u formua struktura organizative për hartimin e planit të ri strategjik e përbërë nga tri nivele: Grupi Bërthamë, Grupi Plenar dhe nëngrupet tematike.

Vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016 dhe analiza e gjendjes e bërë nga Grupi Bërthamë, me ndihmën e gjashtë nëngrupeve, ka qenë baza për planifikimin e ri pesëvjeçar. Procesi i planifikimit është organizuar në shtatë fusha tematike që mbulojnë të gjitha segmentet relevante të arsimit në Kosovë:

1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja,
2. Menaxhimi i sistemit arsimor,
3. Sigurimi i cilësisë,
4. Zhvillimi i mësimdhënësve,
5. Mësimdhënia dhe të nxënit,
6. Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve,
7. Arsimi i lartë.

PSAK ka shtatë objektiva strategjike, nga një për secilën fushë tematike. Më poshtë është dhënë nga një përmbledhje për secilin objektiv strategjik, ndërkaq në dokument është prezantuar zbërthimi i detajuar i tyre në rezultate dhe aktivitete të mundshme:

Objektivi Strategjik/OS 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

Rritja e gjithëpërfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim kërkojnë kohë dhe nuk mund të arrihen pa zbatimin e plotë të kornizës ligjore. Prandaj, ky objektiv strategjik ka lidhje të qarta me aspekte të tjera të PSAK-ut, në veçanti me krijimin e një sistemi të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave që gjithashtu do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët që braktisin shkollën, si dhe me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si përmes ofrimit të programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, ashtu edhe përmes zbatimit të ideve dhe qëllimeve themelore të KKK-së.

Objektivi Strategjik/OS 2: Menaxhimi i sistemit arsimor

Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

Në rrethanat kur sistemi i arsimit është i decentralizuar, përveç ekzistimit të autonomisë së plotë financiare dhe profesionale, avancimet në arsim varen, kryesisht, nga zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese në nivelin qendror, komunal dhe të shkollës. Në kuadër të decentralizimit, ngritja e kapaciteteve në nivel lokal/nivel të shkollës duhet të shtrihet në organe të tilla si këshillat drejtues të shkollës, të cilat duhet të luajnë një rol kyç në këtë proces.

Objektivi Strategjik/OS 3: Sigurimi i Cilësisë (SC)

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përveç krijimit të një sistemi të menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimit të proceseve dhe mjeteve përkatëse, ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet do të jetë e nevojshme për ta funksionalizuar çfarëdo sistemi të ri të sigurimit të cilësisë. Për më tepër, në klimën e tanishme në Kosovë, gjithashtu

do të jenë të nevojshme edhe aktivitetet e vetëdijesimit që krijojnë një mjedis ku promovohet llogaridhënia.

Objektivi Strategjik/ OS 4: Zhvillimi i mësimdhënësve

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Fokusi kryesor në këtë fushë është që të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, i cili do të kontribuojë në zbatimin e reformës së shkollave dhe të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

Objektivi Strategjik/ OS 5: Mësimdhënia dhe të nxënit

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.

Zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat shihet si diçka thelbësore për përmirësimin e cilësisë së të nxënit në Kosovë. Përveç trajnimit të mësimdhënësve, kjo kërkon përgatitjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore, përfshirë materialet elektronike mësimore që janë në harmoni me KKK-në. Kjo, gjithashtu, supozon se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet furnizimit të shkollave me pajisjet e TIK-ut, si dhe me mjete të tjera mësimore.

Objektivi Strategjik/ OS 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimit për të Rritur (ARr)

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

Fokusi do të jetë në përmirësimin e ndërlidhjes së programeve shkollore me nevojat e tregut të punës, në zhvillimin e një kurrikule bërthamë të veçantë të AAP-së, e harmonizuar me KKK-në, në sigurimin sistematik të përvojës së punës dhe të praktikës profesionale të cilësisë lartë, dhe, që është specifike për kontekstin e Kosovës, në sigurimin e qëndrueshmërisë së Qendrave të Kompetencës dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Objektivi Strategjik/ OS 7: Arsimi i Lartë (AL)

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Prioriteti kryesor në këtë fushë është përmirësimi i cilësisë në institucionet e AL. Kjo ka shumë aspekte, duke përfshirë përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, nxitjen e hulumtimit shkencor, si dhe ofrimi i ndihmës në punë artistike dhe inovacione në institucionet e AL. Gjithashtu, vëmendje do t'i kushtohet cilësisë së mësimdhënies dhe nevojës për të rritur mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, si dhe pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të AL dhe të hulumtimit shkencor.

Për secilin objektivi strategjik është zhvilluar një plan veprimi, si dhe treguesit e suksesit që shërbejnë për monitorimin e zbatimit të PSAK-ut. Planet e veprimit janë përmbledhur në një udhërrëfyes për zbatimin e PSAK-ut. Po ashtu, është kalkuluar buxheti i PSAK-ut, i cili kap shumën e përgjithshme prej €176.94 mil.

Përmbajtja

PARATHËNIE	2
FALËNDERIME	3
LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	9
1.1. PLANIFIKIMI STRATEGJIK NË ARSIM	9
1.2. NDËRLIDHJA E PSAK-UT ME POLITIKAT DHE INICIATIVAT TJERA	9
2. METODOLOGJIA	13
3. KONTEKSTI	15
3.1. SFIDAT DHE MUNDËSITË NË MJEDISIN AKTUAL	15
3.1.1. Faktorët politikë	15
3.1.2. Faktorët ekonomikë	16
3.1.3. Faktorët socialë	16
3.1.4. Faktorët teknologjikë	17
3.3. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E SISTEMIT ARSIMOR	20
3.4. SFIDAT DHE MUNDËSITË NË ARSIMIN E KOSOVËS	22
3.4.1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	22
3.4.2. Menaxhimi i sistemit arsimor	23
3.4.4. Zhvillimi i mësimdhënësve	25
3.4.5. Mësimdhënia dhe të nxënit	26
3.4.6. Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi i të Rriturve	27
3.4.7. Arsimi i lartë	28
3.5. FINANCIMI I ARSIMIT NË KOSOVË	31
3.6. INTERVENIMET KRYESORE NË FUSHËN E ARSIMIT	32
3.6.1. Programet që mbështesin përmirësimin e cilësisë së arsimit	32
3.6.2. Programet që mbështesin ndërlidhje efektive të arsimit me tregun e punës	33
3.6.3. Programet që synojnë grupet e marginalizuara	33
4. VIZIONI YNË, MISIONI YNË DHE VLERAT TONA	34
5. QASJA JONË STRATEGJIKE	36
5.1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË PSAK	37
5.2. ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA	40
6. OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PJESËMARRJA DHE GJITHËPËRFSHIRJA	42
7. OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MENAXHIMI I SISTEMIT ARSIMOR	51
8. OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: SIGURIMI I CILËSISË	62
9. OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: ZHVILLIMI I MËSIMDHËNËSVE	70
10. OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT	79
11. OBJEKTIVI STRATEGJIK 6: ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL (AAP) DHE ARSIMI I TË RRITURVE ..	84
12. OBJEKTIVI STRATEGJIK 7: ARSIMI I LARTË	93
13. ZBATIMI I PSAK	103
13.1. MEKANIZMAT PËR ZBATIM	103
13.2. UDHËRRËFYESI PËR ZBATIM	103
14. BUXHETI PËR ZBATIMIN E PSAK-UT	106

1. Hyrje

1.1. Planifikimi strategjik në arsim

Planifikimi strategjik në arsim është një fenomen relativisht i ri: realisht, vetëm në vitet e 90-ta ndodhi zhgënjimi me planifikimin tradicional, në veçanti nga mungesa e marrjes së përgjegjësisë dhe e përfshirjes së palëve kyçe, mungesa e përqendrimit në monitorim dhe vlerësim, dhe mungesa e fleksibilitetit në aspektin e zbatimit, e kombinuar me një konsideratë të pamjaftueshme për mjedisin në ndryshim e sipër, që çoi në zhvillimin e gjerë të asaj që quhet planifikim 'strategjik'. Planifikimi strategjik, në shumë vende në transicion, është ndërlidhur me futjen graduale në zbatim të Qasjes Mbarësektoriale (QMS) në bashkëpunimin zhvillimor që nga mesi i viteve të 90-ta e tutje.

Qasja e planifikimit strategjik përcaktohet nga UNESCO/INPA si më poshtë:

"Mjet i menaxhimit për të ndihmuar organizatën në përmirësimin e performancës së saj, duke siguruar që anëtarët e saj janë duke punuar për të njëjtat qëllime, dhe duke përshtatur vazhdimisht drejtimin e organizatës ndaj mjedisit ndryshues, në bazë të rezultateve të fituara".

Planifikimi efektiv strategjik kërkon një sens të përgjithshëm të drejtimit, nivel të lartë të vetëdijes sa i përket mjedisit, fokus në rezultate, të dhëna nga një gamë e gjerë e grupeve të interesit, mbikëqyrje të afërt dhe sistematike, si dhe fleksibilitet maksimal në përzgjedhjen e qasjes më të mirë për zbatim.

Planet e para gjithëpërfshirëse strategjike për arsim të hartuara në Kosovë ishin Strategjia e Arsimit të Lartë 2005-2015 dhe Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017. Në vitin 2009, kur Kosova ka miratuar QMS në arsim, ishte vendosur që të ketë një plan gjithëpërfshirës dhe të veçantë për tërë sektorin e arsimit, gjë e cila çoi në zhvillimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016. Plani ishte zbatuar në mënyrë mjaft të suksesshme në fusha të caktuara, ndërsa në disa fusha tjera nuk janë arritur rezultatet e pritura. Këtë e dëshmon edhe Raporti i detajuar i Vlerësimit (nëntor 2015). Si procesi i zhvillimit të PSAK-ut 2017-2021, ashtu edhe dokumenti që rezulton më pas, kanë pasur mundësi të përfitojnë nga mësimet e nxjerra nga përvoja e zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të PSAK-ut 2011-2016. Në veçanti, tani kuptohet shumë më mirë rëndësia e integritetit të monitorimit, matjes dhe vlerësimit në kuadër të kornizës së objektivave, si dhe e një vlerësimi të shtuar për rolin e grupit të gjerë të aktorëve të përfshirë në arsim.

1.2. Ndërlidhja e PSAK-ut me politikat dhe iniciativat tjera

Përpyqje të konsiderueshme janë bërë për të siguruar që PSAK 2017- 2021 është në përputhje me politikat, iniciativat dhe strategjitë e tjera përkatëse (*Shih më poshtë skemën*). Në nivel kombëtar është konsideruar e domosdoshme për të harmonizuar PSAK-un 2017-2021 me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim¹, e cila është përgatitur nën udhëheqjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Ndërlidhja kryesore e PSAK-ut dhe SKZh-së realizohet përmes kapitullit të parë - Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor. Politikat kryesore që adreson ky kapitull i SKZh-së përfshijnë masat që kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, rritjen e kualifikimit dhe përgatitjen e mësimdhënësve, përmirësimin e relevancës së ofrimit të shkollimit për kërkesat e tregut të punës, si dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies përmes vlerësimit të performancës së

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës: Strategjia Kombëtare për Zhvillim (Janar 2016).

mësimdhënësve, inspektimit dhe testeve të jashtme. Një iniciativë tjetër e rëndësishme që është marrë parasysh ishte Programi Kombëtar për adaptimin e ACQUIS-it².

PSAK-u, gjithashtu, synon për të siguruar harmonizimin me prioritetet e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës³ në fushën e arsimit dhe shkencës:

- Reformat strukturore në arsim;
- Rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim;
- Sigurimi, garantimi dhe rritja e cilësisë së arsimit;
- Menaxhimi i institucioneve të arsimit (përfshirë decentralizimin e vendimmarrjes në arsim);
- Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve;
- Rritja e financimit të arsimit dhe shkencës;

Si pjesë e procesit të zhvillimit të PSAK-ut ka pasur edhe një përpjekje për ta lidhur në mënyrë sistematike me strategjitë e tjera të zhvilluara nga MASHT-i, duke përfshirë edhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar⁴, Strategjinë e Arsimit Gjithëpërfshirës, e cila është në fazën e miratimit, Udhëzuesin për zhvillimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes në shkollë dhe në sistemin e arsimit⁵ dhe Draft Strategjinë e orientimit dhe këshillimit në karrierë. Zhvillimi i PSAK ka marrë parasysh edhe punën e kryer nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional, dhe në zhvillimin e standardeve të profesionit, disa strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, si: Strategjia e Komunikimit, Strategjia për Praktikën Profesionale, Strategjia për Inovacion e Kosovës 2016-2020.

Për sa i përket dimensionit ndërkombëtar, PSAK-u përpaket të merr parasysh politikat dhe strategjitë përkatëse. Në përgjithësi, hartimi i PSAK-ut u realizua në kontekstin e katër objektivave të përbashkëta të BE-së për të trajtuar sfidat në sistemet e arsimit dhe aftësimit deri në vitin 2020, të detajuara në Arsimi dhe Aftësimi 2020 (ET 2020)⁶.

- Bërja realitet e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe aftësimit;
- Promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;
- Shtimi i kreativitetit dhe inovacionit, duke përfshirë ndërmarrësinë, në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit.

Prioritetet shtesë që rezultojnë nga aktivitetet e vitit 2014 të BE 2020 janë marrë po ashtu në konsideratë.

Agjendat sektoriale për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP), (Procesi i Kopenhagës-Bruzhit) dhe Agjenda e përtërirë evropiane për arsimimin e të rriturve (ARr) kërkojnë një identifikim më të detajuar të rezultateve/prioriteteve për periudhën deri në vitin 2020. Janë bërë përpjekje që PSAK-u të lidhet me to, në veçanti me Rezultatet Afat-Mesme të Rigas për AAP⁷, siç janë: promovimi i mësimi të bazuar në punë dhe në të gjitha format e saj, dhe zhvillimi i mëtejshëm i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në AAP në përputhje me rekomandimet e EQAVET.

²Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura & Kapitulli 25: Shkenca dhe hulumtim.

³Qeveria e Kosovës: Programi i qeverisë (2015).

⁴MASHT: Strategjia e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar, Prishtinë, dhjetor 2015.


⁵Udhëzuesi për diversitetin dhe inkluzionin në arsimin parauniversitar (Draft/2015).

⁶Korniza strategjike – Arsim dhe Aftësim 2020 (http://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/index_en.htm).

⁷http://ec.europa.eu/education/policy/vocational-policy/doc/2015-riga-conclusions_en.pdf.

Rekomandimet e tjera të politikave të BE-së janë të bazuara në rezultatet e raporteve të fundit nga rrjeti Eurydice⁸ dhe nga CRELL (Qendra e Komisionit Evropian për Kërkime mbi Arsimin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës)⁹, dhe këto gjithashtu janë marrë parasysh gjatë procesit të zhvillimit PSAK-ut.

Kuadri ligjor dhe politik si pikë referimi për kornizën teorike për PSAK-un 2017 - 2021



Procesi i zhvillimit të PSAK-ut ka reflektuar përcaktimin e BE-së për analiza të qëndrueshme dhe solide të bazuara në dëshmi, si elemente kyçe për diskutime politike të informuara dhe zhvillim të

⁸'Profesioni i Mësimdhënies në Evropë: Praktikët, Perceptimet dhe Politikët', Eurydice (2015).

⁹Praktikët e mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme në Evropë: Vështrime nga Vlerësimet e Shkallës së Madhe në Arsim', CRELL, 2014.

politikave në fushën e arsimit dhe aftësisë¹⁰. Për më tepër, janë marrë parasysh standardet evropiane që duhet të arrihen deri në vitin 2020¹¹:

- Të paktën 95% e fëmijëve (nga moshë 4 deri në moshën e shkollimit të obliguar) duhet të marrin pjesë në edukimin në fëmijëri dhe hershme;
- Më pak se 15% e 15 vjeçarëve duhet të jenë të nën-kualifikuar në lexim, matematikë dhe shkencë;
- Shkalla e personave të moshës 18-24 vjeç që braktisin arsimin dhe aftësimin, në fazë të hershme, duhet të jetë nën 10%;
- Të paktën 40% e njerëzve të moshës 30-34 vjeç duhet të kenë përfunduar një formë të arsimit të lartë;
- Të paktën 15% e të rriturve duhet të marrin pjesë në të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Të paktën 20% e të diplomuarve në arsim të lartë dhe 6% e 18-34 vjeçarëve me një kualifikim profesional fillestar duhet të ketë kaluar disa kohë në studime apo trajnime jashtë vendit;
- Përqindja e të diplomuarve të punësuar (të moshës 20-34 me arritje të paktën arsimit e mesëm të lartë dhe pas përfundimit të shkollimit 1-3 vjet më parë), duhet të jetë të paktën 82%.

Objektivat tjerë/treguesit me interes për ata që janë përgjegjës për zhvillimin e PSAK-ut kanë përfshirë ato që rrjedhin nga Arsimi për të Gjithë (AGj), iniciativë e përbashkët e organizatave si Banka Botërore dhe UNESCO, si dhe organizatave të propozuara nga shtetet anëtare të OKB-së për Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm¹² (QZhQ), (në veçanti, objektivi 4: Sigurimi i arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë), dhe Kornizën e Arsimit për Veprim (Arsimi 2030). Është marrë parasysh edhe tërësia e treguesve tematikë të zhvilluara nga Grupi Këshillimor Teknik i UNESCO-së¹³.

Së fundi, përgjegjësit për zhvillimin e PSAK-ut gjithashtu kishin parasysh rezultatet e pritura nga IPA II¹⁴, në veçanti shtimin e ndërlidhjes së programeve të arsimit dhe aftësisë me nevojat e tregut të punës, si dhe përmirësimin e përfshirjes së të dyjave, sektorit të arsimit dhe të tregut të punës.

¹⁰Politikat arsimore dhe trajnuese të bazuara në dëshmi, http://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/indicators-benchmarks_en.htm.

¹¹Evropa 2020 Treguesit arsimor (Eurostat).

¹²<http://www.un.org/sustainabledevelopment/education/>.

¹³Treguesit tematik për monitorimin e post-agjendës së arsimit 2015, Forumi Botëror i Arsimit 2015.

¹⁴IPA II – Dokumenti i Strategjisë Treguese për Kosovën 2014-2020, Komisioni Evropian, 2014.

2. Metodologjia

Procesi i zhvillimit të PSAK 2017-2021 filloi në qershorin e vitit 2015 kur MASHT-i inicioi vlerësimin e PSAK-ut 2011-2016 me ndihmën e projektit të Fondit të Bashkuar për Arsimin. Njëkohësisht, u formua struktura organizative për hartimin e planit të ri strategjik e përbërë nga tri nivele:

- Grupi Bërthamë që ishte përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të procesit dhe cilësinë e produktit final. Grupi përbëhej nga drejtorët e departamenteve të MASHT-it, këshilltarët nga kabineti i ministrit, një përfaqësues i Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe drejtohej nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.
- Grupi Plenar përbëhej nga anëtarët e Grupit Bërthamë dhe përfaqësues të tjerë të MASHT-it, komunat, bota akademike dhe shoqëria civile. Roli i këtij grupi ishte të sigurojë ndërlidhjen ndërmjet Grupit Bërthamë dhe nëngrupeve.
- Nëngrupet punuese– ishin gjithsej gjashtë nëngrupe që mbulonin shtatë fushat tematike të PSAK-ut të dhëna më poshtë. Anëtarët e nëngrupeve ishin ekspertë të fushës përkatëse nga MASHT-i, komunat, bota akademike, shoqëria civile dhe partnerët zhvillimorë.

Projekti i GiZ për Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin Bazik (GiZ CBDE) angazhoi konsorciumin e përbërë nga kompania gjermane PEM Consulting dhe OJQ-ja Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), për të ofruar ekspertizë gjatë procesit të zhvillimit të PSAK-ut. Puna rreth planifikimit filloi në fund të shtatorit të vitit 2015 me hartimin e një plani të zbatimit për vet procesin e planifikimit. Po ashtu, u konsultua legjislacioni për hartimin e dokumenteve strategjike, si dhe dokumentet tjera strategjike me të cilat duhej të ndërlidhej PSAK-u i ri.

Ky plan i zbatimit u aprovua në takimin e Grupit Bërthamë të dt. 18.11.2015. Në këtë takim, u mor vendimi që qasja në procesin e planifikimit të jetë tematike, që dallonte nga qasja nën-sektorale e cila u ndoq gjatë hartimit të PSAK-ut 2011-2016. Kështu, u identifikuan shtatë fusha tematike: 1) Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja; 2) Menaxhimi i sistemit arsimor; 3) Sigurimi i cilësisë; 4) Zhvillimi i mësimdhënësve; 5) Mësimdhënia dhe të nxëniet; 6) Arsimi profesional dhe arsimi i të rriturve; dhe 7) Arsimi i lartë.

Me të përfunduar të procesit të vlerësimit të PSAK-ut 2011-2016 dhe pas prezantimit të rezultateve të vlerësimit në konferencën e mbajtur më 26 nëntor 2015 u krijuan kushtet për të filluar me aktivitetet kryesore të planifikimit të PSAK-ut 2017-2021.

Nga janari 2016, procesi i zhvillimit të PSAK-ut 2017-2021 është mbështetur edhe nga projekti i financuar nga BE-ja “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”, i cili ofroi ekspertizë për punën e dy grupeve punuese për fushat tematike “Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja” dhe “Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi për të Rritur”.

Më poshtë po i prezantojmë hapat kryesorë të këtij procesi, në mënyrë kronologjike:

1. Analiza e gjendjes ishte një proces që u realizua përmes shfrytëzimit të metodave të planifikimit si SWOT dhe PEST. Po ashtu, u shfrytëzuan përfundimet e nxjerra nga vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016. Rezultati i analizës së gjendjes u përmbledh në një raport pune të hartuar nga Grupi Bërthamë.
2. Përcaktimi i vizionit, misionit dhe objektivave strategjikë. Pasi Grupi Bërthamë ra dakord rreth formulimit të vizionit për arsimin dhe formuloi misionin për arritjen e tij, për secilën nga shtatë

fushat tematike u përcaktua një objektiv strategjik. Objektivat strategjike u zbërthyen në rezultate të pritshme, ndërsa për secilin rezultat u definuan aktivitetet e mundshme, si dhe treguesit e suksesit. Për këtë qëllim u mbajtën dy punëtori të grupit bërthamë, dy punëtori të nëngrupeve dhe një e grupit plenar. Edhe rezultati i kësaj faze u përmbledh në një dokument të hartuar nga Grupi Bërthamë.

3. Hartimi i draftit të PSAK-ut u bë duke shfrytëzuar punën e bërë në dy fazat e para. Ky draft reflekton të gjitha ndryshimet që janë sugjeruar nga grupi bërthamë në përfundim të fazës së dytë të planifikimit.
4. Më 5 maj 2016 u mbajt një konferencë kombëtare ku u diskutua drafti i PSAK-ut. Mbi 100 pjesëmarrës që përfaqësonin të gjithë sektorët relevantë të qeverisë, institucionet arsimore, shoqërinë civile, partnerët zhvillimorë dhe palët tjera me interes dhanë vërejtjet dhe sugjerimet e veta në lidhje me dokumentin e PSAK-ut, të cilat u konsoliduan në një draft të ri nga grupi i ekspertëve.
5. Më 21 dhe 22 maj u mbajt një punëtori me Grupin Bërthamë, në përbërje të zgjeruar, ku u shqyrtuan komentet nga konferenca dhe u bënë ndryshimet e fundit në draftin e dokumentit të PSAK-ut, me përjashtim të ndryshimeve në fushën e arsimit dhe aftësisë profesionale të cilat u bënë dy javë më vonë, pas një punëtorie të veçantë të grupit të punës për këtë objektiv. Ndërkohë, u përfshinë në versionin e radhës edhe komentet e dhëna me shkrim nga OSBE dhe Këshilli i Evropës. Po ashtu, në këtë periudhë u finalizuan edhe treguesit e suksesit të cilët u diskutuan me Grupin Bërthamë dhe strukturat tjera brenda MASHT-it.
6. Procesi i planifikimit buxhetor u zhvillua gjatë qershorit të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe u organizuan dy punëtori planifikimi me pjesëmarrjen e Grupit Bërthamë në përbërje të zgjeruar. Paralelisht me këtë proces u hartua edhe plani i zbatimit të PSAK-ut për periudhën 2017-2021.
7. Versioni final i dokumentit të PSAK-ut u hartua gjatë korrikut të vitit 2016 në bazë të udhëzimeve të dhëna nga Grupi Bërthamë. Në këtë fazë u bënë disa shkurtime dhe riorganizime të pjesëve të dokumentit.

3. Konteksti

Ritmi i ndryshimeve me të cilat ballafaqohen të gjitha shoqëritë në shekullin XXI paraqet një sfidë të madhe për qeveritë dhe planifikuesit në të gjitha nivelet. Askund tjetër nuk është kjo më e vërtetë sesa në fushën e arsimit dhe të aftësimit që kanë përgjegjësi, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin humanitar, për të lehtësuar zhvillimin e qytetarëve. Nëse duam që sektori i arsimit dhe aftësimit të jetë në gjendje të ju përgjigjet në mënyrë efektive ndryshimeve të mjedisit, është e një rëndësie të jashtëzakonshme që ata të cilët udhëheqin me zhvillimin e strategjisë të kenë njohuri solide rreth kontekstit të jashtëm dhe të brendshëm në të cilin veprojnë.

Për këtë arsye, gjatë procesit të zhvillimit të PSAK-ut 2017-2021, vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar analizës së kontekstit për të cilin është përgatitur plani i ri.

3.1. Sfidat dhe mundësitë në mjedisin aktual

Analiza e faktorëve të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e PSAK-ut 2017-2021 nxori disa përfundime interesante. Gjatë diskutimeve në Grupin Bërthamë doli se pjesa më e madhe e faktorëve të identifikuar kanë ndikim mesatar ose të lartë në zbatimin e PSAK-ut. Grupi Bërthamë ka shfrytëzuar metodën PEST¹⁵, e cila identifikon për analizë faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë, ndërsa gjetjet kryesore të këtij diskutimi të cilat janë prezantuar në vijim, ofruan një sfond të dobishëm për diskutimet gjatë procesit të zhvillimit të PSAK-ut.

3.1.1. Faktorët politikë

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me BE-në për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, për shembull në, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe aftësinë e kufizuar. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të merr formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të PSAK-ut. Prandaj, ky Plan Strategjik do të jetë temë e konsultimeve të rregullta me BE-në dhe temë shqyrtimi i raporteve të progresit.

Vet zbatimi i PSAK-ut, në masë të madhe, varet nga kapaciteti zbatues i komunave, më saktësisht i drejtorive komunale të arsimit (DKA-ve). Me gjithë faktin se bartja e autorizimeve në fushën e arsimit nga niveli qendror në atë lokal ka ndodhur në vitet 2008 dhe 2009, deri sot nuk është arritur që të gjitha komunat të ndërtojnë kapacitetet e duhura për t'i përmbushur detyrimet e tyre në këtë fushë. Kjo ndikon në jetësimin e masave të PSAK-ut, pasi nuk është e mundur që të gjitha masat të zbatohen drejtpërdrejt nga MASHT-i, pa një mbështetje solide nga niveli komunal. Për më tepër, është me rëndësi të madhe të nxitet të kuptuarit e gjerë të faktit se kjo autonomi e rritur e nivelit lokal duhet të shoqërohet me rritjen e përgjegjshmërisë dhe me menaxhim të cilësisë. Për këtë arsye, PSAK-u përmban masa për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve në komuna.

Shkollat me mësim në gjuhën serbe në Kosovë vazhdojnë të operojnë jashtë sistemit kosovar të arsimit, përkundër faktit se legjislati aktual ofron mundësi të mëdha për akomodimin e nevojave specifike të komunitetit serb. Republika e Kosovës do t'i vazhdojë përpjekjet aktuale për integrimin e komunitetit serb me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë. Masat e PSAK-ut i përshtaten të gjitha

¹⁵Analiza PEST (faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë) shpjegon faktorët makro - mjedisor të përdorura në komponentin e skanimit mjedisor të menaxhimit strategjik.

komuniteteve, por nëse, në një fazë të mëvonshme, paraqitet nevoja për adresimin e çështjeve specifike që kanë të bëjnë me integrimin e komunitetit serb, MASHT-i do të bëj përpjekje t'i akomodojë ato në planet vjetore të veprimit.

Lëvizja e lirë brenda kufijve të Evropës është një mundësi për të rinjtë që kanë përfunduar shkollimin që të kërkojnë punë edhe jashtë kufijve të Kosovës. Meqë pritet që një lëvizje e tillë të mundësohet në të ardhmen e afërt, sistemi i arsimit duhet t'i përshtatet edhe kërkesave të tregut evropian të punës, duke u përqendruar në ngritjen e cilësisë, në mënyrë që të diplomuarit t'i përmbushin standardet e punëdhënësve nga vendet e BE-së.

3.1.2. Faktorët ekonomikë

Gjendja ekonomike në vend karakterizohet me ngecje në zhvillim ekonomik, e cila rezulton me pamundësi për të krijuar vende të reja pune. Nga ana tjetër, nevojat e tregut të punës mund të ndryshojnë shumë shpejtë. Pra, rëndësia e përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe aftësisë, e rritjes së nivelit të aftësive në mesin e shoqërisë, dhe e vënies së theksit të mjaftueshëm në mësimin gjatë gjithë jetës, nuk mund të nënvlerësohet.

Kushtet e vështira ekonomike-sociale në të cilat jeton një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Kosovës implikojnë disa shpenzime për adresimin e problemeve siç është furnizimi i të gjithë nxënësve me tekste shkollore falas për arsimin e obligueshëm që i kushton buxhetit të shtetit rreth 7 mil. EUR në vit; pastaj, subvencionimi i arsimit të lartë dhe banimit në konvikte përmes pagesave të ulëta që aplikohen. Nëse nuk ka përmirësim domethënës të gjendjes ekonomike, trendi i shpenzimeve të kësaj natyre, domosdo, do të vazhdojë, që do të thotë se do të ketë më pak mjete në dispozicion për zbatimin e PSAK-ut.

Sipas Bankës Botërore¹⁶, shpenzimet publike në arsim janë rritur në mënyrë domethënëse, nga 3.3% të BPV-së në vitin 2007 në 4.1% në vitin 2012. Pavarësisht nga kjo rritje, Kosova ende shpenzon më pak se mesatarja e vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore (4.6%) apo mesatarja e vendeve me të ardhura të mesme të larta (5%). Në mesin e vendeve të Evropës Juglindore, Kosova shpenzon më shumë se Shqipëria (3.3%) dhe Maqedonia (3.5%), por më pak se Kroacia (4.4%) dhe Serbia (4.7%). Vendet me popullsi më të re, si Kosova, kanë tendencë për të shpenzuar më shumë në arsim si përqindje e shpenzimeve totale publike se sa ato me popullsi të vjetër. Prandaj, është e dëshirueshme të bëhen përpjekje për shfrytëzim më efikas të burimeve në dispozicion, si dhe një rritje graduale e shpenzimeve në arsim, që janë në funksion të përmirësimit të sistemit të arsimit.

3.1.3. Faktorët socialë

Kosova është duke kaluar në një fazë të ndryshimeve të konsiderueshme demografike. Në bazë të projeksioneve të popullsisë, do të regjistrohet një rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve në nivelin fillor dhe të mesëm. Ulja e numrit të nxënësve do të ndikojë në uljen e numrit të paraleleve në shkolla, zvogëlim të nevojës për mësimdhënës dhe, potencialisht, edhe në zvogëlimin e numrit të shkollave. Në anën tjetër, lëvizja e popullsisë nga fshati në qytet do të shkaktojë ngarkesë më të madhe në shkollat urbane dhe numër të vogël të nxënësve sidomos në zona të largëta rurale. Këto ndryshime demografike ka të ngjarë të rezultojnë me nevojën për një racionalizim domethënës të rrjetit të shkollave dhe mund të imponojnë nevojën për rishikim të planifikimit gjatë periudhës së zbatimit të planit të ri strategjik.

¹⁶Grupi i Bankës Botërore: Country Snapshot-Kosovo. Prishtinë: Zyra e Bankës Botërore në Kosovë, 2015.
<http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

Nevoja për më shumë arsimim për të rritur dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, e theksuar më lartë në aspektin e kontekstit ekonomik, duhet të theksohet edhe në kontekstin social, ku niveli i dobët i arsimit dhe aftësimit është i lidhur drejtpërdrejtë me përjashtimin shoqëror për një numër të grupeve.

Në përgjithësi, imazhi i arsimit në sytë e qytetarëve nuk është i mirë, prandaj edhe janë shtuar kërkesat për cilësi në arsim. Kjo reflektohet në debatet publike dhe shkrimet kritike të mediave për cilësinë e arsimit. Meqë Kosova tani merr pjesë në provime ndërkombëtare (PISA) që lejojnë krahasimin me vende të tjera, mund të ndodhë që kërkesat për përmirësim të cilësisë së arsimit të shtrohen edhe në formën që reflekton mungesë mirëkuptimi për situatën në të cilën ndodhet vendi dhe sistemi i tij i arsimit. Sidoqoftë, kërkesat e tilla duhet të shihen si stimulim pozitiv për të zbatuar PSAK-un e ri, si dhe për të lëvizur me hapa më të shpejtuar drejt përmirësimit të gjendjes.

Mashtrimi është dukuri negative që vërehet në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit në Kosovë. Brengos fakti se nxënësit dhe studentët bëjnë përpjekje për mashtruar në provime, duke shfrytëzuar edhe teknologjinë më bashkëkohore, ndërsa institucionet arsimore bëjnë përpjekje të pamjaftueshme që të ndalojnë këtë dukuri. Po ashtu, dënimi shoqëror që i bëhet kësaj dukurie është i pamjaftueshëm që ta identifikojë si veprim të palejueshëm. Është detyrë e sistemit të arsimit që të luftojë mashtrimin, por kjo nuk mund të bëhet pa mbështetje të përgjithshme shoqërore dhe qytetare për zbatim të rreptë dhe transparent të rregullave dhe procedurave. Prandaj, është me rëndësi të punohet edhe në ngritjen e vetëdijes për këtë çështje, duke siguruar kështu që rezultate e vlerësimit të japin pasqyrën reale të zotërimit të njohurive dhe shkathtësive nga ana e nxënësve dhe studentëve.

3.1.4. Faktorët teknologjikë

Në dhjetë vitet e fundit, infrastruktura rrugore në Kosovë është përmirësuar dukshëm, gjë e cila ka ndikuar në shkurtimin e kohës së udhëtimit nga shtëpia deri në shkollë. Me përmirësim të mëtutjeshme, mund edhe të pushojë arsyeja për ekzistimin e shumë shkollave që iu shërbejnë komuniteteve të vogla, të përbëra prej disa dhjetëra familjesh. Nëse kësaj i shtohet edhe rënia e natalitetit, atëherë mund të parashikohet se përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të sjellë deri tek riorganizimi i rrjetit të shkollave në disa komuna, që mund të kërkojë edhe investime shtesë.

Kosova është vend me shkallë të lartë të shfrytëzimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Sipas një raporti të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit në Kosovë (STIKK)¹⁷, vlerësohet se 76.6% e popullsisë së Kosovës janë përdorues të internetit, kryesisht për qëllime argëtuese. Kjo shkallë është në nivelin e vendeve të zhvilluara. Nga ana tjetër, në shkollat e Kosovës është një kompjuter për 46 nxënës, ndërkohë që 57% e personelit mësues janë të trajnuar për ECDL. Gjendja e tillë kërkon lëvizje më të shpejtë drejt aplikimit të TIK-ut në klasa, pasi e kundërta mund ta zvogëlojë rëndësinë e shkollës për të ardhmen e nxënësve. Pritet që përdorimi i TIK-ut gjatë pesë vjetëve në vijim do të merr edhe dimensione të tjera, që, tani për tani, nuk mund të parashikohen. Prandaj, mund të ndodhë që duhet të bëhen ndryshime të mëvonshme në PSAK, në favor të integritimit më të shpejtë të TIK-ut në shkolla.

Financimi i shtuar i veprimtarisë kërkimore-shkencore mund të sjellë ngritje të kapaciteteve hulumtuese në fushën e edukimit, ndërkaj kjo mund të rezultojë me hulumtime të ndryshme, që

¹⁷Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë, STIKK, 2013. Shkarkuar nga http://www.mfa-ks.net/repository/docs/STIKK_raport_alb_2013_short_web.pdf

dalën me rekomandime të reja praktike për adresimin e problemeve në arsim. Prandaj, mund të paraqitet nevoja që në PSAK të bëhen ndryshime dhe plotësime të caktuara, si rezultat i këtyre rekomandimeve të bazuara në hulumtime të mëvonshme.

3.2. Vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016

PSAK-u 2011-2016 ishte plani i parë strategjik gjithëpërfshirës për Kosovën, i cili nuk ka përfshirë në vetvete mekanizmin e rishikimit dhe të vlerësimit. Për këtë dhe shumë arsye të tjera, vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016 ka qenë një detyrë sfiduese. Megjithatë, raporti i vlerësimit i cili është publikuar në nëntor të vitit 2015 ofron disa njohuri shumë të dobishme rreth zhvillimeve që kanë ndodhur në sistemin e arsimit në Kosovë gjatë kësaj periudhe, si dhe siguroj një dokument që shërbej si bazë për zhvillimin e PSAK-ut 2017-2021.

Të gjeturat kyçe të vlerësimit të PSAK-ut 2011-2016 janë si në vijim:

1. Disa përmirësime të dukshme janë vërejtur në procesin e hartimit të politikave në arsimin parashkollor. Megjithatë, cikli i zbatimit nuk ka regjistruar ndonjë rritje të konsiderueshme në nivelet e regjistrimit në edukimin parashkollor. Planifikimi në të ardhmen duhet të vë një theks më të madh në këtë nën-sektor dhe duhet të synojë rritjen e regjistrimit në arsimin parafillor me një numër shtesë prej 5000 fëmijëve, dhe të dyfishojë përqindjen e fëmijëve në programin parashkollor (0-4).
2. Kosova ka arritur një nivel të lartë të regjistrimit në arsimin parauniversitar, i cili është i krahasueshëm me nivelet evropiane, ku edhe arritshmëria e nxënësve në provimet e jashtme është rritur në mënyrë modeste. Megjithatë, mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë dhe llogaridhënies mbasin të pazhvilluara dhe procesi i zbatimit të kurrikulës së re është larg nga përmbushja e afatit të përcaktuar në planifikim. Nën-sektori është duke u goditur nga një rënie e natalitetit dhe kjo do të ketë implikime të mëdha në infrastrukturën shkollore dhe në numrin e mësimdhënësve. Me gjithë progresin e arritur në procesin e kalimit të përgjegjësive nga niveli qendror në atë lokal, procesi i kalimit të përgjegjësive financiare tek shkollat ka hasur në pengesa të mëdha.
3. Rreth gjysma e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë zgjedhin profilin e arsimit profesional. Megjithatë, lidhja e arsimit profesional me tregun e punës mbetet një sfidë, dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë mbasin të pazhvilluara. Raporti mësimdhënës-nxënës është përmirësuar në vitet e fundit, mirëpo numri i personelit përgjegjës për orientim në karrierë dhe menaxhim të cilësisë duhet të rritet. Një numër i standardeve profesionale janë zhvilluar gjatë pesë viteve të fundit, por nevojiten më shumë përpjekje për të plotësuar komplet kornizën. Kurrikula e AAP-së duhet të rishikohet për të siguruar se është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe për të inkurajuar të nxënët e bazuar në module.
4. Disa zhvillime pozitive janë vërejtur në programet e rikualifikimit të mësimdhënësve, mirëpo nevojitet një progres i mëtejshëm për të siguruar që të gjithë mësimdhënësit i përmbushin standardet minimale të mësimdhënies. Gjatë viteve të fundit, pagat e mësimdhënësve janë rritur dhe janë krijuar parakushte për joshjen e mësimdhënësve të kualifikuar dhe për të përmirësuar llogaridhënien e tyre. Megjithatë, aktualisht rreth 40% e mësimdhënësve nuk kanë kualifikime adekuate të përcaktuara me udhëzimin përkatës administrativ për mësimdhënie.
5. Përparim i rëndësishëm është arritur në rritjen e numrit të regjistrimit të studentëve në arsimin e lartë, ku Kosova tani është në krye të vendeve evropiane me numrin e studentëve për 100,000

banorë. Megjithatë, përqindja e studentëve të diplomuar mbetet e ulët dhe rritja e shpejtë e numrit të studentëve ka paraqitur sfida në menaxhimin e cilësisë. Kosova është bërë anëtare e ENQA në vitin 2014, duke konfirmuar se Kosova po i zbaton Udhëzimet dhe Standardet Evropiane të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Megjithatë, ka ende sfida në mekanizmat e brendshëm të cilësisë dhe në zbatimin e një praktike të standardizuar dhe të unifikuar të menaxhimit financiar në të gjitha institucionet publike. Shpenzimet e qeverisë në kërkimin shkencor janë shumë të ulëta (0.1% e BPV-së).

6. Një nga sfidat kryesore në sektorin e arsimit është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovimin e arsimit për të rritur dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe në sigurimin e financimit për këtë prioritet. Aktualisht nuk ka ndonjë skemë financimi apo formulë të financimit për arsimin e të rriturve. Funksionimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr), si dhe i Këshillit të saj është një sfidë dhe parakusht për krijimin e një qasjeje më koherente ndaj arsimit për të rritur. Për më tepër, nuk ka kapacitete të stafit për të adresuar nevojat e arsimit për të rritur dhe zbatimi i prioritetëve të këtij nën-sektori bëhet kryesisht në kuadër të arsimit profesional, si dhe nga organizatat jo-qeveritare dhe bizneset.
7. Sistemi arsimor karakterizohet me një përdorim të ulët të teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK) dhe teknologjia bashkëkohore nuk është e integruar si duhet në kurrikulë, mësimdhënie apo në menaxhim të arsimit. Zbatimi i strategjisë për përfshirjen e teknologjisë së informimit dhe komunikimit nuk ka përparuar siç parashikohej me planin fillestar. Raporti kompjuter-nxënës në Kosovë është 1:46 dhe është shumë më i ulët në krahasim me mesataren e BE-së, ku 3-7 nxënës përdorin një kompjuter. Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxënës mbetet një prioritet i rëndësishëm që duhet të adresohet në ciklin e ardhshëm të planifikimit.
8. Sfidat kryesore në menaxhimin e sistemit arsimor mbetet bashkërendimi i planeve dhe prioritetëve brenda një kornize të bashkërenduar të planifikimit dhe monitorimit. Përfshirja e komunave, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat është thelbësore për avancimin e zbatimit të planeve arsimore. Kapaciteti për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për arsim është përmirësuar dukshëm, por kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve për sigurimin e të dhënave më të detajuara për studentët dhe nxënësit, për integrimin e informatave nga raportimi i të dhënave, për rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe për ndikimin e arsimit në punësim. Duhet të promovohet një qasje më e bashkërenduar e raportimit të të dhënave dhe e raportimit në bazë të praktikës dhe treguesve ndërkombëtar (UNESCO/OBEZh/BE).

Raporti i vlerësimit ka krijuar një "Indeks të zbatimit të PSAK-ut 2011-2016" shumë të dobishëm, i cili ka vlerësuar zbatimin në kuptimin e arritjes së objektivave, si dhe zbatimit të aktiviteteve të dhëna në kuadër të PSAK-ut, sipas nën-sektorëve të ndryshëm të tij. Edhe pse shkalla e indeksit nuk përfaqëson domosdoshmërisht gjendjen në secilin nën-sektor, ajo ofroj një pikë referimi shumë të dobishme për hartimin e PSAK-ut 2017-2021. Vlerësimi ishte gjithashtu në gjendje të ofrojë rekomandime të qarta për veprime të ardhshme në kuadër të sektorit të arsimit.

Megjithatë, vlerësimi nuk ka ofruar asnjë analizë të faktorëve që kanë ndihmuar/vështirësuar zbatimin e PSAK-ut 2011-2016. Për më tepër, procesi i vlerësimit nuk ka provuar që formalisht të vlerësojë se si ka funksionuar PSAK-u 2011-2016 si një plan strategjik. A ka qenë struktura e dobishme? A ka qenë qasja efektive? Për fat të mirë, disa nga këto çështje janë ngritur në diskutime,

gjatë të cilave janë siguruar udhëzime të dobishme lidhur me ndryshimet në strukturën e PSAK-ut 2017-2021.


3.3. Organizimi dhe struktura e sistemit arsimor

Sistemi i arsimit publik në Kosovë operon nëpërmjet një rrjeti të përbërë prej 43 institucioneve parashkollore, 985 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, 119 shkollave të mesme të larta, dhe 9 institucioneve publike të arsimit të lartë. Përveç kësaj, janë edhe 10 institucione private të licencuara që ofrojnë arsimim fillor dhe të mesëm, si dhe 30 institucione të licencuara të arsimit të lartë privat. Po ashtu, janë edhe një numër i institucioneve private që ofrojnë shërbime parashkollore.

Sistemi arsimor në Kosovë është i strukturuar si në vijim:

- Arsimi Parashkollor (ISCED 0¹⁸, fëmijë të moshës < 6 vjeçare)
- Arsimi Fillor (ISCED 1, klasat 1-5, fëmijë të moshës 6-10 vjeçare)
- Arsimi i Mesëm i Ulët (ISCED 2, klasat 6-9, fëmijë të moshës 11-14 vjeçare)
- Arsimi i Mesëm i Lartë (ISCED 3, klasat 10-12, fëmijë të moshës 15-18 vjeçare)
- Arsimi i Lartë (ISCED 5-8)

Në vitet e fundit (*shih grafikun më poshtë*) është arritur një progres i konsiderueshëm në përmirësimin e qasjes në arsim, edhe pse ende nuk është arritur një ekuilibër gjinor, veçanërisht në arsimin e mesëm të lartë.



Burimi: Raporti i vlerësimit të PSAK 2011-2016

Progresi më i dukshëm në shkallën bruto të regjistrimit ka qenë në nivelin e arsimit parafillor, të mesëm të lartë, dhe në nivelin e arsimit të lartë. Edhe pse nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme në nivelin e regjistrimit të fëmijëve në edukimin parashkollor, megjithatë ka pasur një përmirësim të dukshëm në nivelin bruto të regjistrimit të fëmijëve të moshës 5 vjeçare në arsimin parafillor. Regjistrimi në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është, pothuaj se, universal, ndërsa shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë është 84.7%. Rreth gjysma e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë vijon profilet e arsimit profesional.

¹⁸ISCED - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit, i miratuar në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO në sesionin e 36-të në nëntor 2011.

Numri i studentëve në arsimin e lartë është rritur në rreth 122,000 duke e vënë Kosovën në krye të vendeve evropiane me 6,669 studentë për 100,000 banorë.

Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor është e ilustruar në Figurën 1.




Figura 1. Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë (marrë nga Butler dhe të tjerët 2009, dhe e azhurnuar në vitin 2015)

3.4. Sfidat dhe mundësitë në arsimin e Kosovës

Analiza e gjendjes është bazuar në vlerësimin e PSAK-ut 2011-2016 të realizuar nga MASHT-i, si dhe në analizën SWOT të shtatë fushave tematike në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha palët me interes. Rezultatet e analizës së gjendjes janë prezantuar në vijim.

3.4.1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Të dhënat e MASHT-it tregojnë se shkalla e përfshirjes së nxënësve në nivelin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë është përmirësuar. Megjithatë, ende mbetet shqetësuese përfshirja në nivelin parashkollor, në veçanti në nivelin 0-3, që është larg përmbushjes së standardeve evropiane të pjesëmarrjes. Nga të dhënat e MASHT-it vërehet se shkalla bruto e regjistrimit të fëmijëve të grup moshës 0-5 vjeç në arsimin parashkollor dhe parafillor gjatë vitit shkollor 2014/15 ishte 15.7%¹⁹.

Të dhënat tregojnë se shkalla e regjistrimit të fëmijëve në grup moshat 0-4 vjeç në institucione parashkollore të licencuara është vetëm 2.8%, ndërsa e grup moshave 3-5 vjeç është 29.6%²⁰. Sidoqoftë, përfshirja e fëmijëve në arsimin parafillor, tregon një situatë më pozitive që aktualisht arrin në 79.6%²¹.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është shkollim i detyrueshëm, prandaj shkalla e përfshirjes së nxënësve në këto nivele ka qenë gjithmonë e lartë, me 96% në arsimin fillor, përkatësisht me 98% në arsimin e mesëm të ulët, ndërsa shkalla e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë gjatë vitit shkollor 2014/15 ka qenë 84.5%²².

Sfidat kryesore:

- Shkalla e ulët e përfshirjes në edukimin parashkollor.
- Mos funksionimi sistemit të licencimit dhe monitorimit të institucioneve private të edukimit parashkollor.
- Përfshirja e pamjaftueshme në arsim e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Përfshirja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara.
- Fenomeni i braktisjes së shkollimit ende i pranishëm.

Është vërejtur një mobilizim për të rritur përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta dhe gjatë vitit 2013 janë përfshirë 6093 nxënës në shkolla të rregullta²³. Përkundër kësaj, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt është shumë e vogël dhe MASHT-i ka përgatitur planin e veprimit për arsimin gjithëpërfshirës 2016-2020.

Në Kosovë komunitetet e ndryshme janë plotësisht të integruara në sistemin e arsimit, përveç fëmijëve që vijnë në mësimin në shkolla në gjuhën serbe. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme nga ana e MASHT-it, raportet e progresit të BE-së për Kosovën vazhdojnë të theksojnë vështirësitë me të cilat ballafaqohen fëmijët e grupeve të marginalizuara, si dhe të grupeve të ndryshme etnike. Shkalla e ulët e vijueshmërisë së shkollimit, në veçanti të fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian mbetet shqetësuese.

¹⁹ <http://MASHtSmia-001-site1.smarterasp.net/Raport%20Statistikor%20me%20Tregues%20Arsimor%202014-15.pdf>

²⁰ Ibid.

²¹ <http://MASHtSmia-001-site1.smarterasp.net/Raport%20Statistikor%20me%20Tregues%20Arsimor%202014-15.pdf>

²² <http://MASHt.rks-gov.net/uploads/2015/12/raport-statistikor-me-tregues-arsimor-2014-15.pdf>

²³ Përmbledhje e punës së Divizionit për Arsimin me Nevoja të Veçanta për periudhën 2008 -2014.

Masat e ndërmarra gjatë viteve të fundit kanë rezultuar me rënien e shkallës së braktisjes nga 0.48%, sa ishte në vitin 2011, në 0.12% në vitin 2014²⁴. Megjithatë, shkalla e braktisjes dhe shpërputhja ndërmjet të dhënave të të regjistruarve dhe vijueshmërisë mbetet shqetësuese. Shkalla e nxënësve që braktisin shkollimin në fazën e hershme²⁵ të shkollimit nuk është monitoruar deri më tani.

Gjatë dy viteve të fundit, migrimi dhe kthimi i mëvonshëm i një numri të madh të qytetarëve të Kosovës ka shkaktuar probleme në integrimin e fëmijëve të kthyer në sistemin e arsimit. Bashkëpunimi ndërmjet MASHT-it dhe DKA-ve duhet të intensifikohet në mënyrë që të koordinojnë aktivitetet për nxënësit e rikthyer.

Sigurimi i mundësive për mësimin gjatë gjithë jetës, si një aspekt i rëndësishëm i pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes, është trajtuar në 2.4.6.

3.4.2. Menaxhimi i sistemit arsimor

Korniza ligjore për funksionimin e sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm është rumbullakësuar në masë të kënaqshme. Megjithatë, është i nevojshëm zbatimi i plotë dhe rishqyrtimi i pjesëve të legjislacionit, në mënyrë që të shmangen politikat e mundshme kontradiktore dhe të rritet ndikimi i tyre në praktikë me qëllim të sigurimit të një qasje koherente ndaj reformës arsimore dhe të arritjes së rezultateve maksimale me burimet në dispozicion.

Kohëve të fundit, vënia e theksit në autonominë e nivelit komunal dhe shkollor në sistemin arsimor në Kosovë sjell me vete nevojën për të zhvilluar përgjegjshmërinë dhe sigurimin e cilësisë. Prandaj, përmirësimi në menaxhimin e arsimit, duke përfshirë menaxhimin financiar, është një komponentë thelbësore e PSAK-ut 2017-2021. E lidhur ngushtë me të vjen edhe nevoja për ngritjen e konsiderueshme të kapaciteteve, sidomos në nivelin komunal, ku struktura organizative në kuadër të DKA-ve, në përgjithësi, është në shpërputhje me fushat kryesore të përgjegjësisë të reja të marra nga ana e tyre pas hyrjes në fuqi, në vitin 2008, të Ligjit për Arsim në Komuna, dhe fillimit të reformës së vazhdueshme kurrikulare.

Ngjashëm, është e nevojshme të zhvendoset fokusi drejt zhvillimit të shkollës si organizatë dhe ndërtimi i mekanizmave më koherent dhe të qëndrueshëm për vendosjen e llogaridhënies në nivel shkolle. Njëkohësisht, reforma e re kurrikulare, e cila synon autonomi në rritje për nivelin e shkollës, në kuptim të përcaktimit dhe ofrimit të përmbajtjes arsimore, rezulton me nevojën për forcimin e planifikimit dhe menaxhimit të proceseve në shkolla, duke përfshirë punën e mëtejshme për sqarimin e statusit të drejtorëve të shkollave, si një pozitë e karrierës, si dhe në zhvillimin e

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet e kufizuara në nivel qendror, komunal dhe shkollë për zbatim të reformës përmes një qasje të koordinuar dhe koherente.
- Vështirësi në implementimin e plotë të legjislacionit primar dhe jokoherencë e nismave të legjislacionit sekondar dhe politikave arsimore.
- Mungesë e kulturës së politikëbërjes së bazuar në tregues dhe të dhëna më gjithëpërfshirëse.
- Progres i kufizuar drejt shndërrimit të shkollës në ambient miqësor për mësim.
- Vetëdije e ulët tek të gjitha palët në perceptimin e shkollimit si përgjegjësi publike.

²⁴Raporti i vlerësimit të zbatimit të PSAK 2011-2015.

²⁵Nxënësit që braktisin shkollimin në fazën e hershme: të rinjtë në moshat ndërmjet 16 dhe 24 vjeç të cilët kanë përfunduar vetëm shkollën e mesme të ulët dhe që aktualisht nuk janë të regjistruar në ndonjë institucion arsimor apo aftësues.

mekanizmave të cilësisë për emërimin e drejtorëve të shkollave dhe për monitorimin e performancës së tyre.

MASHT ka zhvilluar bazën e të dhënave GIS, e cila mban të dhënat e mbledhura për gjendjen infrastrukturore të të gjitha shkollave (klasat 1-12), si instrument kryesor për planifikimin e investimeve dhe hartimin e politikave. MASHT, po ashtu, ka zhvilluar standardet për ndërtesa arsimore për nivelin 1-12, dhe standarde të tilla do të duhet të zhvillohen edhe për nivelet tjera. Nga viti 2011-2015, infrastruktura shkollore ka arritur në 3.6 m² për nxënës. Megjithatë, kjo mbetet nën standardin kombëtar dhe është i nevojshëm ndërtimi i godinave të reja shkollore. Kjo çështje ndërlidhet, gjithsesi, me potencialin për racionalizimin e rrjetit shkollor si rezultat i ndryshimeve demografike.

Zhvillimi i mjediseve më miqësore, të shëndetshme dhe të sigurt për fëmijë duke përfshirë edhe zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, sipas standardeve përkatëse, si dhe zbatimi i plotë i protokollit për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, mbeten prioritet i rëndësishëm për periudhën vijuese.

Në kontekstin aktual, ku MASHT-i është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e politikave dhe monitorimin e sistemit të arsimit, vendimmarrja e bazuar në të dhëna është esenciale. MASHT-i publikon raporte të rregullta statistikore vjetore dhe raporte periodike të brendshme, si dhe ka zhvilluar një kornizë për një raport të ri statistikor vjetor që i jep publikut qasje në të dhëna. Megjithatë, ka kufizime të konsiderueshme që ndërlidhen me të dhënat e nxënësve. Kredia prej 11 milion dollarë e Bankës Botërore do të mundësojë që fusha e mbledhjes së të dhënave të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme.

Zhvillimi i partneritetit në sektorin e arsimit midis niveleve dhe palëve të ndryshme është, po ashtu prioritet, duke përfshirë edhe lidhjet më të mëdha me partnerët e jashtëm me qëllim të rritjes së përgjegjësisë publike për arsim dhe fuqizimin e bordeve udhëheqëse të shkollës dhe këshillave të studentëve.

3.4.3. Sigurimi i cilësisë

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar “Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020” në dhjetor të vitit 2015. Qëllimi i kësaj strategjie është të prezantojë një sistem të plotë të sigurimit të cilësisë në nën-sektorin e arsimit parauniversitar të Kosovës për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit.

Kjo strategji ka katër komponente të ndryshme, të përfaqësuara përmes objektivave strategjike përkatëse:

Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë.

Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune.

Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet.

Sfidat kryesore:

- Besueshmëria e rezultateve të testeve kombëtare.
- Cilësia e testeve kombëtare.
- Prezenca e dukurisë së MASHTrimit dhe kopjimit në shkolla dhe në teste.
- Analiza e rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për përmirësim të cilësisë.
- Pjesëmarrja në teste ndërkombëtare dhe shfrytëzimi i rezultateve për politikëbërje arsimore.

Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë.

Secili objektiv strategjik është i zbërthyer në masa. Buxheti për zbatimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2016-2020 është rreth 8.2 milion euro.

Për faktin se strategjia tanimë ekziston dhe është hartuar mbi bazën e një analize të thellë të gjendjes, ideja ishte që ajo, thjeshtë, të integrohet në PSAK-un 2017-2021. Megjithatë, gjatë planifikimit të PSAK-ut, pak më shumë vëmendje i është kushtuar një çështjeje e cila ka marrë më pak vëmendje brenda Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar - çështja e vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

MASHT-i dhe DKA-të tanimë kanë fituar përvojë në organizimin e disa provimeve kombëtare. Përkundër dobësive evidente, janë bërë përpjekje të vazhdueshme që të përmirësohet administrimi i provimeve. Në vitin 2015, Kosova ka marr pjesë për herë të parë në vlerësimin ndërkombëtar PISA. Sidoqoftë, mbetet të bëhet edhe shumë punë në administrimin e provimeve kombëtare: fenomeni i kopjimit masiv mbetet i pranishëm, duhet të zhvillohet përdorimi i analizave të rezultateve të provimeve kombëtare si bazë për përmirësimin e cilësisë. Po ashtu, sfida për periudhën e ardhshme mbeten cilësia e administrimit të provimit, besueshmëria e testeve si instrumente matëse dhe përshtatja e testeve për fëmijët me vështirësi në nxënie.

3.4.4. Zhvillimi i mësimdhënësve

Sfidat kryesore:

- Moszbatim i plotë i sistemit të licencimit të mësimdhënësve: vlerësimi i bazuar në performancë dhe licencimi ende mungojnë.
- Ofertë e kufizuar e zhvillimit të obliguar profesional të mësimdhënësve.
- Mungesë e strategjisë për zbatimin e vlerësimit të bazuar në performancë.
- Mungesë e qasjes koherente në sistemin e zhvillimit të mësimdhënësve duke përfshirë koherencën midis zhvillimit 'para-shërbimit', 'fillimit të karrierës' dhe 'zhvillimit në karrierë'.
- Lidhja e pamjaftueshme midis elementeve të ndryshme të menaxhimit të karrierës së mësimdhënësve, si dhe e lidhjes së standardeve të mësimdhënies së mirë me veprimet praktike në zhvillimin e mësimdhënësve dhe licencimin e tyre.

Zhvillimi i mësimdhënësve ka qenë njëri ndër prioritetet e sistemit të arsimit në Kosovë në vitet e fundit. Licencimi i mësimdhënësve ishte menduar si një nga mekanizmat kryesorë për zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies, motivimin e mësimdhënësve për performancë të mirë, si dhe për adresimin e rasteve kur performanca nuk është në nivelin e duhur. Sistemi i licencimit të mësimdhënësve, ashtu siç është planifikuar të zbatohet, ngërthen në vete mekanizmin e zhvillimit profesional të obliguar për secilin mësimdhënës dhe mekanizmin e vlerësimit të performancës të secilit prej tyre, si dy elemente përcaktuese. Avancimi në skemën e licencimit ishte menduar të ndërlidhej me rritjen e pagës për mësimdhënësit, si instrument motivues i performancës së mirë.

Korniza ligjore për licencimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve²⁶ është zhvilluar por ende nuk është zbatuar. Megjithatë, së fundi, aktivitetet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë zhvilluar në

baza të rregullta nga projekte të ndryshme. Është e qartë që arritja e cakut që secili mësimdhënës të

²⁶Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2013: Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 25/2014: Licencimi i mësimdhënësve 2014.

plotësojë një numër të caktuar të orëve të zhvillimit profesional (së paku 100 orë gjatë periudhës pesë vjeçare) do të jetë sfiduese.

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë në ndërtimin e mekanizmave për realizimin e qëndrueshëm të zhvillimit profesional. Po ashtu, është zhvilluar mekanizmi për përcaktimin e procedurave dhe përgjegjësi të secilës palë në zbatimin e një sistemi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional, duke ndarë rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë në proces²⁷.

Në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2013, modeli ekzistues i zhvillimit profesional, i drejtuar nga ofertuesit/oferta, duhet të zgjerohet edhe me alternativa të tjera, duke përfshirë qasjen e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, pa anashkaluar mekanizmat e monitorimit dhe të akreditimit të programeve të zhvillimit profesional dhe integritet brenda skemës së gjerë të licencimit të mësimdhënësve (në nivel qendror). Do të jetë e domosdoshme të zhvillohet një proces i vazhdueshëm i vlerësimit të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional nga niveli qendror, dhe në nivel shkolle dhe komune. Zhvillimi profesional duhet të menaxhohet nën një kornizë më të gjerë qendrore, e cila lidh zhvillimin profesional me reformën kurrikulare dhe rezultatet e marra, si për arritjet e nxënësve.

Sistemi i zhvillimit profesional dhe i licencimit duhet të udhëhiqet nga një seri parimesh dhe standardesh të mësimdhënies së mirë, në mënyrë që licencimi i mësimdhënësve të shkojë drejt avancimit, si mekanizëm për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Kosovë. Përkundër progresit të arritur në avancimin e profesionalizimit të rolit të mësimdhënësit, nevojitet zhvillim i mëtutjeshëm në dy drejtime. Fillimisht, duhet të sigurohet një mekanizëm që të gjitha institucionet publike që përgatisin mësimdhënës të rinj të bazohen në standarde të unifikuara shtetërore. Së dyti, duhet të specifikohen standardet për nivelin e 'para shërbimit' dhe atyre 'në shërbim', si dhe të sigurohet ndërlidhja midis tyre.

3.4.5. Mësimdhënia dhe të nxënit

Për të ngritur cilësinë e arsimit në Kosovë dhe për të harmonizuar atë me trendet e vendeve të zhvilluara, MASHT-i, në vitin 2011, ka aprovuar Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK). Kjo kornizë mundësoi kalimin nga mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në objektiva dhe përmbajtje mësimore, në metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit të bazuar në rezultate dhe në zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Pas aprovimit të Kornizës së Kurrikulës, u hartua baza ligjore dhe dokumentet përcjellëse për zbatimin e saj. Sipas planifikimit të MASHT-it pritej që kurrikula të zbatohet në të gjitha shkollat e Kosovës gjatë periudhës 2011-2014. Gjatë vitit 2013/2014 pilotimi i kurrikulës u realizua fillimisht në 10 shkolla, ndërsa një vit më vonë zbatimi i saj u zgjerua në 92 shkolla në 30 komuna. Disa nga

Sfidat kryesore:

- Kapacitete të limituara për zbatimin e kurrikulës së re.
- Hartimi i teksteve të reja shkollore të bazuara në nevojat dhe kërkesat e kurrikulës për zhvillimin e kompetencave.
- Kapacitete të limituara për shfrytëzimin e TIK-ut dhe për përgatitjen e resurseve online.
- Mungesa e mjeteve të konkretizimit për zbatimin e kurrikulës së re.
- Mungesa e shërbimeve funksionale profesionale në DKA dhe në shkolla.

²⁷Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për zbatimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

problemet që shoqëruan shtrirjen e ngadalshme të kurrikulës së re janë: numri i vogël dhe përgatitja e pamjaftueshme e trajnerëve të fushave lëndore për të aftësuar, mentoruar dhe monitoruar mësimdhënësit gjatë zbatimit të kurrikulës në klasa, kapacitetet e kufizuara profesionale dhe financiare në sistemin e arsimit, vonesat në përgatitjen e materialeve përcjellëse për zbatimin e kurrikulës, si dhe mungesa e teksteve shkollore të përshtatshme.

Standardet për hartimin e teksteve shkollore²⁸ janë zhvilluar dhe ato mund të shërbejnë si bazë për rishikimin e teksteve ekzistuese, si dhe për hartimin e teksteve të reja. Megjithatë, MASHT-i duhet të ofrojë mjete financiare për realizimin e këtij procesi. Për të minimizuar shpenzimet dhe për të ofruar fleksibilitet maksimal, MASHT-i duhet të shqyrtojë përgatitjen e materialeve digjitale.

MASHT ka hartuar draft-Strategjinë për mësimin elektronik dhe ka bërë pajisjen e shkollave me mjete dhe pajisje të ndryshme mësimore. Një numër i konsiderueshëm i shkollave në Kosovë janë pajisur me kompjuterë, projektorë, pajisje për kabinete të ndryshme, si dhe mjete të tjera që mundësojnë zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Statistikat e MASHT-it tregojnë se 44.4% e shkollave kanë pajisjet për teknologji të informacionit dhe të komunikimit. Megjithatë, problemi i mirëmbajtjes së dobët të pajisjeve të TIK vazhdon të mbetet. Për më tepër, përkundër investimeve, numri i mësimdhënësve që janë të aftë të përgatisin përmbajtje elektronike dhe të përdorin ato në procesin mësimor është shumë i kufizuar.

3.4.6. Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi i të Rriturve

AAP administrohet përmes një numri të konsiderueshëm të ligjeve dhe politikave arsimore të cilat ndodhë të janë kontradiktore dhe duhet të harmonizohen sa me shpejtë.

Në përgjithësi, regjistrimi i nxënësve në shkolla profesionale shihet si një opsion i dytë për ata që nuk arrijnë të regjistrohen në shkollat e mesme të përgjithshme/gjimnazet, dhe numri i nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale, në vitet e fundit ka rënë nën 50% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në shkollimin e mesëm të lartë. Raporti ndërmjet arsimit profesional dhe tregut të punës mbetet sfidë që kërkon trajtim të menjëhershëm, sepse rreth 30% e shkollave profesionale ofrojnë profile të cilat nuk janë shumë të kërkuara në treg.

Buxheti për nxënës në AAP është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat themelore. Për më tepër, shkollat publike profesionale kanë kufizime serioze në gjenerimin e të hyrave. Kufizimet financiare për AAP-në zvogëlojnë mundësitë për investime në infrastrukturë dhe në pajisje, edhe për ato aftësi specifike për të cilat ka një kërkesë në Kosovë.

Sfidat kryesore:

- AAP ekzistues nuk i përgjigjet kërkesave të tregut të punës.
- Mungesa e Kurrikulës Bërthamë të veçantë për AAP.
- Përfshirje e tërë sistemit të AAP në KKK.
- Mundësi të kufizuara për trajnim praktik, brenda shkollës dhe në ndërmarrje.
- Buxheti i pamjaftueshëm dhe formula joadekuate për AAP.
- Oferta shumë e kufizuar për nivelin e 5-tët KKK.
- Sigurimi i qëndrueshmërisë i qendrave të kompetencës.
- Mungesë e sistemit efikas dhe të hapur për arsim për të rritur.

²⁸ Udhëzimi Administrativ Nr. 5/2011 për zbatimin e standardeve të teksteve shkollore.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është funksional, përkundër numrit të vogël të stafit dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë së jashtme të shkollave të AAP. AKK ka ofruar trajnime për koordinatorët e sigurimit të cilësisë, dhe, po ashtu, deri më tani, ka përfunduar validimin e 19 kualifikimeve dhe akreditimin e mbi 33 institucioneve private që ofrojnë arsim profesional dhe verifikimin e mbi 40 standardeve të profesionit.

Themelimi i qendrave të kompetencës është shoqëruar me disa zhvillime pozitive për sa i përket infrastrukturës, ngritjes së kapaciteteve të tyre, zhvillimit të standardeve të profesionit, kurrikulave modulare të bazuara në kompetenca dhe materialeve mësimore. Megjithatë, duhet të sigurohet qëndrueshmëria e tyre financiare. Agjencia e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale dhe Arsimit të Rritur (AAPARR) është themeluar në vitin 2014 dhe aktualisht vazhdon të mbetet në fazë pilotuese deri në shtator 2016. Pas kësaj faze mbetet të qartësohet roli i mëtejshëm i saj në sistemin e AAP-së.

Përkundër disa përparimeve në zhvillimin e praktikës së mbledhjes së të dhënave të tregut të punës dhe hartimit të Strategjisë për Arsim dhe Këshillim në Karrierë 2015-2019, mungesa e orientimit dhe qendrave të këshillimit të karrierës në shkollë, në nivel komunal dhe në nivel kombëtar, si dhe mungesa e informatave nga tregu i punës, mbeten sfida të rëndësishme. Në mënyrë të ngjashme, përkundër punës së mirë të MASHT në Strategjinë për Praktikën Profesionale 2013-2020 dhe zhvillimin e dy udhëzuesve për ndërmarrjet dhe shkollat profesionale me qëllim që të ofrohen mundësi për bashkëpunim më të madh, deri më tani ende nuk ka ndonjë marrëveshje ndërministrorë për të lehtësuar këtë bashkëpunim dhe për të mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale të nxënësve.

Çështjet të tjera të cilat kanë nevojë për vëmendje në AAP përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të stafit mësimdhënës, sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe ndërmarrjeve, rishikimin e standardeve ekzistuese të profesionit dhe zbatimin e standardeve që mungojnë. Sfidat e tjera janë zhvillimi i kurrikulit bërthamë për AAP-në, korniza për profilet profesionale, modularizimi i kurrikulave ekzistuese të AAP-së dhe zhvillimi i kurrikulës së re modulare të bazuar në kompetenca sipas standardeve profesionale, cilësia e mësimit praktik dhe trajnimit në shkollat profesionale dhe mbështetja për mësimdhënësit e AAP-së nga programet e zhvillimit profesional.

Në arsimin për të rritur, ekziston një vetëdije se "bërja e mësimit gjatë gjithë jetës dhe e mobilitetit realitet" është objektivi i parë i ET 2020. Megjithatë, mungesa, pothuajse, totale e strukturave dhe ekspertizës në fushën e arsimit për të rritur në Kosovë, e kombinuar me nevojën urgjente për të përmirësuar cilësinë e dispozitave ligjore, bëjnë të pamundur që zhvillimi i mësimit gjatë gjithë jetës në Kosovë të jetë prioritet brenda një periudhe afatmesme. Megjithatë, do të bëhen disa përpjekje përmes PSAK-ut 2017-2021 për të filluar angazhimin në këtë fushë.

3.4.7. Arsimi i lartë

Aktualisht, në Kosovë veprojnë 39 institucione të akredituara dhe të licencuara të arsimit të lartë, prej të cilave 9 janë institucione publike dhe 30 institucionet private. Kështu, Kosova ka 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë që tejkalon shumëfish mesataren e Bashkimit Evropian²⁹.

Numri i studentëve në arsim të lartë është rritur nga rreth 40,000 studentë në vitin 2004 në 122,000 në vitin 2015. Kosova ka 6,669 studentë në 100 mijë banorë, që është, pothuajse, dyfishi i mesatares

²⁹Të dhënat nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës, Eurostat dhe www.webometrics.info.

së BE-së³⁰. Pjesëmarrja e femrave në arsimin e lartë është rritur dhe tani 50.2% e popullsisë studentore janë femra. Po ashtu, Kosova ofron trajtim preferencial për regjistrim në arsim të lartë për kandidatët nga radhët e komuniteteve etnike joshqiptare.

Numri i programeve të studimit ka shënuar rritje domethënëse. Megjithatë, të gjitha hulumtimet në Kosovë tregojnë se ekziston një shpërputhje e madhe ndërmjet ofertës së arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës, siç bëhet e qartë nga shqyrtimi i tabelës më poshtë:

Përqindja e studentëve sipas fushave të studimit

Fusha Studimore	Publik	Privat	Total
Edukimi	9.2%	0.0%	6.8%
Shkencat humane dhe artet	10.8%	6.4%	9.7%
Shkencat shoqërore, biznesi dhe drejtësia	48.1%	63.7%	52.1%
Shkencat e natyrës, matematika dhe kompjuterika	5.5%	10.2%	6.7%
Inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi	14.0%	7.5%	12.3%
Bujqësia dhe veterina	2.6%	0.0%	2.0%
Shëndeti dhe Mirëqenia	6.9%	7.7%	7.1%
Shërbimet	2.8%	4.5%	3.3%

Burimi: Të dhënat e pjesshme nga institucionet e arsimit të lartë

Për më tepër, mungesa e komunikimit të mjaftueshëm në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe të komunitetit të biznesit ka rezultuar në vështirësi për studentët në kryerjen e praktikës profesionale.

Rritja e numrit të stafit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë në vitet e fundit ka qenë tejte e ulët në krahasim me numrin në rritje të studentëve dhe programeve. Kapacitetet e administratës në institucionet publike të arsimit të lartë janë të kufizuara. Për më tepër, infrastruktura dhe pajisjet adekuate janë të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit. Aktualisht, qasja në literaturë të përditësuar në bibliotekat e institucioneve të arsimit të lartë mbetet një sfidë, si dhe ka një numër shumë të kufizuar të laboratorëve. Në përgjithësi, të gjitha investimeve në infrastrukturë ju mungon një plan operativ i mirëmbajtjes dhe qëndrueshmërisë.

Sfidat kryesore

- Shpërputhje e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës.
- Raport i disfavorshëm ndërmjet numrit të stafit akademik dhe studentëve.
- Mosinkurajimi i punës kërkimore-shkencore në IAL.
- Mungesa e të dhënave në IAL.
- Kapacitete të ulëta për hartimin e projekteve.
- Mungesa e formulës për financimin e IAL bazuar në performancë.
- Mungesa e praktikës profesionale për studentët.
- Numri i vogël i të diplomuarve në arsim të lartë.

Kosova ende nuk e ka të zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxitë efektivitetin dhe llogaridhënien, përkundër faktit që korniza ligjore e arsimit të lartë përcakton zhvillimin e mekanizmave efektive për financim të bazuar në performancë. Nga viti 2011, financimi për arsimin e lartë është në rritje si përqindje e bruto-produktit vendor dhe buxhetit të Kosovës. Si total, shpenzimet publike për arsim të lartë janë në kufi të standardeve evropiane, ndërkohë që shpenzimet për kokë studenti janë në rënie, për shkak të shtimit të numrit të

³⁰Kalkulimet janë bërë bazuar në të dhënat e Eurostat dhe MASHT 2015.

studentëve dhe rritjes së vazhdueshme të BPV-së. Në anën tjetër, institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë shumë pak i shfrytëzojnë mundësitë për krijimin e mjeteve vetanake.

Kosova ishte një nga vendet e para në Evropë që ka miratuar sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS), dhe ka ndjekur dhe zbatuar të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës. Megjithatë, Kosova e ka pasur të pamundur te anëtarësohet në Procesin e Bolonjës, pasi që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës.

Në dimensionin e sigurimit të jashtëm të cilësisë, AKA është anëtarësuar në ENQA dhe EQAR dhe ndërmjet periudhës 2009-2015 ka realizuar 276 raunde të vlerësimit të jashtëm në institucionet e arsimit të lartë. Procesi i akreditimit ka ndikuar në themelimin dhe funksionalizimin e zyrave për sigurim të cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, të cilat i zbatojnë procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë.

Kosova merr pjesë në skema të mobilitetit akademik siç janë: CEEPUS, Erasmus Mundus dhe përfiton mbështetje nga forma të ndryshme të përkrahjes bilaterale dhe multilaterale në arsimin e lartë. Mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët janë të shumta, përkundër që mosnjohja e mjaftueshme e gjuhës angleze nga stafi dhe studentët kufizon mundësitë për shfrytëzimin e këtyre skemave. Kosova merr pjesë me një numër mjaft të vogël të projekteve në programin e BE-së për kërkim dhe inovacion "Horizon 2020".

Në fushën e kërkimit shkencor, Kosova mbetet prapa vendeve të tjera evropiane: me 0.1 % të bruto produktit vendor të investuar në hulumtim dhe me 826 publikime të indeksuara në dy bazat e të dhënave më prestigjioze (Scopus dhe Web of Science) në periudhën 2003-2013, Kosova është larg nga arritja e standardeve evropiane për zhvillimin e kërkimit shkencor. Megjithatë, Strategjia e Inovacionit të Kosovës 2016-2020 është hartuar së fundi, e cila përcakton objektivat dhe aktivitetet për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për të lidhur komunitetin shkencor me industrinë dhe ekonominë. Për më tepër, në katër vitet e fundit, në kuadër të Fondit të Shkencës, MASHT-i ka mbështetur punën kërkimore shkencore përmes disa skemave të granteve. Sfidë mbetet shfrytëzimi i këtyre granteve në mënyrë efektive.

3.5. Financimi i arsimit në Kosovë

Shpenzimet publike në Sektorin e Arsimit në Kosovë janë rritur në mënyrë të qëndrueshme nga 3.3% e BPV-së në vitin 2007³¹ në 4.7% të BPV-së në vitin 2014³² gjë që e bën Kosovën të krahasueshme me vendet e tjera të rajonit. Megjithatë, për shkak të BPV-së së ulët dhe popullatës së re, Kosova mbetet prapa vendeve të tjera në kuptimin e shpenzimeve për kokë banori për nxënës. Shpenzimet për kokë banori në arsimin parauniversitar në vitin 2014 ishin 477 Euro³³ (ose 16.1% e BPV-së për kokë banori), ndërsa në arsimin e lartë - 703 Euro³⁴ (ose 23.8% e BPV-së për kokë banori). Në vendet e OBEZh-it, shpenzimet për nxënës nga institucionet arsimore shkojnë mesatarisht në 21% të BPV-së për kokë banori në nivelin fillor, 26% në nivelin e mesëm, dhe 41% në nivel terciar³⁵. Tabela 1 ofron një pasqyrë të shpenzimeve sipas treguesve standard dhe nën-sektorëve për periudhën 2011-2014.

Tabela 1. Pasqyrë e shpenzimeve në sektorin e arsimit 2011-2014

	2011	2012	2013	2014
GDP (BPV)	4,773	4,916	5,327	5,581
Shpenzimet në sektorin e arsimit	218.9	230.4	230.5	262.3
% GDP në arsim	4.60%	4.70%	4.30%	4.70%
Buxheti i Qeverisë në total	1,415	1,441	1,469	1,589
Buxheti (%) arsim	15.50%	16.00%	15.70%	16.50%
Financimi qendror	65.4	71.4	69.9	81
Financimi lokal (komuna)	153.5	159	160.5	181.3
Financimi i arsimit parauniversitar	183.95	192.57	188.80	210.99
Financimi në arsimin e lartë	34.63	37.62	41.02	50.76

Burimi: Ministria e Financave/MASHT

Shenim (1): Financimi lokal përfshin jo vetëm grantin specifik për arsim por edhe të hyrat vetanake (vetëfinancimin), grantin e përgjithshëm. Shpenzimet në nivelin parauniversitar përfshijnë financimin lokal dhe shpenzimet e MASHT të dedikuara për nivelin e arsimit parauniversitar. Shpenzimet në arsimin e lartë përfshijnë shpenzimet e institucioneve publike arsimore, shpenzimet e MASHT për arsimin e lartë, UP, ASHAK, AKSP, BK.

Burimi: MASHT: Raporti i Vlerësimit të PSAK 2011-2016, nëntor 2015

Rritja e pagave të mësimdhënësve në vitin 2011 dhe 2014, si dhe përfshirja e përfitimeve të reja dytësore kanë tejkaluar shpenzimet tjera në arsim. Shuma e grantit specifik të arsimit për vitin 2016 është 161.3 milionë euro dhe mbulon vetëm pagat³⁶, ndërsa nuk parashihet asnjë kontribut nga ana e qeverisë për shpenzimet operative jashtë pagave. Nga ana tjetër, buxhetet komunale për arsim arrijnë shumën gjithsej prej 172 milionë euro (duke përfshirë shpenzimet kapitale komunale për arsim). Prandaj, ekziston një mungesë prej 11 milionë euro ose 7% më pak nga financimi i kërkuar³⁷. MASHT-i është në proces të trajtimit të kësaj çështjeje përmes një politike të re që do të përfshihet në KASH 2017-2019.

³¹Banka Botërore: Rishikimi i Financave Publike i Republikës së Kosovës, Raporti nr.: ACS9351, qershor 2014.

³²MASHT: Raporti i Vlerësimit të PSAK-ut 2011-2016, nëntor 2015.

³³Po aty, p. 12.

³⁴Po aty, p. 88.

³⁵OBEZh: Arsimit në vështrim të shpejt 2011, faqe 212.

³⁶Qeveria e Republikës së Kosovës: Korniza Afat-Mesme e Shpenzimeve 2016-2018.

³⁷Buxheti i vitit 2016: subvencioni komunal për grantin operativ specifik për shërbimet e arsimit fillor (përfshirë pjesën kapitale).

3.6. Intervenimet kryesore në fushën e arsimit

Në 17 vitet e fundit ka pasur programe të shumta të financuara nga donatorët që mbështetnin zhvillimin e pjesëve të ndryshme të sektorit të arsimit. Programet që janë relevante për zhvillimin e PSAK-ut 2017-2021 ndahen në tri kategori, dhe janë ilustruar më poshtë.

3.6.1. Programet që mbështesin përmirësimin e cilësisë së arsimit

Ky grup i programeve përfshin:

- Zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës - Korniza e re e kurrikulit e bazuar në kompetenca është miratuar në gusht 2011, por zbatimi i saj i cili është mbështetur nga UNICEF-i, Banka Botërore, Projekti SWAp dhe Projekti i Binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian, është ende në fazën e saj të pilotimit.
- Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve - Në vitin 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës filloi zbatimin e një sistemi të akreditimit të programeve të trajnimit, duke njohur faktikisht kualifikimet e fituara përmes trajnimit në shërbim. Nga atëherë, më shumë se 100 programe të trajnimit në shërbim janë ofruar nga ofruesit e akredituar publikë dhe privatë, ku edicioni i parë i Katalogut të Programeve të pranuar u botua në vitin 2011. MASHT-it dhe partnerët zhvillimor, duke përfshirë USAID-in, GIZ-in, dhe BE-në, kanë siguruar një shumëllojshmëri të programeve të ndryshme të trajnimit për mësimdhënësit dhe administratorët.
- Licencimin e mësimdhënësve - Qeveria e Republikës së Kosovës e mbështetur nga Banka Botërore, futi në zbatim sistemin e licencimit të mësimdhënësve në bazë të pjesëmarrjes në trajnimin në shërbim dhe vlerësimit të performancës për të siguruar një kornizë e cila i nxit mësimdhënësit që në mënyrë të vazhdueshme të rritin performancën e tyre profesionale.
- Sigurimin e Cilësisë në Arsim - me asistencë teknike nga BE-ja, Banka Botërore dhe USAID-i, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka hartuar materiale esenciale dhe instrumente të punës që ndërlidhen me kornizën ligjore të kualifikimeve dhe sigurimin e cilësisë të AAP-së, dhe futi në funksion procedura për akreditim vullnetar të institucioneve të AAP-së në bazë të vlerësimit të jashtëm. MASHT-i ka zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse të sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar, e cila është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2015.
- Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit - Përveç blerjes së kompjuterëve, MASHT-i ka punuar me partnerët zhvillimorë, në veçanti me BE-në dhe USAID-in, në zhvillimin e përmbajtjes elektronike (e-përmbajtjes) dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla.
- Ngritjen e kapaciteteve - Programi TalkOn i financuar nga GIZ, i fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të MASHT-it, ka filluar në fillim të vitit 2014 si pararendës për një ndërhyrje më të madhe të ngritjes së kapaciteteve, e cila është financuar nga Fondi i Përbashkët i Sektorit të Arsimit (FPSA) themeluar në maj të vitit 2013 nëpërmjet një Marrëveshjeje të Financimit të Përbashkët (MFP) ndërmjet Qeverisë së Kosovës, e përfaqësuar nga MASHT-i, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian, dhe partnerëve zhvillimor që kontribuojnë në fondin, duke përfshirë SIDA-n dhe ADA-n.

3.6.2. Programet që mbështesin ndërlidhje efektive të arsimit me tregun e punës

Ky grup i programeve përfshin:

- Qendrat e Kompetencës (QeK) - mbështetur nga Lux-Development, NORAD dhe GIZ janë një koncept i ri i institucioneve të AAP-së që kanë për qëllim lehtësimin e procesit të shmangies nga kurrikula e bazuar në përmbajtje në kurrikulë të bazuar në kompetenca, duke siguruar një përgatitje të shkëlqyer për tregun e punës. Qendrat kanë objekte të shkëlqyera, lidhje të mira me tregun e punës, dhe janë menduar të shërbejnë si modele për shkollat profesionale në Kosovë dhe rajon.
- Programet e Simulimit të Biznesit - firmat ushtrimore ua mundësojnë shkollave që të krijojnë biznese virtuale të cilat janë pjesë e një rrjeti më të gjerë ndërkombëtar të firmave virtuale, duke ua mundësuar nxënësve që të praktikojnë aspekte të ndryshme të administrimit të biznesit, përfshirë marketingun, kontabilitetin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Aktualisht, firmat ushtrimore të themeluara me mbështetjen e partnerëve zhvillimorë SDC, ADA dhe DANIDA veprojnë me sukses në të gjitha shkollat ekonomike dhe bujqësore në Kosovë. Gjithashtu, ekziston një Qendër e Shërbimit në MASHT e cila ofron shërbime virtuale për të gjitha firmat ushtrimore dhe organizon trajnime dhe krijimin e rrjeteve për mësimdhënësit, si dhe organizon panairë vjetore.
- Ndërlidhja e programeve të arsimit me tregun e punës - Qeveria e Republikës së Kosovës ka punuar me vite për të forcuar cilësinë dhe rëndësinë e programeve të arsimit dhe lidhjen ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, si një parakusht për punësim dhe zhvillim ekonomik. Dy projekte të reja të financuara nga BE-ja do ta zhvillojnë më tej këtë punë, projekti ALLED (Harmonizimi i Arsimit me Nevojat e Tregut të Punës) dhe projekti KEEN (Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim).

3.6.3. Programet që synojnë grupet e marginalizuara

Ky grup i programeve përfshin:

- Mbështetja e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian - ndërhyrjet kanë qenë të mbështetura nga partnerët e ndryshëm zhvillimor, duke përfshirë BE-në, SDC, Balkan Sunflowers, REF, dhe qeverinë gjermane, në zona të ndryshme në Kosovë, ndërsa MASHT-i është marrë me koordinim, dhe kohëve të fundit ka marr përsipër edhe një pjesë të financimit.
- Arsimi i Veçantë - MASHT-i i ka kushtuar vëmendje të madhe përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe me mbështetjen e partnerëve zhvillimor, në veçanti të Qeverisë së Finlandës, ka krijuar një mjedis më të mirë për ta. Pesë shkolla të veçanta janë shndërruar në qendra burimore me qëllim të lehtësimit të integrit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta në vend të ndarjes së tyre në shkolla të veçanta. Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu edhe trajnimit të mësimdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës.

4. Vizioni ynë, misioni ynë dhe vlerat tona

Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021 merr si pikënisje legjislacionin e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2020, si dhe dokumentacionin tjetër përkatës. Në kuadër të këtyre parametrave, dhe duke marrë parasysh mjedisin aktual vendor dhe ndërkombëtar, një grup i gjerë i palëve me interes të përfshirë në zhvillimin e PSAK-ut kanë formuluar vizionin e sistemit të arsimit në Kosovë: Kosova, shoqëri konkurrense e dijes, e bazuar në vlerat evropiane, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për t'i kontribuar zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

VIZIONI

Kosova, shoqëri konkurrense e dijes, e bazuar në vlerat evropiane, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për t'i kontribuar zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

Mandatet e institucioneve kryesore përgjegjëse për arsim dhe aftësim në Kosovë janë përcaktuar me ligj apo me udhëzime administrative. Megjithatë, të gjitha këto institucione, përveç që kanë për detyrë të veprojnë në përputhje me mandatin e tyre, janë relativisht të lira për të filluar aktivitete të tjera, përderisa ato nuk janë të ndaluara shprehimisht. Mendohet se të gjitha institucionet do të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve arsimore në të gjitha nivelet në Kosovë. Deklarata e misionit e formuluar nga palët me interes, gjatë hartimit të PSAK-ut, ofron një mjet të dobishëm për të ndihmuar në nxitjen kreativitetit: Zhvillimi i sistemit arsimor të bazuar në cilësi, në qasje gjithëpërfshirëse dhe në llogaridhënie, që mundëson formimin e individëve në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

MISIONI

Zhvillimi i sistemit arsimor të bazuar në cilësi, në qasje gjithëpërfshirëse dhe në llogaridhënie, që mundëson formimin e individëve në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.


Gjithashtu, ne kemi marrë hapin me qëllim që t'i afirmojmë vlerat tona për të theksuar qasjen tonë strategjike për t'u përballuar me rrethanat që ndryshojnë shpejtë, në kuadër të të cilave do të zbatohet PSAK-u, si dhe për të mbështetur realizimin e objektivave tona. Vlerat janë në zemër të kulturës dhe sjelljes sonë organizative. Ato identifikojnë atë që ne besojmë fuqishëm dhe ato bëjnë deklaratë të forta në lidhje me besimet, qëndrimet dhe sjelljet që udhëzojnë se si ne i realizojmë shërbimet e arsimit dhe trajnimit cilësor për qytetarët e Kosovës. Ne jemi konsultuar gjerësisht për të siguruar që vlerat janë të përbashkëta.

VLERAT:

- **Respekti:** ne i qasemi të tjerëve në një mënyrë që tregon se i vlerësojmë ata dhe kontributin e tyre. Ne tregojmë respekt në të gjitha marrëdhëniet tona me palët e interesit, duke përfshirë edhe marrëdhëniet në mes të stafit menaxhues dhe mënyrës se si ne komunikojmë me financuesit dhe si ofrojmë shërbimet për qytetarë.
- **Integriteti:** ne do të fitojnë besimin dhe respektin duke qenë etik, të ndershëm dhe të paanshëm. Ne jemi të ndershëm dhe të sinqertë në të gjitha marrëdhëniet dhe komunikimet tona. Ne sigurojmë që informatat të jenë me kohë, të përshtatshme dhe të sinqerta.
- **Gjithëpërfshirja:** ne jemi të përkushtuar për shumëllojshmërinë, barazinë e mundësive dhe drejtësinë sociale, dhe ne i vlerësojmë dhe i gëzojemi dallimeve. Ne ofrojmë shërbime kulturore gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.
- **Bashkëpunimi dhe partneriteti:** ne e vlerësojmë partneritetin dhe bashkëpunimin si mënyra më efektive për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona.
- **Risitë:** ne jemi të hapur për ndryshime, përshtatje, veprim proaktiv dhe risi gjatë punës sonë të përbashkët në shkolla dhe në vende të punës, për të gjetur metoda të reja për t'u përballur me sfida, në një mjedis gjithnjë në ndryshim.
- **Përsosmëria:** ne kemi pritje të mëdha për veten, nxënësit tanë dhe komunitetet tona, dhe kemi për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit tonë.

5. Qasja jonë strategjike

Qasja jonë metodologjike është ilustruar në Figurën 2:



5.1. Objektivat strategjike të PSAK-ut

Objektivat strategjike të PSAK-ut 2017-2021 janë, kryesisht, tematike, me vetëm dy prej tyre që i referohen nën-sektorëve të veçantë. Vendimi për të miratuar këtë qasje ka për qëllim të shmang dyfishimin e identifikuar gjatë vlerësimit të PSAK-ut 2011-2016, si dhe të sigurojë harmonizim me prioritetet tematike tashmë të identifikuara nga qeveria, dhe, mbi të gjitha, për të siguruar që PSAK-u i ri ka orientim të qartë strategjik. Dy përjashtimet, AAP/Arsimi i të Rriturve dhe Arsimi i Lartë, janë fusha, pa dyshim, më të gjera në fushëveprimin e tyre se sa nën-sektorët e MASHT-it të fokusuar në arsimin parauniversitar. Fushat prioritare strategjike janë përcaktuar në figurën 5 më poshtë:




Figura 5: Objektivat strategjike të PSAK 2017-2021

Ky kapitull ofron një pasqyrë të objektivave strategjike. Detajet e plota të arsyeshmërisë, rezultatet e pritura dhe aktivitetet e mundshme për secilin objektiv strategjik, si dhe rreziqet dhe supozimet përcjellëse dhe lidhjet ndërmjet objektivave të ndryshme janë prezantuar në kapitujt përkatës më poshtë.

Objektivi Strategjik/OS 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

Ky objektivi strategjik ndërlidhet drejtpërdrejt me prioritetet e Qeverisë, Kornizën Strategjike të BE-së 2020, si dhe me vlerësimin e fundit të PSAK-ut 2011-2016. Megjithatë, rritja e gjithëpërfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim kërkojnë kohë dhe nuk mund të arrihen pa zbatimin e plotë të kornizës ligjore. Prandaj, kjo është një çështje komplekse e cila kërkon mobilizimin e shkollave, si dhe të qeverisjes lokale dhe qendrore. Ky objektivi strategjik ka lidhje të qarta me aspekte të tjera të

PSAK-ut, në veçanti me krijimin e një sistemi të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave që gjithashtu do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët që braktisin shkollën, si dhe me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si përmes ofrimit të programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, ashtu edhe përmes zbatimit të ideve dhe qëllimeve themelore të KKK-së.

Objektivi Strategjik/OS 2: Menaxhimi i sistemit arsimor

Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

Ky objektivi strategjik, gjithashtu, rrjedh direkt nga strategjia kombëtare e zhvillimit. Në rrethanat kur sistemi i arsimit është i decentralizuar, përveç ekzistimit të autonomisë së plotë financiare dhe profesionale, avancimet në arsim varen, kryesisht, nga zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese në nivelin qendror, komunal dhe të shkollës. Në kuadër të decentralizimit, ngritja e kapaciteteve në nivel lokal/nivel të shkollës duhet të shtrihet në organe të tilla si këshillat drejtues të shkollës, të cilat duhet të luajnë një rol kyç në këtë proces. Ky objektivi, pra është në zemër të tërë PSAK-ut 2017-2021, dhe ashtu si me OS 1, është i ndërlidhur ngushtë me aspekte të tjera të PSAK-ut, e të cilat duhet të jenë parime udhëheqëse të ndërtimit të kapaciteteve menaxhuese, dhe zhvillimit të një sistemi të sigurimit të cilësisë.

Objektivi Strategjik/OS 3: Sigurimi i Cilësisë

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ky objektivi strategjik korrespondon me elementin kyç të SZhK-së, dhe lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Ky element, për momentin, kryesisht mungon në sistemin e arsimit në Kosovë, dhe do të jetë themel për çfarëdo progresi në cilësinë e ofrimit të arsimit në të ardhmen. Përveç krijimit të një sistemi të menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimit të proceseve dhe mjeteve përkatëse, ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet do të jetë e nevojshme për ta funksionalizuar çfarëdo sistemi të ri të sigurimit të cilësisë. Për më tepër, në klimën e tanishme në Kosovë, gjithashtu do të jetë e nevojshme edhe aktivitetet e vetëdijesimit që krijojnë një mjedis ku promovohet llogaridhënia. Edhe pse sistemi i sigurimit të cilësisë për arsimin e lartë, dhe, në një farë mase, për arsimin dhe aftësimin profesional, është i veçantë dhe i tanimë ekziston, ky objektivi strategjik është kryesisht i varur nga ndryshimet legjislative. Pas kësaj, kjo lidhet drejtpërsëdrejti në një marrëdhënie të dyanshme me përmirësimin në menaxhimin e arsimit, dhe ka një funksion kyç në sigurimin e suksesit të objektivave të tjera strategjike.

Objektivi Strategjik/ OS 4: Zhvillimi i mësimdhënësve

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Rëndësia e këtij objektivi strategjik është e vetëkuptueshme. Sipas hulumtimeve ndërkombëtare në fushën e arsimit, cilësia e mësimdhënësve është përcaktuesi kryesor i performancës së nxënësve.³⁸ Prandaj fokusi kryesor në këtë fushë është që të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, i cili do të kontribuojë në zbatimin e reformës së shkollave dhe të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Përsëri, ky objektivi strategjik lidhet me të gjitha objektivat tjera në një gamë të gjerë të mënyrave, duke filluar nga ofrimi i programeve të cilat do t'i ndihmojnë mësimdhënësve në zbatimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve në procesin mësimor, deri tek përqendrimi i vëmendjes së shtuar ndaj nxënësve me nevoja të veçanta dhe atyre

³⁸“Ecim: Arsim për zhvillim ekonomik”, dokument nga konferenca, Prishtinë, 17./18.09.2013, GIZ.

të grupeve të marginalizuara (OS 1), ofrimi i trajnimeve për zbatimin e KKK-së (OS 5), dhe ndikimi i kualifikimit të mësimdhënësve para-shërbimit që sigurohet nga institucionet e arsimit të lartë (OS 7).

Objektivi Strategjik/ OS 5: Mësimdhënia dhe të nxënit

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.

Zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat shihet si diçka thelbësore për përmirësimin e cilësisë së të nxënit në Kosovë. Përveç trajnimit të mësimdhënësve, kjo kërkon përgatitjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore, përfshirë materialet elektronike mësimore që janë në harmoni me KKK-në. Kjo, gjithashtu, supozon se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet furnizimit të shkollave me pajisjet e TIK-ut, si dhe me mjete të tjera mësimore. Objektivi lidhet me OS 1 në drejtim të zhvillimit të qasjes dhe gjithëpërfshirjes; me OS 3, veçanërisht lidhur me organizimin e punës së departamenteve të shkollave; dhe me OS 4 për faktin se zbatimi i suksesshëm i kurrikulit të ri varet shumë nga zhvillimi i mësimdhënësve.

Objektivi Strategjik/ OS 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me një numër të nismave kombëtare dhe ndërkombëtare që rrjedhin në mënyrë të veçantë nga strategjia e BE-së 2020. Sa i përket AAP-së, fokusi do të jetë në përmirësimin e ndërlidhjes së programeve shkollore me nevojat e tregut të punës, në zhvillimin e një kurrikule bërthamë të veçantë të AAP-së, e harmonizuar me KKK-në, në sigurimin sistematik të përvojës së punës dhe të praktikës profesionale të cilësisë lartë, dhe, që është specifike për kontekstin e Kosovës, në sigurimin e qëndrueshmërisë së Qendrave të Kompetencës dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Sa i përket arsimit të të rriturve, fokusi duhet të jetë asgjë më pak se krijimi i një sistemi efikas dhe cilësor të arsimit për të rriturit. Ky objektivi strategjik ndërlidhet, në veçanti, me OS 1, duke pasur parasysh se promovimi i barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes duhet të vazhdohet në AAP dhe të plotësohet përmes të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Objektivi Strategjik/ OS 7: Arsimi i Lartë

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Prioriteti kryesor në këtë fushë është përmirësimi i cilësisë në institucionet e AL. Kjo ka shumë aspekte, duke përfshirë përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, nxitjen e hulumtimit shkencor, si dhe ofrimi i ndihmës në punë artistike dhe inovacione në institucionet e AL. Gjithashtu, vëmendje do t'i kushtohet cilësisë së mësimdhënies dhe nevojës për të rritur mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, si dhe pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të AL dhe të hulumtimit shkencor. Edhe pse ky objektivi është, thuajse, i bazuar në nën-sektor, ai është në të vërtetë i lidhur, me një sërë mënyrash, me pjesën dërrmuese të PSAK-ut 2017-2021: për shembull, pjesëmarrjet e ndryshme të studentëve në AL arrihen nëse nxënësit nga grupet e marginalizuara janë të përfshira në një masë të kënaqshme në arsimin parauniversitar (OS 1); trajnimi i mësimdhënësve parauniversitarë është detyra e institucioneve të specializuara të arsimit të lartë, por duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e cilësisë të mësimdhënies (OS 4).

5.2. Alternativat e konsideruara

Ideja e PSAK është që të jetë një strategji gjithëpërfshirëse për sistemin e arsimit në Kosovë, në përputhje me rekomandimet për zbatimin e qasjes tërësoriale në arsim³⁹. Strategjia e parë që është hartuar në pajtim me këto rekomandime, e që mbulon periudhën 2011-2016, është e organizuar sipas nënsektorëve të sistemit të arsimit (Sektori parashkollor, Sektori parauniversitar, Sektori i AAP, Sektori i trajnimit të mësimdhënësve, Sektori i arsimit të lartë, Sektori i arsimit të rriturve, Sektori i TIK-ut). Ndërkaq, në dokumentin e ri strategjik është shfrytëzuar një kombinim i qasjes tematike dhe asaj sektoriale. Siç është shpjeguar në kapitullin 2 janë identifikuar shtatë fusha: 1) Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja; 2) Menaxhimi i sistemit arsimor; 3) Sigurimi i cilësisë; 4) Zhvillimi i mësimdhënësve; 5) Mësimdhënia dhe të nxënit; 6) Arsimi profesional dhe arsimi i të rriturve; dhe 7) Arsimi i lartë. Derisa pesë të parat janë të karakterit tematik, dy të fundit janë të karakterit sektorial. Për këtë arsye ka ekzistuar mundësia që nga ky dokument strategjik të dalin tri dokumente paralele: njëri për arsimin parauniversitar që do t'i përfshinte fushat 1-5, i dyti për arsimin dhe aftësimin profesional, ndërsa i treti për arsimin e lartë. Megjithatë, është konsideruar se një qasje tillë do të binte ndesh me përcaktimin për qasje tërësoriale në arsim, si dhe me politikat qeveritare për reduktimin e numrit të dokumenteve strategjike.

Te objektivi strategjik 1 (“Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja”) si problem qendror paraqitet pjesëmarrja e ulët në edukimin parashkollor. Rruga më e mirë për zgjidhjen në këtë problem do të ishte ndërtimi i një numri të konsiderueshëm të institucioneve parashkollore të specializuara që do të implikonte rritjen e shpenzimeve kapitale dhe hapjen e qindra vendeve të punës në sektorin publik. Për shkak të kufizimeve buxhetore është përzgjedhur qasja tjetër – rritja e pjesëmarrjes në arsimin parafillor që ka shpenzime shumë më të vogla. Po ashtu, do të stimulohet hapja e institucioneve parashkollore private dhe me bazë në komunitet.

Objektivi strategjik 2 (“Menaxhimi i sistemit arsimor”) synon profesionalizimin e rolit të drejtorit të shkollës që paraqet një risi për sistemin e arsimit në Kosovë. Konsiderohet se përmes menaxhimit profesional do të ndikohet në arritjen e të gjitha objektivave të PSAK.

Objektivi strategjik 3 (“Sigurimi i cilësisë”) rregullon ndarjen e përgjegjësisë për cilësinë e arsimit në mes të nivelit qendror (MASHT), nivelit komunal (DKA) dhe shkollës. Alternativa tjetër ka qenë një inspektorat i fuqishëm i arsimit që do të merrte gjithë përgjegjësinë për sigurimin e cilësisë, përderisa komunat dhe shkollat do të zbatonin vendimet e inspektorëve. Është konsideruar se një alternative e tillë është në shpërputhje me karakterin e decentralizuar të sistemit të arsimit në Kosovë dhe nuk do të jepte rezultate të dëshiruara.

Objektivi strategjik 4 (“Zhvillimi profesional i mësimdhënësve”). Dilema kryesore ka qenë nëse duhet insistuar në funksionalizimin e sistemit për licencimin e mësimdhënësve për shkak të mundësive të kufizuara për ndërlidhjen në mes të avancimit profesional dhe pagës. Përfundimi ka qenë se licencimi i mësimdhënësve është një mjet stimulues për përmirësimin e cilësisë dhe, po ashtu, një tregues i cilësisë së mësimdhënies në shkolla.

Objektivi strategjik 5 (“Mësimdhënia dhe të nxënit”) përqendrohet tek zbatimi i kurrikulës së re, tekstet shkollore dhe zbatimin e TIK-ut në arsim. Për të gjitha këto fusha janë analizuar alternativa të shumta. Ideja e kurrikulës së re është që shteti të përcaktojë kompetencat që duhet arritur dhe kurrikulat bërthamë, ndërsa shkollat përmbajtjet mësimore. Në një sistem të tillë, tekstet shkollore

³⁹ MEST: Kosovo Roadmap for improved education sector performance and aid effectiveness, Reports I-III, 2008.

do të duhej të ishin më të përgjithësuara dhe më pak të kontrolluara. Megjithatë, për shkak të rrethanave në shkollat e Kosovës është vendosur që MASHT të jetë i përfshirë në hartimin e përmbajtjeve mësimore, ndërsa tekstet shkollore të jenë në përputhje me ato përmbajtje. Pikërisht për këtë arsye, rëndësi e veçantë i është kushtuar shfrytëzimit të TIK-ut në shkollë, pasi shfrytëzimi i materialeve elektronike rrit mundësinë e zgjedhjes.

Objektivi strategjik 6 (“AAP dhe arsimit të rriturve”). Një dilemë që është ngritur në kuadër të këtij objektivi ka qenë roli i arsimit të rriturve në Strategji. Këtij nënsektori i është dhënë karakteri i arsimit dhe aftësimin profesional, në vend të ngritjes së përgjithshme të nivelit arsimor të popullsisë. Kjo është bërë për shkak të papunësisë së madhe dhe nevojës që ky problem madhor të adresohet përmes aftësimin profesional të rriturve.

Objektivi 7 (“Arsimi i lartë”). Në këtë objektiv, përqendrimi është në sigurimin e jashtëm të cilësisë që realizohet përmes mbështetjes së AKA dhe aplikimit të sistemit për mbledhjen e të dhënave në arsimin e lartë (SMIAL). Alternativa tjetër ka qenë t’i kushtohet më shumë kujdes sigurimit të brendshëm të cilësisë, por, duke pasur parasysh zhvillimet në arsimin e lartë të Kosovës, është konsideruar se kjo nuk do të jepte rezultatin e dëshiruar. Po ashtu, është diskutuar shumë financimi i institucioneve të arsimit të lartë mbi bazë të performancës, i cili nuk është aplikuar deri tani. Përfundimi ka qenë se një sistem i tillë rrit përgjegjësinë e institucioneve të arsimit të lartë për rezultatin e punës së tyre.

6. Objektivi strategjik 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Arsimi, përveç tjerash, është mjet për parandalimin e varfërisë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për fuqizimin e femrës dhe për integrimin e secilit në shoqëri. Sipas UNESCO, arsimi gjithëpërfshirës shihet si proces që adreson dhe i përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënë duke reduktuar përjashtimin në arsim dhe nga arsimi.

Arsimi gjithëpërfshirës ofron mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që shkollat duhen përshtatur për të gjithë fëmijët, pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose faktorëve të tjerë. Gjithëpërfshirja ka për synim minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Prandaj, është e domosdoshme të zbatohen politika dhe praktika arsimore që synojnë procese gjithëpërfshirëse, në veçanti në raport me grupet shoqërore të marginalizuara, siç janë personat me nevoja të veçanta arsimore, komunitetet pakicë, të varfrit, si dhe disa kategori të tjera shoqërore.

Sfidat

Shkalla e ulët e përfshirjes në edukimin parashkollor

Ky segment i arsimit ka mungesë të investimeve, prandaj mungesa e infrastrukturës mbetet shkaktari kyç për përfshirjen e ulët të fëmijëve në këtë nivel. Vetëdijesimi i familjeve dhe politikëbërësve për rëndësinë e edukimit parashkollor është çështje që duhet adresuar edhe në të ardhmen.

Analizën e gjendjes reale të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor e pamundëson mungesa e të dhënave nga institucionet private të pa licencuara dhe nga qendrat e edukimit parashkollor me bazë në komunitet. Fëmijët që vijnë në edukimin parashkollor në më tepër se 40 qendra mësimore⁴⁰ dhe një numër të konsiderueshëm të institucioneve parashkollore private fare nuk përfshihen në të dhënat e SMIA-s, prandaj ende mbetet sfida mbledhja dhe sistemimi i të dhënave të sakta për fëmijët e përfshirë në edukimin parashkollor.

Përfshirja dhe pjesëmarrja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara

Sfidë e madhe mbetet përfshirja në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, në veçanti e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Derisa për shkallën e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta nuk ka të dhëna të sakta, tek fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian vërehet një përfshirje tejet e ulët në edukimin parashkollor dhe të mesëm të lartë, ndërkohë që shkalla e regjistrimit bruto në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9) është rreth 85% që, përsëri, është dukshëm nën mesataren e vendit.

Fenomeni i braktisjes së shkollimit dhe mos-regjistrimit në arsim

Deri në vitin 2014 braktisja ka shënuar rënie të vazhdueshme, por në vitin 2015 dukshëm është rritur numri i fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën, si rezultat i largimit të një numri të madh të familjeve drejt vendeve perëndimore. Refuzimi i lejeve të qëndrimit dhe kthimi prapa i një numri të madh të emigrantëve, lëvizjet e popullatës brenda vendit dhe mospajisja me dokumente përkatëse kanë shkaktuar probleme në regjistrimin e fëmijëve në shkolla. Kjo situatë e aktualizon përsëri

⁴⁰ Qendrat Mësimore i shërbejnë fëmijëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe menaxhohen nga OJQ-të e bazuara në komunitet.

fenomenin e braktisjes dhe të mos regjistrimit në shkolla. Po ashtu, vetëdijesimi i ulët, moskoordinimi në mes të institucioneve, DKA-ve dhe zyrave të regjistrimit civil, ndikon në mos-regjistrim dhe mbetet sfida për t'u adresuar.

Objektivi

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

Zbatimi i politikave dhe praktikave shkollore që synojnë procese gjithëpërfshirëse është parakusht që mundëson rritjen e përfshirjes dhe parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët. Mundësia e barabartë dhe

mundësia për realizimin e potencialit për të gjithë fëmijët janë elementet kryesore të këtij objekti. Rritja e përfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim merr kohë dhe nuk mund të arrihet pa zbatim të plotë të kornizës ligjore. Po ashtu, kjo është çështje komplekse dhe kërkon mobilizimin e shkollave, si dhe të nivelit lokal e atij qendror.

Rezultatet e pritshme:

- 1.1. Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0-5;
- 1.2. Të gjithë fëmijët e moshës 5-vjeçare përfshihen në edukimin cilësor parafillor;
- 1.3. 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar;
- 1.4. Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë për 20%;
- 1.5. Përfshihen të gjithë fëmijët e ri-atdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimin në diasporë;
- 1.6. Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar;
- 1.7. Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike;
- 1.8. Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor.

Çështje të ndërlidhura

Përfshirja e të gjithë fëmijëve në sistemin arsimor dhe parandalimi i braktisjes varen nga menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit (fusha 2). Në veçanti, me krijimi i sistemit të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e të dhënave do të mundësohet përcjellja e fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe e fëmijëve që braktisin shkollimin. Është me rëndësi të monitorohet zbatimi i legjislacionit, planeve kombëtare dhe udhëzimeve ekzistuese. Me avancimin e sistemit për zhvillimin profesional të mësimeve (fusha 4), posaçërisht me ofrimin e programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, shkollat përfitojnë dhe mundësojnë qasje më integruese për të gjithë fëmijët dhe familjet e tyre. Mësimdhënia cilësore duke zbatuar kurrikulën (fusha 5) ju mundëson edukatorëve të klasave parafillore të kuptojnë dhe zbatojnë idetë themelore dhe qëllimet e KKK, si

dhe mundëson organizimin e aktiviteteve mësimore të veçanta për fëmijë me vështirësi në të nxënë në fushat mësimore kyçe, si në nivelin parashkollor, ashtu edhe në atë shkollor.

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 1.1: Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0-5

1.1.1. Stimulimi i hapjes dhe akreditimit të institucioneve private dhe qendrave me bazë në komunitet nga ana e komunave.

Duke pasur parasysh se institucionet parashkollore publike akomodojnë vetëm një numër shumë të vogël të fëmijëve parashkollorë, gjetja e zgjidhjeve stimuluese, sidomos nga DKA-të, që të përkrahen format tjera alternative, do të mundësonte rritjen e përfshirjes së fëmijëve në shërbimet parashkollore.

1.1.2. Hartimi dhe zbatimi i programit për aftësimin e edukatoreve në shërbim që punojnë me fëmijët 0-3.

MASHT, në partneritet me partnerët zhvillimorë, do të organizojë aktivitete të ndryshme për zhvillim profesional të edukatoreve që punojnë me fëmijët 0-3 vjeç, të cilat janë në shërbim dhe kanë të përfunduar vetëm edukimin e mesëm tre apo katër vjeçar.

1.1.3. Zhvillimi i programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme.

Në shumë raste prindërit duhen edukuar për zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Këto programe, sidomos në vendet ku nuk ka ndonjë shërbim parashkollor, do të ndihmojnë prindërit të kuptojnë dhe realizojnë aktivitete të cilat përkrahin zhvillimin e fëmijës edhe në kushte të qëndrimit në shtëpi.

1.1.4. Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e shoqërisë për rëndësinë e edukimin parashkollor.

Shoqëria duhet të njoftohet me ndikimin e edukimit parafillor dhe parashkollor në cilësinë e zhvillimit akademik të fëmijëve në të ardhmen. Shumë prindër ende besojnë se edukimi i fëmijëve vetëm në ambient familjar mjafton për zhvillimin e tyre, prandaj duhet paraparë debate dhe forma tjera të vetëdijesimit që prindërit dhe e tërë shoqëria të kuptojnë rëndësinë e edukimit parashkollor.

1.1.5. Pilotimi i kurrikulës së re parashkollore.

Kurrikula e re parashkollore duhet të monitorohet dhe të bëhet vlerësim i saj. Po ashtu, duhet të zhvillohen materiale për mësimdhënie dhe të nxënë, të përshtatshme për grup-mosha të ndryshme.

1.1.6. Zbatimi dhe monitorimi i kompetencave për edukatore 3-5.

Pasi që ekziston sistemi i mirëfilltë për monitorimin e edukatoreve sipas kompetencave të tyre, i cili mundëson sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë, atëherë është e nevojshme organizimi i monitorimit të edukatoreve duke u bazuar në këtë sistem.

Rezultati 1.2: Të gjithë fëmijët e moshës 5-vjeçare përfshihen në edukimin cilësor parafillor

1.2.1. Hapja e klasave të reja parafillore.

Hapja e klasave të reja edhe organizimi i punës në klasat parafillore që veprojnë në shkolla fillore, institucione parashkollore dhe qendra të komunitetit (të bazuara në kritere të qarta

dhe përmes një procesi transparent të licencimit), si dhe puna në dy ndërrime e më tepër do të mundësojë rritjen e përfshirjes së numrit të fëmijëve në arsimin parafillor.

1.2.2. Aftësimi i edukatoreve për zbatimin e kurrikulës.

Trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re do të mundësojnë unifikimin e planeve të punës me fëmijët parafillorë, si në klasa parafillore, ashtu edhe në kopshte, të cilat do të shërbenin si parapërgatitje për klasën e parë.

1.2.3. Hartimi i materialeve mësimore dhe didaktike të posaçme për klasën parafillore.

Për të siguruar cilësinë e edukimit parafillor, si dhe për të unifikuar punën edukative në klasat parafillore dhe në kopshte është i domosdoshëm hartimi i materialeve mësimore dhe didaktike për këtë moshë. Këto materiale duhen të ndihmojnë fëmijët të përgatiten për sfidat që pritet t'i kenë në të ardhmen, në shkollën fillore.

1.2.4. Krijimi i mekanizmit për monitorimin e cilësisë në edukimin parafillor sipas kompetencave të edukatoreve.

Që të përcillet zhvillimi i cilësisë në të gjitha institucionet parashkollore dhe klasat parafillore duhet të ketë monitorim i cili vlerëson performancën e tyre. Këtë e mundëson zbatimi i sistemit të monitorimi të edukatoreve sipas kompetencave i cili ndihmon në sigurimin e cilësisë.

Rezultati 1.3: 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar

1.3.1. Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për fëmijët me nevoja të veçanta për SMIA.

Grupi punues definon treguesit për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

1.3.2. Funkcionalizimi i ekipeve vlerësuese pedagogjike.

Ekipeve vlerësuese të përbëra nga pedagogë, psikologë, specialistë dhe mësimdhënës vlerësojnë nevojat pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përcaktojnë orientimin dhe shërbimet të cilat do të ofrohen për ta në institucionet arsimore. Duhet të bëhet aftësimi i ekipeve pedagogjike për vlerësim të nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe për hartimin e instrumenteve vlerësuese.

1.3.3. Trajnimi i personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës.

Edhe pse një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve ka kaluar nëpër programe të ndryshme të trajnimit për gjithëpërfshirje, drejtësi shoqërore, diversitet etnik, kulturor, fetar, gjuhësor, etj. kjo nuk mjafton që shkollat të kenë qasje gjithëpërfshirëse. Prandaj, që shkollat të jenë të hapura dhe të trajtojnë secilin nxënës në mënyrë të barabartë, duhet që çdo mësimdhënës të ketë njohuri dhe shkathtësi për të siguruar gjithëpërfshirje në arsim. Ky aktivitet është adresuar te aktiviteti 4.1.10 i fushës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Trajnimi duhet të përfshijë promovimin e barazisë gjinore në të gjitha mjediset arsimore për të gjitha nivelet e arsimit.

1.3.4. Shndërrimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma burimore.

Integrimi i nxënësve nga klasat e bashkëngjitura në klasa të rregullta ndikon në socializmin dhe përfitimin arsimor të tyre. Dhomat burimore ndihmojnë shkollat në zhvillimin e aktiviteteve sociale brenda shkollës dhe me komunitetin jashtë saj.

1.3.5. Fuqizimi i mekanizmave për mbështetjen e shkollës.

Rritja e numrit të mësimeve mbështetës në shkolla krijon mundësi që të përkrahët një numër më i madh i fëmijëve me nevojë të veçanta dhe vështirësi në të nxënë.

Rezultati 1.4: Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë për 20%

1.4.1. Harmonizimi i programeve të qendrave mësimore.

Edhe pse kemi një numër të konsiderueshëm të qendrave mësimore, rreth 40 syresh, ato punojnë me programe të ndryshme. Përmes vënies së kontaktit në mes të qendrave, këto programe duhet të harmonizohen, duke i përshtatur me nevojat e komunitetit të synuar.

1.4.2. Hartimi i rregulloreve nga komunat për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe arsimit të mesëm.

Duke marrë parasysh se në nivelin parashkollor kemi përfshirje tejet të ulët të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian duhet marrë masa për lehtësimin e regjistrimit të tyre në këtë nivel, si dhe për ofrimin e kushteve më të volitshme financiare për të siguruar vijimin e rregullt, e që nënkupton subvencionimin e pagesës për vijim. Ndërkaq, në shkollimin e mesëm të lartë, ku pjesëmarrja e këtyre komuniteteve është, po ashtu, shumë e ulët, përveç lehtësirave në regjistrim, duhet shqyrtuar mundësi për ofrimin e bursave për shkollim. Përveç kësaj, dallimet gjinore duhet të shqyrtohen dhe të përfshihen në rregulloret komunale për përkrahjen e regjistrimit dhe vijimit të djemve dhe vajzave në të dyja nivelet e arsimit, parashkollor dhe atë të mesëm.

1.4.3. Monitorimi i zbatimit të masave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parashkollor dhe në shkolla të mesme të larta.

MASHT do të monitorojë dhe inspektojë zbatimin e masave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve, si dhe do të sigurojë zbatimin e tyre.

1.4.4. Trajnimi i mësimeve për mësime në gjuhën rome.

Në shkollat ku vijnë mësime fëmijët rom dhe ku ofrohet mësimi zgjedhor i gjuhës rome, mësimeve në gjuhën rome duhet trajnuar që të përdorin tekstet e gjuhës rome të ofruara nga MASHT-i. Ky aktivitet është adresuar te aktiviteti 4.1.12 i fushës së zhvillimit profesional të mësimeve.

1.4.5. Organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat.

DKA-të, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, duhet të njoftojnë prindërit për rëndësinë e regjistrimit dhe vijimit të shkollimit. Aktivitetet duhet të pasqyrojnë saktë nevojat, shqetësimet dhe sfidat e ndryshme me të cilat përballen djemtë dhe vajzat e që ndikojnë në regjistrimin dhe vijimin e shkollës, dhe nëse vajzat ballafaqohen me ndonjë pengesë të posaçme përkitazi me regjistrimin fillestar.

Rezultati 1.5: Përfshihen të gjithë fëmijët e ri-atdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimi në diasporë

1.5.1. Monitorimi i zbatimit të legjislacionit për të ri-atdhesuarit nga grupi mbikëqyrësi i MASHT-it.

Grupi mbikëqyrës i MASHT në bashkëpunim me DKA-të dhe ZKKR-të⁴¹ përcjell zbatimin e legjislacioni për të rikthyerit nga shkollat.

1.5.2. Hartimi i planeve individuale për nxënësit e ri-atdhesuar.

Nxënësit e ri-atdhesuar, sapo të përfshihen në sistem arsimor, duhet të kenë plane individuale për t'u integruar sa më shpejtë dhe më lehtë në procesin mësimor. Këto plane duhet të hartohen nga shkollat, në bashkëpunim me prindërit dhe shërbimet e tjera sociale.

1.5.3. Rishikimi i programit për të ri-atdhesuarit.

Programi për të ri-atdhesuarit i cili në vete përmban librin e nxënësit dhe udhëzuesin për mësimdhënës të hartuar nga Këshilli i Evropës duhet rishikuar dhe t'i përshtatet rrethanave aktuale. Mund të nevojiten materiale shtesë.

1.5.4. Trajnimi i mësimdhënësve dhe zyrtarëve komunalë për programin për të ri-atdhesuarit.

Komunat të cilat kanë numër më të madh të fëmijëve të ri-atdhesuar duhet paraparë të përfshijnë mësimdhënësit dhe zyrtarët në programe trajnimi të cilat do të lehtësonin punën dhe do të përkrahnin këta fëmijë. Ky aktivitet është adresuar te aktiviteti 4.1.12 i fushës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

1.5.5. Koordinimi dhe monitorimi i mësimi plotësues nga grupi mbikëqyrës i MASHT-it.

Procesi i monitorimit të mësimi plotësues siguron ofrimin e shërbimeve cilësore për personat e ri-atdhesuar.

1.5.6. Organizimi i aktiviteteve për nxënësit e diasporës.

MASHT në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës do të organizojnë aktivitete të ndryshme arsimore dhe rekreative për nxënësit e diasporës që vizitojnë Kosovën në mënyrë të organizuar. MASHT-i do të nxisë dhe përkrahë krijimin e binjakëzimeve në mes të shkollave të Kosovës dhe të atyre që organizojnë mësimin në diasporë.

Rezultati 1.6: Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalim e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar

1.6.1. Ngritja e kapaciteteve të ekipeve parandaluese në nivel, shkolle, komune dhe në nivelin qendror.

Të gjitha komunat duhet të themelojnë ekipet e EPMPB⁴² në nivel shkolle dhe komune. Anëtarët duhet të trajnohen për zbatimin e dokumenteve ekzistuese që adresojnë çështjet e braktisjes dhe të mosregjistrimit në shkollim.

1.6.2. Rishikimi i rolit të EPMPB.

Pasi që EPMPB merren vetëm me shkollimin e obligueshëm, duhet të rishikohet dhe të analizohet edhe roli i tyre në nivelin e arsimit të mesëm, meqë në këtë nivel të shkollimit është më e pranishme dukuria e braktisjes.

⁴¹ Zyrrat komunale për komunitete dhe të rikthyer.

⁴² EPMPB – Ekipet për reagim ndaj mosregjistrimit dhe parandalim të braktisjes.

1.6.3. Përmirësimi i grumbullimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë për braktisje dhe mos regjistrim.

Duhet të rishikohen treguesit dhe të përcaktohen procedurat standarde operative për të siguruar grumbullimin e të dhënave të besueshme. Duhet të zhvillohen dhe zbatohen instrumentet e paralajmërimit të hershëm për parandalimin e braktisjes së shkollës (si për shembull veprimi lidhur me mosvijimin në shkollë), dhe duhet të saktësohen të dhënat për braktisje dhe mosregjistrim bashkë me instrumentet për paralajmërim të hershëm të braktisjes. Çfarëdo dallimi gjinor duhet të pasqyrohet në përqindjen e braktisjes dhe ndikimin e intervenimit për të ulur shkallën e braktisjes dhe të mosregjistrimit.

1.6.4. Krijimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat.

Shkollat, në bashkëpunim me komunat, duhet të hartojnë plane veprimi për parandalimin e braktisjes, si pjesë e planeve zhvillimore të shkollave/ komunave me raportim të rregullt tek MASHT-i. Duhet të shqyrtohet mundësia për organizimin e mësimit alternativ (p.sh. të mësuarit në distancë) për nxënësit që, për arsye të ndryshme specifike, nuk mund të vijnë në mësimin e rregullt (p.sh. nxënësit e hospitalizuar, etj).

1.6.5. Vetëdijësimi i popullatës për arsimimin e kategorive tjera të rrezikuara.

Fushatat avokuese, debatet, klipet në TV janë disa forma vetëdijesuese për arsimimin e kategorive të rrezikuara.

1.6.6. Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të arritur në zbatim të politikave që adresojnë braktisjen dhe mos-regjistrimin, si dhe paralajmërimin e hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes.

MASHT, në bashkëpunim me komunat, shkollat dhe partnerët e tjerë do të bëjë zbatimin e politikave përkatëse, do të monitorojë progresin, vlerësojë dhe raportojë për braktisjen dhe mos-regjistrimin në shkollë.

1.6.7. Organizimi i mësimit të përshpejtuar për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë.

MASHT-i, në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë, do të organizojë mësimin e përshpejtuar për nivelin fillor dhe të mesëm të ultë për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë.

Rezultati 1.7: Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike

1.7.1. Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave dhe programeve identifikuese dhe mbështetëse për fëmijë me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta.

Pasi që te ne shumë pak evidentohen fëmijët me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta duhet të zhvillohen mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e këtyre fëmijëve.

1.7.2. Trajnimi i mësimeve dhe psikologëve shkollorë për punën me fëmijë me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta.

Që këta fëmijë të përkrahen dhe të zhvillohen në bazë të nivelit individual të zhvillimit, dhe talentit të tyre duhet të aftësohen mësimeve dhe psikologët shkollorë për të punuar me ta.

1.7.3. Stimulohen fëmijët me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta.

Niveli lokal dhe ai qendror duhet paraparë sigurimin e formave stimuluese për këta fëmijë.

1.7.4. Bashkëpunimi me qendra dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë.

Rezultati 1.8: Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor

1.8.1 Zhvillohet strategji për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve

Kjo përfshin udhëzimet për aktivitete kurrikulare e jashtëkurrikulare për shkollat që ndiqen nga komunitetet e ndryshme ose ndërmjet shkollave të ndryshme.

1.8.2 Rishikimi i dispozitave për mësimeve në gjuhë

Aktualisht, mundësitë e mësimit të gjuhës janë të kufizuara dhe nuk ka mundësi që nxënësit të mësojnë gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla. Për më tepër, për ato komunitete që nuk ndjekin shkollimin në gjuhën e tyre amtare, nuk ka mundësi që të studiojnë gjuhën e tyre amtare si lëndë (ky opsion aktualisht ofrohet vetëm për pjesëtarët e komunitetit rom). Ky aktivitet i ri do të mund të lejonte zhvillimin e mësimeve në gjuhë në baza jashtëkurrikulare.

1.8.3 Masat për përmirësimin e mësimeve në gjuhën shqipe si gjuhë e dytë

Gjuha shqipe si gjuhë e dytë është lëndë zgjedhore në shkollat me mësime në gjuhën boshnjake apo turke. Megjithatë, nuk ka ndonjë aftësim për mësimeve për specifikat e mësimeve në gjuhën shqipe si gjuhë e dytë, e as nuk ka libra shkollorë të mjaftueshëm. Pra, propozohet që masat të përfshijnë zhvillimin e programeve të specializuara të aftësimin të mësimeve për gjuhën shqipe si gjuhë e dytë, por edhe hartimin e librave përkatës shkollorë.

1.8.4 Zhvillimi i moduleve arsimore specifike për komunitete

Neni 8 (7) i Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë thekson që komunitetet kanë të drejtë për module arsimore specifike për komunitete, në kuptimin e historisë dhe traditave të tyre, për të mundësuar ruajtjen e kulturës, identitetit dhe/ose gjuhës së tyre. Deri më sot, këto module janë zhvilluar për komunitetet boshnjake, turke e romë. Planifikohet vlerësimi i nevojave për zhvillimin e moduleve të tilla për komunitetet tjera numerikisht më të vogla në Kosovë.

1.8.5 Zhvillimi i një politike për organizimin e mësimeve për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit

Mësimeve për të gjithë nxënësit mbi komunitetet që jetojnë në Kosovë, identitetet e tyre dhe rëndësinë e respektimit të diversitetit dhe pluralizmit, duhet të inkorporohet në të gjitha fushat lëndore që mbulohen me kurrikulë.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Shkollat hartojnë dhe ofrojnë programe për përkrahje të nxënësve të cilët kanë ngecje në mësim.
- Shkollat hartojnë plane për përfshirjen e nxënësve të ri-athtësuar.
- Gatishmëria e institucioneve qendrore e lokale për përkrahjen e fëmijëve/nxënësve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Mosgatishmëria e komunave për të stimuluar përkrahjen e institucioneve private, dhe qendrave me bazë në komunitet.
- Mosorganizimi i programit për rikualifikimin e edukatoreve në shërbim 0-3 nga ana e Fakultetit të Edukimit.
- Mosfunksionalizimi i ekipeve vlerësueses për fëmijët me nevojat ë veçanta nga ana e DKA-ve.
- Qendrat mësimore rrezikohen të mbyllen për shkak të mos sigurimit të qëndrueshmërisë.
- Mungesa e gatishmërisë së komunave për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe të mesëm.
- Mosangazhimi i ekipeve në nivel shkolle dhe komune për të parandaluar braktisjen.
- Mungesa stimulimeve për fëmijët me inteligjenca të jashtëzakonshme me bursa të veçanta nga ana e komunave.
- Dështimi për të mbledhur në mënyrë sistematike të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe për të mbështetur përdorimin e tyre në arritjen e objektivave të përcaktuara.

7. Objektivi strategjik 2: Menaxhimi i sistemit arsimor

Menaxhimi i sistemit arsimor, në çfarëdo rrethane, paraqet instrumentin kryesor që siguron planifikimin dhe realizimin e politikave të caktuara, si dhe përcaktimin e proceseve që shpijnë drejt sigurimit të funksionimit të të gjitha hallkave në sistemin arsimor.

Shpeshherë, menaxhimi i sistemit arsimor kufizohet në qasjen administrative, duke siguruar që rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë të jenë të përcaktuara qartë. E tillë është qasje që siguron ruajtjen e vazhdimësisë dhe gjendjes aktuale, ndërsa sistemet e arsimit që synojnë reforma më të thella angazhohen për një qasje më proaktive të menaxhimit, duke synuar arritjen e ndryshimeve të dëshiruara. Literatura dhe praktikat e mira bashkëkohore sugjerojnë që fuqizimi i nivelit të shkollës dhe angazhimi i saj në përcaktimin dhe realizimin e reformave arsimore është parakusht për sukses të vet reformës, që do të thotë se drejtorët e shkollave nuk janë, thjeshtë, vetëm menaxherë të burimeve njerëzore dhe materiale, por ata duhet të shndërrohen në shtyllë dhe motor të cilësisë së arsimit në shkollat e tyre. Këto kërkesa definojnë profilin e drejtorëve të shkollave si profesionistë me aftësitë menaxheriale dhe me përvojë në arsim.

Në rrethanat ku sistemi i arsimit është i decentralizuar, parakusht për realizimin e ndryshimeve në arsim, krahas sigurimit të autonomisë financiare dhe profesionale brenda kompetencave të përcaktuara, mbetet zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese, qoftë në nivel lokal apo të shkollës, transformimi i shkollës në organizatë të të nxënit, ku drejtori i shkollës jep llogari dhe është përgjegjës për këtë proces. Në secilin sistem të arsimit, e sidomos në ato që synojnë fuqizimin e nivelit të shkollës, sfidë kryesore mbetet vendosja e mekanizmave të llogaridhënies dhe efektshmëria e zbatimit të politikave arsimore që përcaktohen nga niveli i politikë-bërësve. Decentralizimi nuk mund të funksionojë pa transparencë dhe llogaridhënie. Andaj, instrumentet e menaxhimit të sistemit të arsimit duhet të vendosen në funksion të mbështetjes, monitorimit dhe ridefinimit të proceseve dhe politikave që i shërbejnë këtij qëllimi.

Sfidat

Kapacitete të pamjaftueshme në nivel qendror, komunal dhe të shkollës

Sistemi i arsimit në Kosovë ka shënuar progres në decentralizimin e kompetencave nga niveli qendror në nivel komunal dhe në nivel shkolle, duke synuar mobilizimin dhe përkushtimin e të gjitha palëve në proces për efektshmëri në realizimin e misionit të sistemit të arsimit. Në një kontekst të ndryshimit të roleve, përgjegjësive dhe pritjeve, të kombinuar me një nivel të lartë të ndërrimit të personelit, nevoja për shkathtësi të shtuara menaxheriale në të gjitha nivelet theksohet edhe më shumë ndërsa qasja e koordinuar dhe koherente e veprimeve në të gjitha nivelet bëhet parakusht për suksesin.

Mungesa e koherencës në fushën e legjislacionit dhe politikave

Legjislacioni mbetet mekanizmi kryesor për përcaktimin e modaliteteve të funksionimit të sistemit të arsimit dhe politikave kryesore në sistem. Nevoja për zhvillime dhe modifikim të proceseve arsimore nënkupton edhe nevojën e modifikimit të legjislacionit ekzistues apo edhe zhvillimin e pjesëve të reja të legjislacionit. Sfidat mbetet sigurimi i qasjes koherente të pjesëve të ndryshme të legjislacionit primar dhe sekondar dhe sigurimi i qasjes koherente të zbatimit të politikave arsimore. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit nga niveli ekzekutiv dhe legjislativ lë shumë për të dëshiruar.

Mungesa e profesionalizmit menaxherial dhe e autonomisë shkollore

Për, pothuajse, një dekadë pas përfundimit të luftës në Kosovë, funksionimi i institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese (shkollave) në Kosovë është zhvilluar brenda një sistemi të centralizuar të arsimit. Ideja e bartjes së kompetencave në nivel shkolle ndërlidhet ngushtë me synimin e fuqizimit të shkollës. Shtytja e shkollës drejt zhvillimit të saj si organizatë e të nxënit paraqet hapin kryesor në mobilizimin e komunitetit shkollos drejt avancimit të cilësisë së shërbimeve në shkollë. Rekrutimi i menaxherëve të shkollave që kanë një bazë profesionale në fushën e arsimit, të menaxhimit dhe të udhëheqjes është hap me rëndësi drejt arritjes së synimit që shkollat të jenë përgjegjëse për zhvillimin e vet. Zhvillimi i bazës legislative apo ndryshimi i legjislacionit ekzistues për të mundësuar transformimin e shkollave në organizata të të nxënit, duke mundësuar autonomi të shtuar financiare dhe profesionale, do të jetë thelbësor për suksesin e kësaj qasjeje. Pra, sfida mbetet sigurimi i kushteve dhe kapaciteteve për fuqizimin e autonomisë së shkollës dhe vendosja e menaxhimit profesional në shkollë, e që shpie drejt arritjes së këtij synimi.

Vendimmarrje jo e bazuar në të dhëna

Shpeshherë nuk dihet qartë burimi i politikave të caktuara arsimore. Ose, edhe me shqetësuese janë situatat kur politikat arsimore formulohen duke mos u bazuar në informatën e duhur, e që përfshin edhe praktikën e përcaktimit të politikave bazuar në intuitën e individëve ose të grupeve të caktuara përgjegjëse. Të dhënat (statistikat) nga terreni, si dhe të gjeturat nga hulumtimet vendore e ndërkombëtare, mund të jenë burime nga të cilat informohet procesi i formësimit të politikave të caktuara arsimore. Ose, thënë ndryshe, realiteti në terren që na paraqitet përmes statistikave, si një burim informacioni, do të duhej të influenconte natyrën dhe llojin e politikave arsimore. Andaj, sfida e ndërtimit të një sistemi të menaxhimit të informatave në arsim nuk duhet të kufizohet në nivelin e mbledhjes së të dhënave. Në fakt duhet të përfshijë analizën dhe interpretimin e të dhënave me qëllim të shfrytëzimit të tyre për marrjen e vendimeve dhe politikë-bërje.

Kushtet jo të mira dhe mjedisi jo i përshtatshëm për mësim cilësor

Mjedisi duhet të perceptohet nga këndvështrimi i sigurimit të kushteve infrastrukturore për mësim, duke përfshirë hapësirën e mjaftueshme dhe adekuate, inventarin e përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxënë, si dhe ofrimin e një mjedisi të sigurt, të shëndetshëm dhe, mbi të gjitha, miqësor. Meqë në vitet e fundit fokusi ishte vendosur në rritjen e hapësirës fizike për mësim, në vitet vijuese sfida mbetet të punohet që, krahas rritjes së vazhdueshme të hapësirës shkollore, të sigurohet menaxhim dhe mirëmbajtje adekuate e infrastrukturës dhe krijim i mjediseve më të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore.

Objektivi

Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

Prioritetet kryesore në këtë fushë mbetet ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese në nivel qendror, komunal dhe të shkollës. Në nivelin e shkollës përfshihen edhe strukturat si këshilli drejtues i shkollës, këshilli i prindërve

etj. Profesionalizimi i rolit të menaxherëve të institucioneve edukative-arsimore është prioritet i rëndësisë së madhe që duhet ndërtuar mbi punën e bërë në vendosjen e standardeve të praktikës profesionale të drejtorëve dhe ngritjen e standardeve të rekrutimit të drejtorëve. Prioritet tjetër mbetet, po ashtu, edhe avancimi i mekanizmit të financimit të arsimit parauniversitar, në mënyrë që të adresohen specifikat e ndryshme të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese për të

mundësuar aktivitete zhvillimore. Avancimi i sistemit aktual të menaxhimit të të dhënave në sistemin e arsimit dhe shfrytëzimi i tyre në politikëbërje do të mbetet një prioritet tjetër në periudhën vijuese. Nga këndvështrimi infrastrukturor prioritet i periudhës vijuese konsiderohet sigurimi dhe mirëmbajtja e hapësirës së mjaftueshme funksionale dhe mjedisit të sigurt dhe të shëndetshëm. Fuqizimi i rolit të prindërve dhe komunitetit në procesin e vendimmarrjes në shkollë, si dhe fuqizimi i mekanizmave të llogaridhënies në sistem të arsimit, do të jenë hallka kryesore e zhvillimit të sistemit të arsimit në Kosovë për periudhën vijuese.

Çështje të ndërlidhura

Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit ndërlidhet, në radhë të parë, me vetëdijesimin e palëve në sistem për reformat arsimore që janë në proces. Krijimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe të kontrollit do të duhej të jetë parim udhëzues i ndërtimit të kapaciteteve menaxhuese në sistem. Për më shumë, decentralizimi i kompetencave të sistemit të arsimit varet edhe nga përkushtimi dhe kapacitetet e organeve udhëheqëse në nivel shkolle si: këshilli drejtues i shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve dhe komuniteti akademik i shkollës. Një temë e rëndësishme në zhvillimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të arsimit janë edhe mundësitë e barabarta dhe inkurajimi i përfshirjes së gruas në pozita menaxhuese. Po ashtu, menaxhimi i sistemit të arsimit duhet të adresojë edhe aspektet e tjera si gjithëpërfshirja dhe cilësia si parime bazë në ndërtimin e mekanizmave për menaxhimin e sistemit arsimor. Fuqizimi i shkollës si organizatë duhet të ndërlidhet edhe me aktivitetet e sigurimit të cilësisë (fusha 3) në mënyrë që të bëhet lidhja dhe koherenca midis këtyre nismave.

Rezultatet e pritshme:

- 2.1. Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe llogaridhënës të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle;
- 2.2. Përcaktohen standardet profesionale për rekrutim dhe mekanizma për menaxhimin e karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore;
- 2.3. Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës;
- 2.4. Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje;
- 2.5. Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar për të reflektuar ndryshimet në legjislacion dhe politikat tjera;
- 2.6. Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurt, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë;
- 2.7. Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të objekteve shkollore që i kontribuon krijimit të mjediseve të përshtatshme për mësim.
- 2.8. Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor.

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 2.1: Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe llogaridhënës të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle

2.1.1 Ristrukturimi i organizimit të DKA-ve në përputhje me strukturën e decentralizuar të sistemit të arsimit.

Për shkak të madhësive të ndryshme të komunave, burimet e tyre për arsim dallojnë në mënyrë të konsiderueshme. Ideja është që personeli aktual të shfrytëzohet në mënyrë sa më efikase për t'iu përshtatur përgjegjësi të reja në fushën e zhvillimit të arsimit në nivel komunal. Prandaj, modelet e ndryshme për strukturë organizative të DKA-ve do të mund t'i udhëzojnë komunitat ta përforcojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, në veçanti ndërmjet komunave më të vogla. Zbatimi do të bëhet në bashkërendim me ministrinë gjegjëse.

2.1.2 Trajnimi i personelit të DKA-ve sipas nevojave të identifikuar dhe në përputhje me strukturën e decentralizuar të sistemit të arsimit.

Aktivitetet duhet të ndërtojnë mbi aktivitete të deritanishme dhe duhet të orientohen drejt fushave më specifike të përgjegjësi profesionale të DKA-ve, reformës kurrikulare dhe politikave të tjera si aktivitetet e sigurimit të cilësisë. Kjo do të bazohet në vlerësimin e nevojave të DKA-ve për zhvillim të kapaciteteve.

2.1.3 Hartimi i rregulloreve dhe udhëzuesve mbështetës për menaxhimin e arsimit në nivel komunal.

Duke pasur parasysh kontekstin aktual të bartjes dinamike të përgjegjësi në nivel komune, një udhëzues standard do të duhej t'i dokumentonte të gjitha rregulloret dhe ligjet ekzistuese e të reja që përcaktojnë fushëveprimin dhe punën e DKA-ve. Udhëzuesi duhet të azhurnohet së paku një herë në vit. Ai duhet të përmbajë një numër udhëzuesish që adresojnë fushat specifike të menaxhimit të sistemit të arsimit që do t'i shërbente koordinimit më të mirë.

2.1.4 Trajnimi i personelit të MASHT për planifikim, politikëbërje dhe monitorim.

Këtu do të merren parasysh aktivitete që janë realizuar në të kaluarën në këtë fushë, duke synuar një fokus më të theksuar në politikëbërje, planifikim, zbatim dhe monitorim, si dhe duke ndërlidhur me nën-sektorët e ndryshëm në sistem.

2.1.5 Zhvillimi i mekanizmave për komunikim efektiv midis palëve të ndryshme në sistem përmes raportimit dhe proceseve të tjera të rregullta koordinuese.

Aktivitetet e kësaj natyre do të orientohen drejt zgjerimit të aktiviteteve koordinuese që praktikohen aktualisht, e në funksion të koordinimit dhe raportimit më përmbajtësor. Takimet MASHT – DKA do të mund të transformohen në forume të rregullta me nën-tema të caktuara e, po ashtu, edhe takimet me palët e tjera në proces. Ndërsa, raportimet do të mund të shkonin përtej raporteve formale dhe statistikore, por me analiza më përmbajtësore. Raportet vjetore të MASHT do të përgatiten në formë të analizave të funksionimit të sistemit dhe do të bazohen në të dhëna empirike dhe statistikore, si dhe në të gjetura të hulumtimeve vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa do të publikohen sipas nevojës për audience të brendshme dhe publikun.

2.1.6 Funksionalizimi dhe fuqizimi i këshillave të prindërve në nivel shkolle, komune dhe shteti përmes ofrimit të mbështetjes për punën e tyre dhe monitorimin e punës së tyre.

Pjesëmarrja e prindërve është, shpesh, një rrugë e shkurtër për disa kontribute vullnetare për funksionimin e shkollës. Arsimi, në fakt, ka nevojë për partneritetin ndërmjet mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. Prindërit duhet të jenë të përfshirë në procesin arsimor: të mbështesin vijimin e rregullt, të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, të shprehin pritjet e tyre në pyetjet e menaxhmentit. Prindërit duhet të informohen lidhur me të drejtat e tyre dhe të motivohen që, në mënyrë aktive të kontribuojnë në zhvillimin e plotë të fëmijës dhe në përmirësimin e rezultateve të shkollës. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar përfaqësimit dhe angazhimit të prindërve nga komunitetet jo-shumicë.

2.1.7 Trajnimi i personelit administrativ dhe anëtarëve të organeve drejtuese të shkollës për qeverisje dhe udhëheqje.

Trajnimet e Këshillit Drejtues do të jenë të orientuara drejt fuqizimit të rolit të tyre në vendimmarrje dhe mbikëqyrje, si dhe në rritjen e llogaridhënies në shkollë.

2.1.8 Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe të komunikimit në mes të shkollave në fushën e udhëheqjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve (Komuniteti i të nxënësve).

Rrjetet e shkollave janë një qasje efektive, (pothuajse) pa kosto shtesë, për shkëmbim të ndërsjellë të përvojave dhe të nxënësve në mes të shkollave. Përvojat e para janë shumë premtuese dhe tregojnë ndryshime të konsiderueshme pozitive. Kjo qasje duhet të shtrihet në mbarë vendin.

2.1.9 Fuqizimi i qasjes së integruar në planifikim midis MASHT – DKA – Shkollë.

PSAK-u është një strategji themelore që ofron bazën konkrete për planifikim për të gjitha nivelet. Zbatimi i suksesshëm i PSAK-ut do të varet shumë nga koordinimi dhe bashkëpunimi i mirë në mes të niveleve qendrore, lokale dhe të shkollës. Kjo është arsyeja pse zbatimi i PSAK-ut duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve të rregullta të punës - në MASHT, në DKA dhe në shkollë. Qasja e Planifikimit të Integruar të Qeverisë së Kosovës ofron një mënyrë të përshtatshme për të krijuar ndërlidhje në mes të niveleve të ndryshme: planifikimi i nivelit të MASHT-it, DKA-ve dhe nivelit të shkollës duhet të jenë të ndërlidhura si nga poshtë-lart, ashtu edhe nga lart-poshtë, Plani Zhvillimor i Shkollës dhe Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit duhet të përfshijnë referenca për PSAK-un. Raporte të rregullta mbi progresin dhe problemet duhet të informojnë MASHT-in për gjendjen e zbatimit të PSAK-ut: në këtë mënyrë MASHT-i mund të veprojë për progresin dhe të sigurojë zbatimin e plotë.

2.1.10. Menaxhimi i rrjetit të shkollave

MASHT organizon procesin e planifikimit të rrjetit të shkollave duke marrë parasysh të dhënat mbi gjendjen infrastrukturore, trendet demografike në vend dhe në bazë të konsultimeve me të gjitha drejtoritë komunale të arsimit për të përcaktuar modelin më efektiv të menaxhimit të rrjetit të shkollave.

2.1.11. Fuqizimi i autonomisë së shkollës

Kjo ka të bëjë me rishikimin e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimet Administrative përkatëse për të fuqizuar vendimmarrjen në nivel shkolle sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe menaxherëve të institucioneve edukative-arsimore. Ky decentralizim i mëtejshëm do të jetë në harmoni me

idenë e decentralizimit të kompetencave kurrikulare në nivel shkolle si dhe planifikimet për vlerësimin e shkollës si pjesë e iniciativës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Rezultati 2.2: Përcaktohen standardet profesionale për rekrutim dhe mekanizma për menaxhimin e karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore

2.2.1 Përcaktimi i statusit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukative-arsimore.

Në bazë të legjislacionit në fuqi nevojitet sqarim i pozitës së menaxherëve të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese dhe, në rast nevojë, edhe zhvillimi dhe rishikimi i legjislacionit për ta bërë pozitën e drejtorit pozitë karriere profesionale.

2.2.2 Krijimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve.

Vazhdimi i kontratës së drejtorëve do të bëhet në bazë të një vlerësimi të performancës që i bëhet nga Këshilli i Drejtues i Shkollës dhe DKA, sipas kornizave të përcaktuara nga niveli i MASHT.

2.2.3 Funksionalizimi i mekanizmave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve duke përfshirë trajnimin e komisioneve përzgjedhëse.

Mekanizmat e zhvilluar në periudhën e shkuar do të duhej të funksionalizohen në shkallë vendi për të siguruar se përzgjedhja e drejtorëve të shkollës është e orientuar drejt standardeve të zbatueshme të performancës për këtë profesion.

2.2.4 Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të karrierës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në bazë të standardeve të aplikueshme.

Duhet të krijohet baza ligjore e menaxhimit të karrierës së drejtorëve të shkollave duke përfshirë standardet e performancës në faza të ndryshme, instrumentet e monitorimit të performancës së tyre dhe modalitetet e ngritjes në karrierë.

2.2.5 Ofrimi i qasjes së barabartë për gratë dhe burrat në programet e zhvillimit profesional të drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve dhe mësimdhënësve që synojnë karrierë menaxhimi duke siguruar një ofertë gjithëpërfshirëse dhe financim të qëndrueshëm.

Duhet të përcaktohet një mekanizëm i akreditimit të programeve për drejtorët e shkollave dhe menaxherët, dhe të caktohet mekanizmi i financimit të programeve për menaxherë dhe ata që synojnë këtë karrierë, duke përfshirë personelin që punon në gjuhët e komuniteteve. Kjo implikon zgjerimin e ofertës aktuale të programeve për zhvillim profesional, duke synuar krijimin e kapaciteteve vendore.

Rezultati 2.3: Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës

2.3.1 Rishikimi i formulës së financimit të arsimit parauniversitar për të ofruar mundësi të adresimit të specifikave të ndryshme të shkollave në dobi të cilësisë.

Në përgjithësi, niveli aktual i financimit të arsimit nuk i plotëson nevojat për përmirësimet e shumta të nevojshme të cilësisë së arsimit në shkolla. Shkollat profesionale kanë disa nevoja të theksuara për material që mundësojnë realizimin e punës praktike, andaj formula e financimit duhet të adresojë këto specifika. Po ashtu, formula e financimit duhet të trajtojë edhe realitetin e shkollave që ofrojnë shërbime për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa duhet të synohet lidhja midis gjendjes infrastrukture të shkollës dhe buxhetit të

mirëmbajtjes. Formula e financimit, gjithashtu, duhet të vazhdojë të ketë parasysh nevojat më të mëdha të financimit për shkollat që vijohen nga komunitetet, e në veçanti shkollat që veprojnë në gjuhë të komuniteteve.

2.3.2 Rritja e efektshmërisë së proceseve të planifikimit të buxhetit arsimor në nivel lokal.

Në baza vjetore MASHT inicion procedura në bashkëpunim me aktorët tjerë relevantë për të shqyrtuar efektshmërinë e proceseve planifikuese në nivel lokal dhe në shkollë, me qëllim të rritjes së efektshmërisë së planifikimit buxhetor.

2.3.3 Zhvillimi i kapaciteteve në shkollë dhe në DKA për menaxhim financiar.

Këto aktivitete do të bazohen në punën e bërë deri tani dhe do t'iu paraprin një analizë e detajuar e nevojave, duke i ndërlidhur me formulën e re të financimit të arsimit parauniversitar dhe vështirësitë e identifikuara deri tani në zbatimin e reformës financiare.

2.3.4 Përcaktimi i treguesve të shpenzimeve të realizuara në arsim me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të shpenzimeve në arsim.

Rezultati 2.4: Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje

2.4.1 Ristrukturimi i divizionit për koordinim të politikave dhe statistika që të qartësohen rolet që lidhen me SMIA.

Nuk bëhet fjalë për ndonjë ristrukturim thelbësor por më shumë ri-organizim të resurseve aktuale drejt sigurimit të proceseve që shpijnë në përdorimin më të madh të raporteve të SMIA-s për vendimmarrje.

2.4.2 Zhvillimi i kapaciteteve për mbledhje, analizë dhe interpretim të avancuar të të dhënave.

Aktivitetet duhet të bazohen në trajnimet e bëra në vitet e kaluara dhe në një analizë të nevojave për mbledhje, përpunim dhe raportim të të dhënave. Brenda kësaj fushe përfshihet edhe rishikimi i Udhëzimit Administrativ ekzistues për mbledhjen e të dhënave, si dhe zhvillimi i udhëzimeve për mbledhjen e të dhënave të ndjeshme për përkatësinë etnike/komunitare.

2.4.3 Zhvillim i procedurave për menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre.

Këto procedura do të formuloheshin në dy politika të reja. Njëra do të orientohej drejt proceseve të brendshme pas finalizimit të raporteve dhe analizave, duke përfshirë edhe modalitetet e inicimit të analizave shtesë që mund të nevojiten për nën-sektorë të caktuar. Politika tjetër do të orientohej drejt komunikimit me palët dhe me publikun e gjerë.

2.4.4 Zhvillimi i platformës për integrimin e sistemeve ekzistuese të informatave dhe bazave të të dhënave për të gjitha nivelet.

Hartohet platforma për integrimin dhe shkëmbimin e të dhënave të automatizuara me katër bazat e të dhënave për licencimin e mësimdhënësve, vlerësimin e nxënësve, hartën e shkollës dhe shpenzimet e sistemeve ekzistuese, duke mundësuar shkëmbimin e të dhënave dhe integrimin e tyre për qëllime dhe nevoja të caktuara, si dhe duke shmangur mbledhjen e dyfishtë të të dhënave.

2.4.5 Ngritja e kapaciteteve për shfrytëzuesit e të dhënave nga shkollat, DKA-të, niveli qendror dhe universitetet.

Ngritja e kapaciteteve për nivelin e MASHT-it do të planifikohet në kontekstin e ndryshimeve që po bëhen në platformën e SMIA-s, të dhënat shtesë që do të mblidhen dhe nevojën për

shfrytëzim të të dhënave dhe analizave për vendimmarrje. Ngritja e kapaciteteve për DKA-të, shkollat dhe universitetet duhet të ndërlidhet me procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe futjes së të dhënave në sistem, dhe me theks të veçantë të përdorimi i tyre në vendimmarrje.

2.4.6 Plotësimi i kornizës së treguesve sipas UNESCO, EUROSTAT dhe OECD.

Do të merret parasysh puna e bërë deri tani në zhvillimin e treguesve në fushën e arsimit sipas treguesve të UNESCO-s duke synuar përditësimin e tyre të mëtejme.

Rezultati 2.5: Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar për të reflektuar ndryshimet në legjislacion dhe politikat tjera

2.5.1 Analiza e koherencës së legjislacionit primar dhe sekondar në raport me projektligjet që janë në proces të miratimit, politikat tjera dhe ligjet jashtë sektorit të arsimit.

Analiza e legjislacioni bëhet për të identifikuar kolizionet brenda legjislacionit dhe të sigurojë koherencë të legjislacionit të arsimit me politikat dhe ligjet tjera relevante kombëtare. Vëmendje e veçantë duhet ti jepet mundësisë për zhvillim e në veçanti rritjes së autonomisë profesionale dhe llogaridhënies të shkollave dhe kompetencave të Këshillit Drejtues të Shkollave.

2.5.2 Hartimi i planit dinamik për rishikimin e legjislacionit.

Plani dinamik mund të ndryshojë në baza vjetore, varësisht nga zhvillimet dhe prioritetet që dalin në ndërkohë.

2.5.3 Hartimi dhe plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore.

Do të identifikohen modalitetet më efikase të hartimit të politikave dhe akteve nënligjore që zbatojnë rregullat e qeverisë për rishikime të tilla, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe koordinimin e dimensioneve të politikave të reja.

2.5.4. Monitorimi i implementimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Përderisa çdo gjë duhet të bëhet për të zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore, monitorimi tregon jo vetëm nivelin e zbatimit aktual, por edhe sukseset dhe dobësitë. Bazuar në këto rezultate MASHT-i mund të veprojë dhe të dretojë procesin e zbatimit të plotë. Kështu monitorimi i MASHT-it nuk është qëllim në vete, por bazë për diskutim, vendime menaxheriale dhe alokim të fondeve. MASHT-i ka nevojë për të zhvilluar një kornizë monitorimi për të ndjekur zbatimin e legjislacionit.

Rezultati 2.6: Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë

2.6.1 Aktivitete vetëdijesimi për mjedisin dhe shëndetin.

Mendohet të hartohen materiale të ndryshme vetëdijesuese dhe të organizohen aktivitete të ndryshme në nivel shkolle dhe në media, duke përfshirë edhe prindërit dhe komunitetin. Këto aktiviteteve duhet të njohin nevojat dhe shqetësimet e ndryshme shëndetësore dhe të sigurisë së djemve dhe vajzave.

2.6.2 Krijimi i mekanizmave për promovim të shëndetit në nivel komunal dhe në nivel shkolle.

Këshilli Drejtues i Shkollës duhet të merr përsipër përgjegjësinë për adresimin e çështjeve të mjedisit të shëndetshëm. Aktivitetet në nivel shkolle do të koordinohen nga niveli komunal.

2.6.3 Hartimi i materialeve për shëndetin dhe mjedisin shkollor.

Hartohet udhëzuesi për shkolla të shëndetshme, publikohet dhe organizohen aktivitete promovuese në të gjitha shkollat.

- 2.6.4 Analizohen nevojat për ujë të pijshëm dhe nyje sanitare, si dhe zhvillohen mekanizma për mirëmbajtjen e tyre.**
- 2.6.5 Hartimi i një udhëzuesi për sigurinë në institucione edukative-arsimore**
Pas publikimit të udhëzuesit organizohen aktivitete promovuese në secilën shkollë.
- 2.6.6 Ndërtimi i mekanizmave për reagim në rastet emergjente.**
Rastet emergjente duhet të përfshijnë rreziqet e të gjitha natyrave duke përfshirë edhe fatkeqësitë natyrore.
- 2.6.7 Vendosja e pajisjeve zjarrfikëse në shkolla.**
- 2.6.8 Pajisja e shkollave me komplete të ndihmës së parë.**
Kjo do të shoqërohet me trajnimin e të paktën tre mësimdhënësve/personel në çdo shkollë dhe me një Udhëzues të përgjithshëm të Ndihmës së Parë.
- 2.6.9 Aktivitete të ngritjes së kapaciteteve të shkollave dhe DKA-ve për parandalim të dhunës.**
Aktivitete që kontribuojnë në zbatimin e rregullativës aktuale për parandalimin dhe raportimin e dhunës në institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese dhe, po ashtu, aktivitete që ndërlidhen me obligimet e institucioneve arsimore për të identifikuar, referuar dhe mbështetur fëmijët, të cilët, potencialisht, janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në shtëpitë e tyre, ose dëshmitarë të dhunës në familje, në shtëpitë e tyre. Në kuadër të aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve do t'i kushtohet kujdes dhunës e bazuar në gjini brenda shkollave.
- 2.6.10 Trajnimi i personelit shkollor për sigurinë dhe shëndetin në shkollë.**
Do të trajnohen 50% e personelit menaxherial dhe mësimdhënës për sigurinë dhe shëndetin në shkollë.

Rezultati 2.7: Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të objekteve arsimore që i kontribuon krijimit të mjediseve të përshtatshme për mësim

- 2.7.1 Zhvillimi i normave dhe standardeve për projektimin e objekteve arsimore për të gjitha nivelet.**
Normat dhe standardet ekzistojnë për nivelin 1-9 dhe do të zhvillohen për arsimin parashkollor, arsimin profesional dhe arsimin e lartë.
- 2.7.2 Promovimi i normave dhe standardeve të ndërtimit të objekteve tek të gjitha nivelet dhe palët.**
Organizohen takime në të gjitha regjionet duke përfshirë DKA-të, drejtoritë e urbanizmit, byrotë projektuese, drejtorët e shkollave etj.
- 2.7.3 Monitorimi i implementimit të normave dhe standardeve të ndërtimit të objekteve.**
Hartohen raporte të rregullta lidhur me respektimin e standardeve të ndërtimit varësisht nga projektet e caktuara dhe sipas nevojës.
- 2.7.4 Vlerësimi i gjendjes fizike të objekteve edukative-arsimore.**
Ky vlerësim bëhet përmes të dhënave të databazës për ndërtesa shkollore. Ky vlerësim është i nevojshëm për planifikim të investimeve për ndërtim, renovim dhe zgjerim të hapësirës mësimore. Në bazë të kësaj MASHT ofron asistencë teknike në zbatimin e standardeve të ndërtimit të hapësirave mësimore.
- 2.7.5 Hartohen udhëzuesit për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave shkollore të të gjitha profileve dhe niveleve.**

2.7.6 Avancimi i databazës për ndërtesat arsimore.

Do të bëhet përditësimi i bazës së të dhënave për nivelin 1-12 dhe zgjerimi i programit për nivelin parashkollor dhe arsimin e lartë. Do të bëhet ndërlidhja me sistemin qendror të SMIA.

2.7.7 Hartimi i një udhëzuesi për planifikimin e investimeve në ndërtesat e reja shkollore.

Udhëzuesi duhet të përfshijë procedurat e aplikimit të komunave për aprovimin e ndërtimit të objekteve shkollore.

2.7.8 Hartimi i një plani të investimit për hapësirat shkollore për një periudhë prej 3 dhe 5 vjeçare.

Në bazë të kërkesave të komunave, sipas kriterëve ekzistues, MASHT harton plane për investime afatmesme dhe afatgjata. Kriteret e investimeve do të rishikohen në baza të vazhdueshme në varësi të zhvillimeve dhe arritjeve në fushën e infrastrukturës.

Rezultati 2.8: Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor

2.8.1 Ndërtohen objekte të reja shkollore duke synuar që 1/3 e nxënësve të mësojnë në një ndërrim.

Identifikimi i lokacioneve për ndërtimin e shkollave të reja do të bëhet duke u bazuar në analizat e dala nga harta shkollore (plani i investimeve) sipas normave dhe standardeve të zbatueshme dhe ndryshimeve të pritshme demografike. Gjatë periudhës pesëvjeçare pritet të ndërtohen 25 objekte të reja shkollore.

2.8.2 Ndërtimi i objekteve për parashkollor/parafillor.

Janë planifikuar të ndërtohen 18 institucione parashkollore/parafilllore sipas normave dhe standardeve.

2.8.3 Renovimi i objekteve edukative-arsimore.

Renovimi bëhet në bazë të vlerësimit të gjendjes fizike të objekteve dhe sipas normave dhe standardeve të zbatueshme në mënyrë që objektet të bëhen më funksionale për sistemin e arsimit dhe reformës kurrikulare. Gjatë periudhës 5 vjeçare do të rinovohen 250 objekte.

2.8.4 Pajisja e shkollave me pakot e sallave sportive.

Sigurimi i këtyre pajisjeve do të bëhet sipas specifikave që janë definuar tashmë nga MASHT, e që janë në harmoni me standardet ndërkombëtare. Gjithsej, 40 shkolla do të pajisen me pako të sallave sportive gjatë periudhës pesëvjeçare.

2.8.5 Pajisja e dhomave të mësimi me inventar adekuat për mësim.

Prokurimi i inventarit për mësim do të bazohet në parimin e ofrimit të ambientit më miqësor dhe më adekuat për mësim. Do të merren parasysh standardet dhe normat e zbatueshme për infrastrukturën edukative-arsimore. Gjithsej 60 objekte do të pajisen me inventar adekuat për mësim.

2.8.6 Pajisja e shkollave me dollapë individualë për nxënës.

Dollapët do të sigurohen sipas specifikave që janë hartuar nga MASHT dhe duke marrë parasysh realitetin ekzistues në hapësirën shkollore. Gjatë periudhës 5 vjeçare do të pajisen 30% e shkollave me dollapë individual për nxënës.

2.8.7 Zgjerimi dhe përmirësimi i mjediseve mësimore në institucionet e arsimit të lartë

Ndërtohen hapësira të reja dhe përmirësohen ndërtesat ekzistuese bazuar në programet që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë. Ndërtohen tri objekte të reja për institucionet e arsimit të lartë

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Niveli komunal ushtron në tërësi përgjegjësitë dhe kompetencat e veta të përcaktuara me ligj.
- Përgatitja e një procesi dhe strukture të ndarë në faza që shkollat i bën të marrin përsipër më shumë kompetenca dhe t'i mbajë të përgjegjshme.
- Rritja e grantit specifik të arsimit për të mundësuar financim të qëndrueshëm për të gjitha shkollat dhe për të inkurajuar aktivitetet zhvillimore.
- Drejtorët dhe këshillat drejtues marrin rol të shtuar në zhvillimin e shkollës.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Kapacitetet e kufizuara për menaxhim profesional në nivel shkolle dhe komune.
- Mungesa e burimeve financiare për investime kapitale.

8. Objektivi strategjik 3: Sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë në arsim është çdo proces sistematik që shërben për të vërtetuar nëse shërbimi që i ofrohet nxënësit i plotëson kërkesat e caktuara. Qëllimi primar i një sistemi të mirëfilltë për sigurimin e cilësisë është që të sigurojë arsimim të cilësisë së lartë për të gjithë, të ofrojë mundësi për gjetjen e defekteve të mundshme në procesin edukativ, si dhe të ndërmerr hapa konkretë për përmirësimet e mundshme. Duke e bërë këtë, besimi i qytetarit ndaj sistemit të arsimit do të shtohet.

Sigurimi i cilësisë kërkon mekanizma në nivele të ndryshme, në varësi nga mënyra e organizimit të sistemit të arsimit. Këto mekanizma duhet të jenë në gjendje ta mbështesin vlerësimin e gjendjes në shkollë⁴³, por edhe të mbështesin përmirësimin e gjendjes në bazë të rekomandimeve të vlerësimit. Në parim, shkolla ka nevojë edhe për vlerësim të pavarur, por edhe për përkrahje profesionale për t'i arritur standardet e përcaktuara.

Planifikimi zhvillimor i shkollës shihet si proces përmes të cilit shkolla merr përgjegjësi për zhvillimin e saj, p.sh. për përmirësimin e performancës së vet dhe kontributin në zbatimin e politikave kombëtare. Në kontekstin e politikave të decentralizimit, planifikimi zhvillimor ka për qëllim ta përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin e menaxhimit të shkollës. Planifikimi zhvillimor fillon me analizën e nevojave, dhe, duke u bazuar në këtë, përcaktohen prioritetet zhvillimore në kontekstin e perspektivës trevjeçare.

Qasjet e reja kërkojnë ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e tyre. Ky lloj ndërtimi i kapaciteteve shkon përtej trajnimeve, duke u shtrirë në fuqizimin e strukturave të reja për ta kryer punën e tyre. Si element me rëndësi në sigurimin e cilësisë paraqitet presioni “nga poshtë lartë” që duhet ta bëjnë qytetarët, në radhë të parë nxënësit dhe prindërit e tyre, duke kërkuar që shkolla të ofrojë cilësi. Kjo nënkupton vetëdijesimin dhe fuqizimin e tyre për të shtruar kërkesa të kësaj natyre që i obligojnë shkollat dhe vendimmarrësit e nivelit qendror dhe lokal të punojnë për të siguruar cilësi.

Testet ndërkombëtare dhe kombëtare, si testi i arritshmërisë pas shkollimit të obligueshëm, provimi shtetëror i maturës apo PISA, shihen si instrumente të rëndësishme për sigurimin e cilësisë, pasi ofrojnë informacion sistematik për anomalitë e sistemit dhe kurrikulumit dhe, si të tilla, mund të shfrytëzohen për ndërmarrjen e hapave drejt evitimit të tyre.

Sfidat

Mekanizmat jofunksionalë për sigurimin e cilësisë

Sigurimi i cilësisë është një ndër pikat më të dobëta të arsimit parauniversitar në Kosovë. Mekanizmat që ekzistojnë më herët, si Enti Pedagogjik i Kosovës, provimi shtetëror për mësimdhënësit, entet pedagogjike në disa komuna dhe pedagogët në shkolla, u zhbënë në vitin 2000, me një vendim të UNMIK-ut, pa i zëvendësuar ato me mekanizma të rinj funksionalë. Ndërkohë, u krijuan institucione si Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Inspektorati i Arsimit, por detyra e tyre është mbulimi vetëm i disa aspekteve të sigurimit të cilësisë, ndërkohë që raportet e tyre nuk kanë pasur ndikim sistematik në vendimmarrje. Po ashtu, në shtatë vitet e fundit vërehet një trend i ripunësimit të pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, por veprimtaria e tyre mbetet jo e koordinuar dhe jo e mbikëqyrur nga jashtë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Ligji për Arsimin në Komuna solli dinamika të reja në fushën e sigurimit të cilësisë, duke i bartur disa përgjegjësi dhe autorizime për këtë fushë nga niveli qendror në atë lokal. Megjithatë, aprovimi i këtij ligji i zuri

⁴³ Në këtë kapitull, fjala “shkollë” përdoret për të përshkruar institucionet e arsimit parauniversitar të nivelit ISCED 0-3.

komunat të papërgatitura nga aspekti kadrovik, por edhe logjistik, për një sfidë të tillë çfarë është sigurimi i cilësisë, aq më parë kur nuk ekziston një sistem unik për sigurimin e cilësisë në vend, pramungojnë kriteret, standardet dhe proceset transparente për sigurimin e cilësisë.

Përderisa Inspektorati i Arsimit ka të drejtë të merret me çështje administrative dhe komunat mbajnë përgjegjësi formale për sigurimin e cilësisë, në realitet ekziston një konfuzion mbi ndarjen e përgjegjësi në mes autoriteteve qendrore dhe lokale. Nga ana tjetër, mekanizmat në nivel shkolle janë jo-ekzistues ose, në rastin më të mirë, jo-funksionale.

Sfidat e Planifikimit Zhvillimor të Shkollës/PZhSh

Me bartjen e vazhdueshme të përgjegjësi nga niveli qendror në komuna, dhe nga komunat tek shkollat, planifikimi zhvillimor i shkollës është detyrë në nivel të çdo shkolle, e cila është një sfidë mjaft e madhe, por edhe një mundësi. Jo të gjitha shkollat në Kosovë janë të detyruara të kenë plane zhvillimore, me përjashtim të Qendrave të Kompetencës. Duke u bazuar në trajnimin zyrtar për menaxhimin në arsim për drejtorët e shkollave, MASHT ka aprovuar një format zyrtar për PZhSh dhe e ka publikuar në faqen zyrtare elektronike. Në një numër të komunave ky format përdoret mjaft shumë. DKA-të kanë ndërtuar mekanizma për vlerësimin dhe diskutimin e PZhSh-ve duke i koordinuar ato edhe me planet e tyre. Këto përvoja shihen si praktika të mira.

Megjithatë, cilësia e shumicës së planeve zhvillimore të shkollës, nuk është në nivelin e kënaqshëm. Duket se shkollat shpesh kopjojnë nga shkollat e tjera. Fokusi kryesor i planeve zhvillimore të shkollave, deri më tani, ka qenë në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, përkatësisht në aspekte të cilat varen nga financimi i jashtëm (komunat, donatorët, komuniteti). Fokusi nuk vihet në atë që shkollat do të mund të bënin në kushtet e dhëna për të përmirësuar cilësinë e funksionit të tyre kryesor, pra përmirësimin e proceseve të mësimdhënies dhe të nxënies. Ligjërisht, shkollat nuk janë të detyruara të ndjekin planin që kanë hartuar, ndërsa monitorimi zakonisht është pikë e dobët. Një problem i madh është që planifikimi zhvillimor i shkollës nuk është i koordinuar me politikat shtetërore dhe lokale të arsimit.

Formalizmi i tillë në planifikimin zhvillimor të shkollës përbën rrezik që planet zhvillimore të shkollave të konsiderohen si aplikacione për burime shtesë në vend të një instrumenti shkolle të bazuar në sigurimin e cilësisë, me fokus në ato veprime të cilat shkolla mund / duhet t'i ndërmarrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ajo ofron. Në anën tjetër, planifikimi zhvillimor i shkollës shihet si një mjet i rëndësishëm i sigurimit të cilësisë, meqë "kultura e cilësisë" në nivel të shkollës është parakusht për zhvillimin efektiv të cilësisë, veçanërisht në kuadër të autonomisë më të madhe të shkollës dhe përqendrimit më të fortë në rezultate.

Mungesa e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë

Krijimi i një sistemi të plotë të sigurimit të cilësisë kërkon ndryshime në legjislacion, dhe një ndarje të re të përgjegjësi në mes të nivelit qendror, lokal dhe shkolle. Kjo duhet të shoqërohet me masa të ndërtimit të kapaciteteve të cilat përfshijnë zhvillimin profesional të personelit dhe stafit në arsim, Inspektoratit dhe DKA-ve, si dhe përpjekje të konsiderueshme për zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet.

Me 57 inspektorë që mbulojnë territorin e Kosovës dhe specializohen në fusha të ndryshme, Inspektorati i Arsimit ka nevojë për zhvillimin e kapaciteteve për të ushtruar rolin e tij në sigurimin e cilësisë së arsimit, si në aspektin e strukturës së stafit dhe numrave të tij, ashtu edhe në përgatitjen e tyre për rolin e ri. Në anën tjetër, ndikimi i komunave në cilësinë e arsimit është, në shumicën e rasteve, i reduktuar në mbulimin e shpenzimeve ditore të shkollës, pavarësisht nga prania e tyre e

detyrueshme në këshillat e shkollave dhe roli i tyre në hartimin e një pjese të kurrikulës. Ata kanë nevojë për forcimin e kapaciteteve të tyre profesionale për të adresuar çështjet e arsimit. Po kështu, shkollat si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve arsimore, duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të siguruar mësim të mirë, për të mbështetur zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe për të monitoruar cilësinë e procesit të mësimitdhënies/nxënies

Vetëdija e ulët për sigurimin e cilësisë

Në përgjithësi, ka një ndërgjegjësim të ulët lidhur me nevojën për të siguruar cilësinë e arsimit pasi që ka pak dëshmi të cilësisë së dobët të arsimit dhe rezultateve të tij. Cilësia e mësimitdhënies në shkolla nuk mund të gjykohej për sa kohë që nuk ka mekanizma të sigurimit të cilësisë në vend që fokusohen në këtë aspekt, siç është, për shembull, vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve dhe vlerësime kredibile të rezultateve të të nxënësve që raportohen në publik. Pjesëmarrja e prindërve është një parakusht për rritjen e përgjegjshmërisë dhe rëndësinë e proceseve arsimore. Prindërit në Kosovë nuk kanë as mendësi, as mekanizma të duhur për të ndikuar në proceset më të gjera arsimore; shqetësimi i tyre mbetet arritja e fëmijës/fëmijëve së/të vet dhe kur janë të pakënaqur me rezultatet e arsimit, ata mbështeten në mekanizmin individual mbrojtës (për shembull, duke i bërë presion mësimitdhënësit/mësimitdhënëses apo lëvizur fëmijën në një shkollë tjetër). Është e zakonshme që prindërit të marrin informacion në lidhje me ecurinë e fëmijës së tyre në formën e notave të arritura. Analiza e vlerësimit të jashtëm të nxënësve në fund të ciklit 9-vjeçar tregon se mesatarja e diskrepancës/dallimit mes vlerësimit të brendshëm të mësimitdhënësit dhe arritjet e nxënësve në testin e jashtëm shkon deri në dy nota. Përderisa informatat për arritjet e fëmijës nuk janë të besueshme sa duhet, nuk ka aspak informacion për performancën e shkollës. Gjithashtu, prindërit në Kosovë kanë shumë pak informacion për kurrikulën e re të bazuar në kompetenca. Edhe tek nxënësit nuk vërehet një këmbëngulje për cilësi, megjithëse organizimet e nxënësve kanë potencial për të shtruar kërkesa për mësimitdhënie cilësore. Ligjërisht, shkollat u përgjigjen komunave, por, pasi që ato nuk janë të obliguara të kenë planin zhvillimor të shkollës, dhe as nuk kanë mekanizma për vlerësimin e tërë performancës së shkollës, linjat e llogaridhënies janë mjaft të dobëta. Në përgjithësi, qytetarët, nuk i mbajnë komunat përgjegjëse për performancën e dobët të shkollave lokale.

Dobësitë e vlerësimit të jashtëm

Përdorimi i rezultateve të testeve kombëtare për përmirësimin e cilësisë shihet si një fushë e cila duhet të zhvillohet në të ardhmen. Nevojitet të zhvillohen mekanizma përmes së cilave analizat e detajuara të rezultateve të testeve kombëtare do të raportohen në nivel vendi, komune dhe shkolle në atë mënyrë dhe në atë format që të ndikojnë në evitimin e dobësive në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënësve, si dhe në funksionimin e shkollës. Në veçanti, duhet inkurajuar kërkesat nga DKA-të për rezultate të testeve, me qëllim të bërjes së analizave në nivelin lokal. Besueshmëria e ulët e rezultateve ndikon negativisht në motivimin e personelit arsimor që të adresojë rezultatet jo të kënaqshme të nxënësve të tyre, sepse nuk jep bazë të mirë për krahasimin e rezultateve të vlerësimit të jashtëm me ato të vlerësimit të brendshëm. Përgjithësisht, testi i klasave të pesta i cili konsiderohet si më i besueshëm. Po ashtu, dukuria e tillë ndikon në dobësimin e hallkave të llogaridhënies, pasi nuk krijon hapësirë për vlerësim objektiv të punës së mësimitdhënësve dhe të shkollës. Pjesëmarrja e mësimitdhënësve në PISA dhe analizat e mirëfillta, si dhe interpretimi i rezultateve të testit në ndërlidhje me faktorët e tjerë socialë, ekonomikë dhe arsimorë do të jetë, pa dyshim, një nxitje për hartuesit e politikave arsimore që t'i marrin të gjitha hapat e duhur për përmirësimin e cilësisë në sistemin e arsimit parauniversitar.

Objekti

Sistemi i sigurimit të cilësisë varet nga funksionaliteti i mekanizmave që veprojnë brenda këtij sistemi, si dhe nga kapacitete njerëzore dhe logjistike për vënien në funksion të këtij sistemi. Për këtë arsye parashihet një ndarje e autorizimeve në mes të nivelit qendror, atij lokal, si dhe nivelit të

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

shkollës. Niveli i shkollës ka rëndësi të veçantë në zinxhirin e sigurimit të cilësisë, prandaj parashihet që planifikimi zhvillimor i shkollës të jetë instrumenti kryesor që nxit sigurimin e cilësisë në këtë nivel. Ndërtimi i kapaciteteve

në të gjitha nivelet është hapi kyç për funksionalizimin e sistemit të ri të sigurimit të cilësisë. Në kushtet e Kosovës janë të nevojshme edhe aktivitete të vetëdijesimit të kombinuara me kornizën e shpërblimeve dhe ndëshkimeve që krijojnë një mjedis ku nxitet llogaridhënia në të gjitha nivelet. Në funksion të nxitjes së llogaridhënies është edhe ngritja e cilësisë së instrumenteve kombëtare të vlerësimit, që nënkupton ndërhyrje në formatin dhe përmbajtjen e tyre.

Rezultatet e pritshme:

- 3.1. Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës të bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes të MASHT, DKA dhe shkollës;
- 3.2. Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërlidhin planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me strategjinë zhvillimore të arsimit;
- 3.3. Deri në vitin 2020 ndërtohen kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkolle;
- 3.4. Profesionistët, politikëbërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar;
- 3.5. Rritet besueshmëria e rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për politikëbërje, krahas rezultateve të testeve ndërkombëtare.

Çështje të ndërlidhura

Sistemi i sigurimit të cilësisë varet nga ndryshimet legjislative, por edhe përmirësimi i menaxhimit të sistemit të arsimit (fusha 2). Gjithashtu, ky sistem ofron bazën organizative dhe kornizën e cilësisë që ndihmon zbatimin e kurrikulës së re (fusha 5), si nga aspekti i organizimit të procesit mësimor, ashtu edhe nga aspekti i vlerësimit. Meqë cilësia në arsim lidhet, në masën më të madhe, me cilësinë e mësimdhënies, është e pamundur të mos ekzistojë lidhja organike në mes të sistemit për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve (fusha 4). Edhe tek sigurimi i cilësisë ekzistojnë disa specifika të nën-sektorit të arsimit dhe aftësimit profesional (fusha 6). Në veçanti, kjo ka të bëjë me legjislacionin i cili parasheh procedura të veçanta për vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional.

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 3.1: Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës të bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes të MASHT, DKA dhe shkollës

3.1.1. Ngritja e sistemit efikas për vlerësimin e performancës së shkollës.

Vlerësimi i performancës së shkollës bëhet nga Inspektorati i Arsimit në bazë të vlerësimit të brendshëm të shkollës, në periudha 3-5 vjeçare. Ndërkaq, për shkollat profesionale vlerësimi është pjesë e procesit të akreditimit që udhëhiqet nga AKK, në bazë të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Ligjit për Kualifikimet Kombëtare.

3.1.2. Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim.

Cikli i menaxhimit të cilësisë përbëhet nga hapa të definuar mirë që janë të përshkruar në Kornizën Evropiane të referencës për Sigurimin e Cilësisë (KERSC) dhe në Kornizën Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë për AAP (KKSCAAP). Në kuadër të kësaj për KERSC në arsimin e përgjithshëm duhet definuar kriteret përcaktuese të cilësisë së mësimdhënies, në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare.

3.1.3. Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së.

Në shkolla do të emërohen koordinatorët e cilësisë dhe do të riorganizohet puna e aktiveve dhe këshillave shkollore në atë mënyrë që të fuqizohet siguri i cilësisë. Është në fazën e përgatitjes Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e përgjegjësive të koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle dhe komune.

3.1.4. Përcaktimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA.

Në përputhje me ristrukturimin e sugjeruar në aktivitetin 2.1.1 secila DKA do të emërojë koordinatorin e cilësisë në nivel komune, si dhe grupet profesionale të fushave lëndore për mbështetje të shkollave në procesin e zhvillimit të kurrikulimit, trajnimit të mësimdhënësve, etj.

3.1.5. Funksionimi i Inspektoratit në aspektin juridik-administrativ dhe pedagogjik-profesional.

Qasja e re kërkon që Inspektorati i Arsimit që të merret me çështjet më specifike të ndërlidhura me arsim, siç është bërja e vlerësimeve periodike institucionale të jashtme. Një qasje e tillë kërkon ndryshime në legjislacion, dhe gjithashtu një strukturë të re të personelit në Inspektoratin e Arsimit. Inspektorët pedagogjikë-profesionalë duhet të specializohen për nivele të caktuara të arsimit parauniversitar, duke filluar nga niveli parashkollor, fillor dhe i mesëm i ulët, si dhe i mesëm i lartë. Po ashtu, ndryshimet legjislative duhet të lejojnë mundësinë që inspektorët e arsimit të kenë rol në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, nëse ky proces do të zhvillohet ashtu si parashihet me udhëzimet administrative aktuale. Struktura e re e personelit në Inspektoratin Arsimit duhet të reflektoj larinë e gjuhëve të mësimi që ofrohen në sistemin arsimor të Kosovës.

3.1.6. Shfrytëzimi efektiv i të dhënave nga monitorimi i arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha gjuhët mësimore

DKA-të dhe drejtorët e shkollave përdorin të dhënat nga monitorimi i arsimit, përfshirë të dhënat nga SMIA, si dhe të dhënat për vlerësimin e jashtëm të nxënësve, për të përmirësuar cilësinë e arsimit.

Rezultati 3.2: Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërlidhin planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me strategjinë zhvillimore të arsimit

3.2.1. Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor.

Do të rishikohen udhëzimet ekzistuese për planifikimin zhvillimor të shkollës dhe do të përmbledhen në një formë të Udhëzimit Administrativ i cili do ta bëjë planin zhvillimor të detyrueshëm për të gjitha institucionet publike të arsimit parauniversitar në Kosovë. Në shkollat profesionale do të ndiqet procedura e përcaktuar nga AKK.

3.2.2. Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave.

Bazuar në përvojat dhe praktikat e mira të DKA-ve dhe drejtorëve të shkollave, ndërtohet një qasje sistematike për monitorim dhe koordinim.

3.2.3. Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollare sipas fushave të cilësisë, përmes planifikimit të integruar.

Planet Zhvillimore Komunale të Arsimit duhet të jenë një linjë me planet shkollare në pajtim me fushat e cilësisë. Përveç kësaj, çdo plan komunal i arsimit duhet të reflektojë prioritetet zhvillimore të shkollave edhe në kuadër të komunës.

3.2.4. Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira.

Praktikat më të mira në planifikimin e zhvillimit të shkollës dhe zhvillimit të cilësisë me bazë në shkollë do të ndahen në nivel të komunës dhe përmes portalit të sigurimit të cilësisë të MASHt-it. Shtimi në nivel kombëtar i rrjetëzimeve të shkollave mund të ofrojë një format të përshtatshëm për shkëmbim dhe mësim të dyanshëm.

Rezultati 3.3: Deri në vitin 2020 ndërtohen kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkolle

3.3.1. Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit për përgjegjësitë e reja.

Inspektorati i Arsimit duhet të hartojë rregullore të brendshme dhe udhëzues për kryerjen e detyrave të reja. Hapi tjetër në ndërtimin e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit për përgjegjësitë e reja është që të rishikojë strukturën e personelit në këtë organ, si në aspektin e numrit, njohurive dhe shkathtësive gjuhësore, ashtu edhe në aspektin kualifikimit të inspektorëve të shkollave, duke proceduar pastaj me trajnime.

3.3.2. Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë.

Doracaku do të vë fokus të veçantë në rolin e aktiveve të shkollave për sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë si planifikimi i përbashkët, koordinimi i mësimdhënies ndër-lëndore por gjithashtu edhe mbështetja kolegjiale (p.sh. vëzhgime në klasa).

3.3.3. Trajnimi i stafit të DKA-ve, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë.

Do të zhvillohet një modul i veçantë trajnimi për stafin e DKA, drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla. Po ashtu, ky modul do të përfshihet në programin ekzistues të trajnimit për drejtorë të shkollave.

3.3.4. Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal.

MASHt do të hartojë udhëzues për sigurimin e cilësisë me bazë në shkollë si dhe instrumente përkatëse për funksionimin e grupeve profesionale. Ndërkaq, për shkollat profesionale ky është rol i AKK.

3.3.5. Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor.

Në nivel kombëtar, ofruesit përkatës të trajnimeve do të inkurajohen për të zhvilluar kapacitet trajnues që mund të plotësojë kërkesat e komunave dhe shkollave për trajnim. Niveli komunal, dhe, kur është e përshtatshme, niveli qendror do të ketë përgjegjësinë për zbatimin e programeve të trajnimit, ndërsa MASHT do të mbikëqyrë procesin e trajnimit.

3.3.6. Krijohet Agjencia për Kurrikulë, Vlerësim dhe Standarde (AKVS) në përputhje me Ligjin e Arsimit Parauniversitar.

Ideja është që njësitë organizative përkatëse nga MASHT të transferohen në agjenci, qoftë në tërësi ose pjesërisht.

Rezultati 3.4: Profesionistët, politikë-bërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

3.4.1. Zhvillohet sistemi për raportimin e rezultateve të testeve kombëtare.

Një masë e tillë do të bëjë që profesionistët, prindërit, nxënësit dhe publiku i gjerë të jenë të vetëdijshëm për performancën e sistemit të arsimit dhe institucioneve arsimore. Aktiviteti do të mbështetet nga Banka Botërore.

3.4.2. Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve.

Shembuj të praktikave të mira që kanë të bëjnë me cilësinë e arsimit do të promovohen gjerësisht përmes Portalit të sigurimit të cilësisë.

3.4.3. Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë.

MASHT-i ka disenjuar një fushatë e cila informon prindërit dhe nxënësit në lidhje me aspektet kyçe të kurrikulit të ri para implementimit mbarëkombëtar. Fushatat informuese duhet të organizohen në të gjitha gjuhët e komuniteteve dhe të shtrihen tek të gjitha komunitetet.

3.4.4. Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim.

Në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, MASHT do të organizojë një konferencë vjetore për cilësinë e arsimit.

3.4.5. Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë.

Portali do të krijohet nga MASHT me qëllim të informimit të mësimitdhënësve, prindërve, nxënësve dhe publikut të gjerë për aranzhimet e sigurimit të cilësisë, dhe do të ofrojë burime dhe instrumente për të mbështetur mekanizma të sigurimit të cilësisë në nivel qendror, lokal dhe të shkollës.

Rezultati 3.5: Rritet besueshmëria e rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për politikëbërje, krahas rezultateve të testeve ndërkombëtare

3.5.1. Rishikimi i udhëzuesit për administrimin dhe monitorimin e testeve.

Saktësohen rregullat e përgjithshme dhe modalitetet e përzgjedhjes së administruesve dhe stafit monitorues për zbatimin e testit kombëtar.

3.5.2. Trajnimi i administruesve dhe monitoruesve të testeve.

Trajnimet e rregullta për administrimin e testit dhe monitorimin do të përmirësojnë cilësinë dhe besueshmërinë e testeve kombëtare.

3.5.3. Sigurohet mbarëvajtja dhe transparenca e procesit të testimit.

Merren masa adekuate për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të testimit, përfshirë ofrimin e sigurisë dhe transparencën e komplet procesit.

3.5.4. Krijimi i bankës së pyetjeve me karakteristika të plota të pyetjeve.

Banka duhet të përmbajë numër të mjaftueshëm të pyetjeve të cilësisë përkatëse që mund të përdoren për teste kombëtare.

3.5.5. Analiza e testeve pas përfundimit të tyre.

Rezultatet e testeve kombëtare analizohen dhe interpretohen me qëllim të nxjerrjes së përfundimeve për cilësinë e kërkesave dhe arritjen e rezultateve të të nxënit.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Finalizimi i legjislacionit për riorganizimin e Inspektoratit të Arsimit.
- Përkushtimi dhe gatishmëria e komunave për të mbështetur zbatimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.
- MASHT, komunat dhe shkollat së bashku do të sigurojnë që bashkëpunimi i mësimdhënësve në struktura shkollore (sikurse funksionet për sigurimin e cilësisë, PRTAN etj.) do të mbulohen me kontratat ekzistuese.
- Ndryshimet në formulën e financimit të marrin parasysh nevojat aktuale të shkollave për financim, duke përfshirë shpenzimet e mundshme për sigurim të cilësisë të bëra nga shkolla.
- Vullneti i mësimdhënësve për t'u angazhuar edhe në detyra menaxhuese të nivelit të mesëm, si koordinatore të cilësisë ose udhëheqës të aktiveve shkollore.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Mungesa e kapaciteteve në nivel komune dhe shkolle për t'i kryer detyrat në lidhje me sigurimin e cilësisë të përcaktuara me këtë Strategji.
- Buxheti i pamjaftueshëm për të mbështetur menaxhmentin e mesëm (koordinatorët e cilësisë, udhëheqësit e aktiveve) në shkolla, si dhe ndërtimin e strukturave përkatëse në nivel komune.
- Formalizmi në hartimin e planeve zhvillimore shkollore dhe komunale.

9. Objektivi strategjik 4: Zhvillimi i mësimdhënësve

Një ndër faktorët kyç që ndikon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit është zhvillimi profesional i mësimdhënësve. Sa më të përgatitur që janë mësimdhënësit aq më lehtë do të tejkalojnë sfidat e shumta me të cilat mund të ballafaqohen gjatë procesit mësimor, si dhe do të zbatojnë reforma që janë në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. Mësimdhënësit janë bartësit e ndryshimeve në çdo sistem të arsimit, prandaj është me rëndësi përgatitja profesionale e tyre.

Zhvillimet në sferën e arsimit kërkojnë që mësimdhënësit të posedojnë shkathtësi të theksuara profesionale dhe pedagogjike, si dhe kompetenca të shtuara për vendimmarrje në shkollë dhe në klasë. Nevoja për përgatitjen optimale të të rinjve për botën e globalizuar, me kërkesa dhe mundësi që vazhdimisht ndryshojnë, kërkon mësimdhënës që mund të krijojnë një mjedis nxitës të të nxënit, që mbështet të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave dhe shërben si model me veprimet e tij/saj. Një gjë e tillë nënkupton nevojën për fuqizim të rolit të mësimdhënësit në raport me planifikimin mësimor, zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit, vlerësimin e nxënësve, përgatitjen dhe përdorimin e materialeve online, si dhe të mjeteve të ndryshme të konkretizimit. Të gjitha këto kanë shtruar nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve.

Sfidat

Mungesa e sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për zhvillim profesional të mësimdhënësve

Modeli ekzistues i zhvillimit profesional të mësimdhënësve është bazuar në programet e ofruara për mësimdhënës, prandaj duhet të përcaktohen programet trajnuese prioritare, në mënyrë që të plotësohen nevojat praktike të mësimdhënësve për zhvillim profesional dhe për zbatim të reformës kurrikulare. Për të ofruar zhvillimin profesional më afër nevojave të mësimdhënësve, MASHT ka realizuar aktivitete të ndryshme për strukturimin e ZHPM-së, siç janë: hartimi i udhëzimeve administrative, akreditimi i ofertuesve/institucioneve dhe programeve trajnuese, hartimi i katalogut për trajnime⁴⁴, etj. Analiza e këtij katalogu tregon se ka shumë pak trajnime specifike të akredituara, p.sh. trajnime didaktike-lëndore të bazuara në analizën e nevojave, si dhe për zbatimin e kornizës kurrikulare.

Nevoja në rritje për zhvillim profesional sipas fushave të caktuara mësimore është një sfidë për kornizën e ZHPM-së, pasi kjo potencon nevojën për zbatim të modelit për zhvillim profesional të mësimdhënësve të bazuar në kërkesë. Për realizimin me sukses të këtij modeli paraqiten së paku dy sfida: e para është identifikimi i nevojave për kualifikim profesional në baza të rregullta, në tri nivele: në nivelin kombëtar për zbatim të reformës kurrikulare, në nivelin komunal që përfaqëson nevojat e shkollave, si dhe në nivelin individual për plotësim të nevojave të mësimdhënësit për zhvillim profesional. Të gjitha këto nevoja për zhvillim profesional duhet të mblidhen, të vlerësohen, dhe, në bazë të rezultateve të tyre dhe objektivave strategjike të organizohet ofrimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Sfidat e dytë është koordinimi i aktiviteteve të ZHPM ndërmjet aktorëve të ndryshëm siç janë Instituti Pedagogjik dhe fakultetet e edukimit, si dhe harmonizimi i aktiviteteve të tyre me kontributet nga partnerët zhvillimorë dhe organizatat e ndryshme arsimore.

⁴⁴ Katalogu i programeve të akredituara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe të udhëheqësve të arsimit, MASHT, 2011.
http://edukimi.webs.com/dokumente%20shkollore/katalogu_i_programeve_per_zhvillim_1.pdf

Deri para disa viteve, zhvillimi profesional i mësimdhënësve ka qenë i organizuar, kryesisht, në formë të trajnimeve klasike. Një qasje e tillë është treguar e pamjaftueshme, sepse mësimdhënësit shpesh kanë pasur nevojë për përkrahje të vazhdueshme profesionale për të zbatuar në praktikë njohuritë e fituara. Përvojat nga Kosova tregojnë se format tjera të zhvillimit profesional, si këshillimi në vendin e punës, mentorimi, praktikat reflektive, etj., mundësojnë bartjen e njohurive dhe shkathtësive në klasë. Praktikrat e këtilla kanë qenë pjesë e disa programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, megjithatë mbetet sfida që kjo qasje gjithëpërfshirëse të bëhet pjesë e një kulture të zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve. Kjo qasje e gjerë mund të mbështetet nga aktivitetet profesionale të çdo shkolle dhe nga rrjetëzimi i shkollave.

Niveli komunal dhe shkollat kanë më shumë informacione të drejtpërdrejta lidhur me nevojat e mësimdhënësve për zhvillim profesional, prandaj MASHT-i ka deleguar këtë përgjegjësi, në masë të madhe, te këto nivele. Po ashtu, MASHT-i ka hartuar dhe rregullativën ligjore për ndarjen e fondeve për këtë qëllim dhe ka përcaktuar përgjegjësitë e secilës palë në këtë proces. Mbetet sfida për MASHT-in që të ndërtojë një mekanizëm të qëndrueshëm të financimit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, i cili, përveç tjerash, do të shqyrtonte alternativat e bashkëfinancimit të ZHPM-së nga niveli qendror dhe komunal.

Mosfunksionalizimi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve

Neni 33 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar përkufizon rregullat bazë për licencimin e mësimdhënësve, pjesë e të cilave është edhe vlerësimi i performancës. Në Kosovë është realizuar pilotimi i procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Pilotimi ka treguar se ekziston nevoja për përmirësimin e instrumenteve dhe të procesit të vlerësimit, pasi që është dëshmuar se kjo kërkon më shumë burime se sa që janë në dispozicion.

Ngecje në procesin e licencimit të mësimdhënësve

Procesi i licencimit të mësimdhënësve bazohet në sistemin e gradimit të përbërë nga katër nivele, secili prej tyre i kushtëzuar me përmbushjen e disa kriterëve, kryesisht me vijimin e programeve të akredituara për zhvillim profesional dhe arritjen e së paku të nivelit të kënaqshëm me rastin e vlerësimit të performancës. Pra, suksesi në zbatimin e procesit të licencimit varet nga dy parakushte: nga realizimi i zhvillimit profesional dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve. Nga aspekti i zhvillimit profesional, procesi i licencimit kërkon që secili mësimdhënës të vijojë së paku 20 orë ose 2.5 ditë trajnim brenda një viti. Mbetet sfida për MASHT-in që të bashkëpunojë me DKA-të dhe donatorët për të ofruar këtë mundësi për të gjithë mësimdhënësit. Ndërsa, kërkesa e dytë është vlerësimi në nivelin së paku të kënaqshëm të performancës, me qëllim të përtëritjes apo promovimit në nivel më të lartë të licencës. Hulumtimet ndërkombëtare tregojnë se mësimdhënësit reagojnë pozitivisht nëse arritjet e tyre profesionale njihen zyrtarisht. MASHT-i duhet të kujdeset që procesi i licencimit të bazohet në parimin e meritokracisë si një shtysë për motivim të mësimdhënësve për performancë më të mirë. Çfarëdo vendimi në këtë kontekst duhet të ketë parasysh kufizimet buxhetore, sepse pagat e mësimdhënësve duhet të jenë të ndërlidhura me licencat e tyre.

Rezultatet nga procesi i licencimit janë burim i vlefshëm i informatave për nevojat e mësimdhënësve për zhvillim profesional. Mbetet sfida ndërtimi i mekanizmave për shfrytëzimin e tyre për politikë-bërje dhe për caktimin e prioritetëve lidhur me zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Përgatitja jociësore e mësimdhënësve para shërbimit

Përgatitja e mësimdhënësve për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar realizohet nga fakultetet arsimore (FA). Përkundër angazhimeve të MASHT-it dhe të FA-ve për të organizuar programe studimi

që janë në harmoni me kërkesat dhe nevojat e profesionit të mësimdhënës, ende nuk është arritur një gjë e tillë. Për momentin FA-të nuk përgatisin në nivel të mjaftueshëm mësimdhënës në harmoni me politikat e MASHT-it për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Për të gjetur zgjidhjet më efikase lidhur me këtë problem, MASHT-i duhet të rrisë bashkëpunimin me FA-të.

Për të siguruar një përgatitje më cilësore të mësimdhënësve, FA-të duhet t'i kushtojnë kujdes pranimit të studentëve të rinj, duke siguruar që në fakultete arsimore të regjistrohen studentë me bazë solide të njohurive që mundëson zhvillim profesional të tyre gjatë studimeve. Përzgjedhja e studentëve për regjistrim në profilet arsimore do të mundësonte që FA-të me anën e programeve studimore të përgatisin mësimdhënës të gatshëm për t'u sfiduar me kërkesat e profesionit të tyre.

Objektivi

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Prioriteti kryesor në këtë fushë është ndërtimi i sistemit të qëndrueshëm për zhvillim profesional të mësimdhënësve, i cili do të kontribuonte në zbatimin e reformës shkollore.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve mundëson organizim më të mirë të procesit mësimor. Po ashtu, përmes zhvillimit profesional mësimdhënësit arrijnë të përmirësojnë performancën e tyre duke ia përshtatur atë nevojave të nxënësve. Një qasje e tillë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e rezultateve më të mira të nxënësve. Po ashtu, është me rëndësi që risitë të bëhen pjesë e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve që zhvillohen nga fakultetet arsimore.

Rezultatet e pritshme

- 4.1. Ndërtohet sistem i qëndrueshëm i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të realizimit të reformës arsimore;
- 4.2. Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve;
- 4.3. Funksionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve;
- 4.4. Sigurohet përgatitja cilësore e mësimdhënësve para shërbimit.

Çështje të ndërlidhura

Pjesëmarrja në programe për zhvillim profesional ndihmon mësimdhënësit që të jenë më kreativë në përgatitjen e përmbajtjeve mësimore për nxënës, si dhe më efikas në realizimin e tyre. Kjo do të ndihmonte në përvetësimin sa më cilësor të përmbajtjeve mësimore nga ana e nxënësve (fusha 3). Programet për zhvillim profesional ndihmojnë mësimdhënësit që të jenë më fleksibilë në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për nxënësit e tyre, si dhe për të përdorur mjete të ndryshme të TIK-ut apo mjete të tjera për konkretizim të tyre. Po ashtu, pjesëmarrja në programin trajnues për zbatimin e KKK-së ofron informacion se si mësimdhënësit të zhvillojnë te nxënësit kompetencat e caktuara përmes realizimit të përmbajtjeve të ndryshme mësimore (fusha 5).

Përzgjedhja e mësimdhënësve për të marrë pjesë në programe të ndryshme të zhvillimit profesional varet nga udhëheqja e shkollës (fusha 2). Një përzgjedhje e bazuar në nevojat e mësimdhënësve do të ndihmonte në aftësimin e tyre për të realizuar mësimdhënie dhe të nxënë cilësor (fusha 3). Po ashtu, pjesëmarrja në programe të ndryshme do të ndihmonte mësimdhënësit që të realizojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin mësimor, duke i kushtuar kujdes të shtuar nxënësve me nevoja të veçanta dhe atyre nga grupet e marginalizuara (fusha 1).

Mësimdhënësit e shkollave profesionale, po ashtu, duhet të kenë një përgatitje pedagogjike para shërbimit, si dhe të marrin pjesë në programe për zhvillim profesional në mënyrë që të aftësohen për të zbatuar kurrikulën në fushat e tyre dhe për të organizuar mësimin sipas moduleve përkatëse (fusha 6). Përgatitja e mësimdhënësve para shërbimit bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, prandaj ky proces, domosdoshmërisht lidhet me nën-sektorin e arsimit të lartë (fusha 7).

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 4.1: Ndërtohet sistem i qëndrueshëm i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të realizimit të reformës arsimore

4.1.1 Rishikimi, hartimi dhe aprovimi i dokumenteve për ZHPM.

MASHT duhet të rishikojë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me ZHPM dhe të harmonizojë përmbajtjet e tyre. Po ashtu, duhet të hartohen edhe UA të cilat e plotësojnë rregullativën ligjore për realizim të ZHPM. MASHT duhet të hartojë dhe standardet e mësimdhënësve “para shërbimit” dhe të atyre “në shërbim” dhe të bëjë harmonizimin e tyre.

4.1.2 Ndërtimi i mekanizmave në nivel shkolle për identifikim të nevojave për ZHPM.

Në rast se shkolla ka shërbim pedagogjik, ky shërbim do të shqyrtojë planet individuale të mësimdhënësve për zhvillim profesional dhe do të këshillojë drejtorin e shkollës dhe Këshillin Drejtues të Shkollës mbi prioritetet për ZHPM. Këto prioritete do të integrohen në Planin Zhvillimor të Shkollës dhe do të dërgohen në DKA për të shqyrtuar mundësinë e organizimit të trajnimeve sipas nevojave dhe kërkesave të mësimdhënësve në nivel komunal.

4.1.3 Zhvillimi i një kornize nacionale për ZHPM të bazuar në nevojat dhe prioritet e identifikuar.

MASHT do të zhvillojë një kornizë afatgjate për ZHPM (2017-2021, si dhe plane pasuese vjetore) e cila do të përmbajë nevojat dhe kërkesat e mësimdhënësve për zhvillim profesional të identifikuar në nivel kombëtar dhe komunal, sipas gjuhëve mësimore, kërkesat për implementim të prioritetëve të përcaktuara në nivel qendror, si dhe nga rezultatet e dala nga procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Kjo kornizë do të shpërndahej tek ofertuesit e programeve për ZHPM në mënyrë që të bashkërendojnë aktivitetet e tyre. Në bazë të kësaj kornize, MASHT-i do të përcaktojë dhe koordinojë kontributet nga burimet e veta (IPK, FE), nga burimet e partnerëve zhvillimorë dhe të shoqërisë civile. Kjo kornizë do të përdoret edhe si pikë e rëndësishme referimi në procesin e akreditimit të programeve të reja dhe ri-akreditimin e atyre ekzistuese.

4.1.4 Hartimi i planit vjetor dhe i planit të KASH për financimin e ZHPM.

MASHT dhe DKA-të duhet të përgatisin plane vjetore lidhur me shpenzimet për ZHPM. Këto plane duhet të jenë në përputhje me planin e KASH.

4.1.5 Angazhimi i ekipeve profesionale të ekspertëve në nivel komune.

Komunat, të cilat kanë mundësi, do të angazhojnë ekipet profesionale të ekspertëve për të ndihmuar shkollat në hartimin e planeve vjetore dhe mujore të punës, si dhe në realizimin e aktiviteteve të ndryshme këshilluese dhe mentoruese për mësimdhënës.

4.1.6 Nxitja e hartimit të programeve trajnuese sipas prioritetëve (për KKK, metodologji, lëndore, arsim gjithëpërfshirës, TIK, mësim i integruar, etj.).

MASHT do të inkurajojë hartimin e programeve trajnuese në bazë të prioritetëve që ka përcaktuar ose nevojave që dalin ndërkohë.

4.1.7 Nxitja e hartimit të programeve për ZHPM të profileve joarsimore.

MASHT do të inkurajojë hartimin e programeve për ZHPM sipas nevojave specifike që kanë mësimdhënësit e profileve të ndryshme të shkollave profesionale.

4.1.8 Ndërtimi i një mekanizmi të financimit të qëndrueshëm për ZHPM.

MASHT, në bashkëpunim me DKA-të, duhet të ndërtojë një mekanizëm për financimin e ZHPM, i cili do të sigurojë që secili mësimdhënësi të mund të vijojë numrin minimal prej 100 orëve të trajnimit brenda periudhës 5 vjeçare. Kjo duhet të përfshijë të gjitha llojet e modeleve të bashkëfinancimit, përfshirë modelin e pagesave për trajnim, p.sh. për trajnime të avancuara.

4.1.9 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të programeve për ZHPM.

Divizioni për Zhvillim Profesional do të përgatisë një kornizë e cila do të përcaktonte afatet dhe modalitetet e monitorimit dhe vlerësimit të realizimit të programeve për ZHPM. Kjo kornizë do të shpërndahej te të gjithë aktoret e gatshme për mbështetjen e programeve për ZHPM. Në bazë të kësaj kornize do të realizohet monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të programeve për ZHPM. Monitorimi mund të realizohet nga MASHT ose organizata të ndryshme që kanë përvojë në monitorimin dhe vlerësimin e programeve trajnuese.

4.1.10 Organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit në nivel qendror dhe komunal (për zbatim të KKK, gjithëpërfshirje, TIK, metodologji të mësimdhënies, programe sipas fushave lëndore, për grupet e marginalizuara, vlerësim të performancës, mentorim, përgatitje të regjistrorit, hartim të PIA, etj.).

MASHT, në bashkëpunim me DKA-të dhe partnerët zhvillimorë, do të sigurojë minimumin e orëve për zhvillim profesional për të gjithë mësimdhënësit duke përfshirë mësimdhënësit që mbajnë mësim në gjuhët e komuniteteve, për të mundësuar përtëritjen e licencës apo avancimin në një nivel më të lartë të sistemit të gradimit. Trajnimet sipas mundësive do të organizohen në gjuhën e komuniteteve.

4.1.11 Organizimi i aktiviteteve për ZHPM në shkollë sipas nevojave të shkollës dhe në harmoni me kornizën afatgjate për zhvillim profesional.

Shkollat do të organizojnë trajnime, mentorime, mbështetje profesionale të ndryshme sipas nevojave të mësimdhënësve.

4.1.12 Organizimi i trajnimeve për zbatimin e kurrikulave bërthamë sektoriale dhe kornizave të profileve për AAP.

Duke marrë parasysh që profilet e shkollave profesionale janë plotësisht të ndryshme nga arsimimi i përgjithshëm, si dhe ka dallime brenda sektorit profesional, mësimdhënësve nga ky sektor do të ju ofrohen trajnime lëndore specifike. Kjo do të realizohet nën mbikëqyrjen e Divizionit të Arsimit Profesional dhe duke u mbështetur në kërkesat specifike për AAP.

4.1.13 Mbështetja e qendrave për ngritje profesionale në nivel komune.

MASHT-i, në bashkëpunim me DKA-të, do të mbështesë, në formë të ndryshme, veprimtarinë e qendrave për ngritje profesionale në nivel komune.

4.1.14 Sigurimi i materialeve/literaturës për ZHPM.

MASHT-i do të sigurojë udhëzues, materiale dhe manuale për zbatimin e KKK-së në nivele të ndryshme të shkollimit si dhe në të gjitha gjuhët mësimore në Kosovë.

4.1.15 Mbështetja e bashkëpunimeve në nivel rajonal dhe më gjerë.

Sipas nevojës, do të mundësohet pjesëmarrja e ekspertëve në takime, trajnime dhe konferenca të ndryshme në rajon dhe më gjerë.

Rezultati 4.2: Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve

4.2.1 Finalizimi i dokumenteve për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

Instrumentet e pilotuara duhet të korrigjohen, në mënyrë që të përfshihen të gjeturat nga procesi i pilotimit. Pakoja e instrumenteve të vlerësimit të performancës duhet të plotësohet me dokumente shtesë, të cilat duhet të aprovohen nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve.

4.2.2 Zhvillimi i licencimit të mësimdhënësve me bazë në performancë dhe skema e promovimit që definojnë kompetencat kyçe për secilin lloj të licencës në skemën ekzistuese dhe ndërlidhja e tyre me sistemin e pagave.

MASHT duhet të përgatisë skemën e promovimit që definojnë qartë kompetencat kyçe për secilin lloj të licencës. Po ashtu, MASHT do të bëjë dhe ndërlidhjen e licencave me sistemin e pagesave.

4.2.3 Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve dhe të vlerësuesve për vlerësim të performancës.

MASHT duhet të rrisë numrin e inspektorëve profesional dhe të vlerësuesve për të mundësuar realizimin e vlerësimit të performancës në të gjitha gjuhët mësimore në Kosovë. Për inspektorët ekzistues, inspektorët e rinj dhe vlerësuesit që do të angazhohen duhet të organizohen punëtori dhe forma të tjera të përkrahjes për ndërtimin e kapaciteteve të tyre për vlerësim të performancës.

4.2.4 Ngritja e kapaciteteve të shkollës (drejtorit, bashkëpunëtorëve profesional, mësimdhënësve) për vlerësim të performancës.

Disa aspekte të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve do të realizohen nga drejtori i shkollës dhe vetë mësimdhënësit. Për të realizuar këto obligime duhet të ndërtohen kapacitetet e drejtorëve të shkollave dhe të vetë mësimdhënësve për përdorimin e instrumenteve për vlerësim të performancës. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të bëhet edhe për shërbimet profesionale të shkollës, në mënyrë që ato të ndihmojnë drejtorët dhe mësimdhënësit në përdorimin e instrumenteve për vlerësim të performancës.

4.2.5 Ndërtimi i një programi hyrës për mësimdhënësit e rinj dhe aktivitetet e tjera të planifikuara me qëllim të përmirësimit dhe institucionalizimit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe zhvillimit profesional.

MASHT duhet të ndërtojë mekanizma për të mundësuar një program hyrës për mësimdhënësit e rinj, i cili do të mundësonte zhvillimin e kompetencave të tyre për planifikim dhe organizim të procesit mësimor.

4.2.6 Hartimi i planit të veprimit për vlerësim të performancës.

Vlerësimi i performancës realizohet për herë të parë në Kosovë dhe këtij procesi kanë mundësi t'i nënshtrohen të gjithë mësimdhënësit. Zyra e Inspektoratit do të hartojë një plan në të cilin do të përcaktojë dinamikën e organizimit të procesit të vlerësimit të performancës. Ky plan do të përgatitet në bashkëpunim me DKA-të për të siguruar bashkërendimin e aktiviteteve për realizimin e tij, si dhe të konsultohet me mësimdhënës, duke përfshirë ata që mbajnë mësim në gjuhët e komuniteteve.

4.2.7 Organizimi i procesit të vlerësimit të performancës.

Procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve do të organizohet për të gjithë mësimdhënësit sipas planit të veprimit që harton Zyra e Inspektoratit.

4.2.8 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit për vlerësimin e performancës.

Për këtë qëllim duhet të ketë angazhim të veçantë të ekipit të ekspertëve që do të zhvillojë kornizën e monitorimit, përmbledhjen e informacionit nga raportet dhe përgatitjen e rekomandimeve që dalin nga ky proces.

4.2.9 Përdorimi i të dhënave nga procesi i vlerësimit të performancës për politikë-bërje dhe caktim të prioritetëve për ZHPM në nivel kombëtar.

MASHT duhet t'i kushtojë kujdes analizimit të të dhënave që dalin nga procesi i vlerësimit. Një gjë e tillë do të ndihmonte MASHT në hartimin e politikave dhe në përcaktimin e programeve prioritare për ZHPM.

Rezultati 4.3: Funksionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve

4.3.1 Hartimi i Planit të veprimit për zbatimin e procesit të licencimit.

Duhet të hartohet një plan në të cilin do të përcaktohen modalitetet e zbatimit të procesit të licencimit. Ky plan duhet të jetë në harmoni me dinamikën e planit të veprimit për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

4.3.2 Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për sigurimin e mjeteve financiare për procesin e licencimit të mësimdhënësve (MF, MAP, Kuvendi i Kosovës).

Licencimi i mësimdhënësve është i lidhur me sistemin e gradimit, i cili duhet të reflektojë në sistemin e pagave. Shpenzimet shtesë duhet që të reflektohen edhe në KASH.

4.3.3 Informimi i mësimdhënësve për sistemin e licencimit.

Mësimdhënësit duhet të informohen lidhur me procesin e licencimit të tyre. Për këtë arsye duhet të organizohen aktivitete të ndryshme me qëllim të informimit të mësimdhënësve lidhur me këtë proces, si: fushata informimi, debate, takime, tryeza të rrumbullakëta, klipe në TV, shpërndarje e materialeve informuese, etj.

4.3.4 Zbatimi i procesit të gradimit dhe harmonizimi me sistemin e pagave.

Në bazë të planit të veprimit duhet të organizohet procesi i ri-licencimit apo avancimit të mësimitdhënësve në nivele të ndryshme të licencimit. Pas 5 viteve, së paku 35% e mësimitdhënësve do të licencohen si mësimitdhënës të avancuar. Gradimi i mësimitdhënësve në nivele të tjera do të përcillet me rritje në sistemin e pagave.

4.3.5 Organizimi i procesit të licencimit për mësimitdhënësit fillestarë.

Sipas Ligjit për profesionet e rregulluara mësimitdhënësit fillestarë duhet të kryejnë provimin shtetëror dhe të pajisen me licencë për të ushtruar profesionin e tyre. Kjo do të mundësonte që në konkursin për mësimitdhënës të aplikojnë ata të cilët kanë zgjedhur si karrierë të tyre profesionin e mësimitdhënësit. Po ashtu, kjo do të lehtësonte procesin e licencimit të mësimitdhënësve, sepse do të siguronte që në sistem të hynin mësimitdhënësit e licencuar dhe të mos merret sistemi me ta në mënyrë retroaktive. Kjo do të lidhet edhe me vendosjen e një mekanizmi mbështetës të mësimitdhënësve fillestar në shkollë (dhe lidhja me licencën provuese) dhe ofrimin e mbështetjes në formë mentorimi në shkollë për mësimitdhënësit fillestar. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet akomodimit të nevojave të mësimitdhënësve fillestarë që japin mësim në gjuhët e komuniteteve.

4.3.6 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të veprimit për licencimin e mësimitdhënësve.

Për këtë qëllim duhet të ketë angazhim të veçantë të ekipit të ekspertëve të cilët do të zhvillojnë kornizën e monitorimit, përmbledhjen e informacionit dhe përgatitjen e rekomandimeve që dalin nga ky proces. Duhet t'i kushtohet kujdes analizës së të dhënave që dalin nga procesi i vlerësimit. Një gjë e tillë do të ndihmonte MASHT-in në hartimin e politikave dhe në përcaktimin e programeve prioritare për ZHPM në nivel kombëtar.

Rezultati 4.4: Sigurohet përgatitja cilësore e mësimitdhënësve para shërbimit

4.4.1 Përcaktimi i standardeve të pranimit të studentëve në fakultete arsimore (FA).

FA duhet të zhvillojnë kriteret për pranim të studentëve. Pas aprovimit të tyre nga MASHT-i, FA duhet të përshtatin proceset e tyre të përzgjedhjes në përputhje me këtë.

4.4.2 Harmonizimi i programeve të FA me politika të MASHT.

FA duhet të zhvillojnë programe për përgatitjen e mësimitdhënësve para-shërbimit që janë në përputhje me kurrikulin e ri. Këto programe duhet të akreditohen nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.

4.4.3 Rritja e kapaciteteve të FA për hartimin dhe zbatimin e programeve sipas KKK.

FA duhet të ndihmojnë mësimitdhënësit në hartimin e programeve që mundësojnë aftësimin e studentëve të tyre për të zbatuar me sukses KKK në fusha të caktuara mësimore dhe në nivele të ndryshme të arsimit. FA duhet të shtojnë bashkëpunimin me mësimitdhënës të dalluar në mënyrë që të realizohet me sukses praktika profesionale, si një mundësi për përgatitje cilësore të studentëve të tyre. MASHT-i, në partneritet me FA-të, mund të gjejnë forma të ndryshme stimulimi për mësimitdhënësit që përfshihen në këtë proces.

4.4.4 Organizimi i hulumtimeve nga ana e stafit të FA lidhur me zbatimin e KKK, metodologjive, gjithëpërfshirjes, etj.

Stafi i FA duhet të inkurajohet për të realizuar hulumtime të cilat do të analizonin aspektet e ndryshme të zbatimit të KKK, të ndikimit të metodologjive të ndryshme në procesin mësimor (p.sh. mësimitdhënësit lëndorë për disa lëndë në klasën e katërt dhe të pestë), në sigurimin e

gjithëpërfshirjes në klasë të nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe të atyre që janë të marginalizuar, etj.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Krijimi i një mekanizmi për financim të ZHPM, i cili do të mundësonte që secili mësimdhënës të vijonte numrin minimal të orëve të trajnimit brenda periudhës 5 vjeçare.
- Kapacitetet e drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve dhe inspektoratit të arsimit për të realizuar me sukses procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.
- Transparenca dhe llogaridhënia e mekanizmave që realizojnë procesin e vlerësimit të performancës dhe të licencimit të mësimdhënësve.
- Sigurimi i mjeteve të nevojshme buxhetore për të lidhur procesin e licencimit të mësimdhënësve me sistemin e pagave.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Pamundësia për të ofruar trajnim për të gjithë mësimdhënësit për të siguruar numrin minimal të orëve të trajnimit brenda periudhës pesë vjeçare.
- Numri i pamjaftueshëm i inspektorëve të arsimit dhe mungesa e kapaciteteve profesionale për të realizuar vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.
- Moszbatimi i procedurave dhe kriterëve për realizimin e procesit të vlerësimit të performancës dhe të licencimit të mësimdhënësve.
- Kufizimet buxhetore për lidhjen e sistemit të licencimit të mësimdhënësve me sistemin e pagave.

10. Objektivi strategjik 5: Mësimdhënia dhe të nxënit

Të gjitha hulumtimet tregojnë se nxënësit mësojnë më së miri kur dinë se si mësohet dhe i përkushtohen të nxënit. Mësimdhënësi dhe shkolla ofrojnë mundësitë më të mira për këta nxënës, nëse shfrytëzojnë parimet e pranuar të të nxënit. Përveç tjerash, parimet e tilla nënkuptojnë: këshillimin e nxënësve, vlerësimin e të nxënit, zhvillimin e shkathtësive të të menduarit dhe aktivitetet që nxisin procesin e të nxënit. Të gjitha këto duhet të jenë pjesë e kurrikulës, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë një shkallë të autonomisë në procesin e të nxënit.

Mësimdhënia dhe mësimdhënësit janë faktorët kryesorë që ndikojnë në përmirësimin e rezultateve të të nxënit. Aftësimi i fëmijëve për të nxënë në mënyrë të pavarur, është vet thelbi i ekspertizës së një mësimdhënësi. Hulumtimet tregojnë se mësimdhënia e orientuar kah aftësimi i nxënësit për të nxënë mund të ndikojë dukshëm në vet rezultatet e të nxënit, duke prodhuar efekte pozitive në fusha kurrikulare të caktuara.

Tekstet shkollore dhe materialet tjera mësimore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mësimdhënie dhe të nxënë. Prandaj, janë të nevojshme mekanizma që, në vazhdimësi, sigurojnë se tekstet dhe materialet tjera mësimore janë të cilësisë së duhur, në aspektin e relevancës, të përmbajtjes, të qasjeve pedagogjike dhe të efektivitetit. Nxitja e të nxënit përmes teknologjisë kërkon më shumë se harduerin dhe softuerin. Këto janë vetëm mjete pune, ndërsa është mësimdhënësi ai që vë në shfrytëzim materialet e ndryshme elektronike për të ndikuar në arritjen e rezultateve të të nxënit.

Sfidat

Vështirësi në zbatimin e kurrikulës së re

Korniza e Kurrikulës e Kosovës (KKK) paraqet një zhvendosje nga mësimdhënia dhe të nxënit të bazuara në objektiva dhe përmbajtje mësimore drejt mësimdhënies dhe të nxënit të bazuara në rezultate të pritshme dhe në zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Qasja e tillë implikon përgjegjësi më të madhe për shkollën dhe mësimdhënësit, të cilët ngarkohen me zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies, si dhe të materialeve dhe mjeteve mësimore. Po ashtu, komunat kanë përgjegjësi për ofrimin e mbështetjes për zbatimin e kurrikulës së re, ndërsa niveli qendror për koordinimin dhe mbikëqyrjen e procesit të shtrirjes së kurrikulës së re në të gjitha shkollat.

Problemi i teksteve shkollore dhe materialeve të tjera

Kurrikula e re promovon fleksibilitetin e mësimdhënësve në përzgjedhjen e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve të të nxënit në fusha kurrikulare dhe në lëndë të caktuara. Për kushtet e Kosovës, konsiderohet se tekstet shkollore janë të domosdoshme, por edhe se duhet të punohet në zhvillimin e materialeve elektronike të përshtatshme për shfrytëzim në klasë, si dhe të inkurajohen mësimdhënësit të zhvillojnë materiale të veta dhe t'i ndajnë ato me të tjerët. Aktivet profesionale (apo departamentet) duhet të marrin përsipër një masë të sigurimit të cilësisë së materialit dhe të përfshijnë mësimdhënësit në diskutim për Standardet e Cilësisë për tekstet shkollore⁴⁵, të cilat, në parim, janë relevante për të gjithë materialin. Zhvillimi i teksteve shkollore që përcjellin një kurrikulë të bazuar në kompetenca paraqet sfidë, pasi nuk ekziston përvoja e hartimit të teksteve të tilla. Po ashtu, siguri i cilësisë së teksteve shkollore dhe materialeve të tjera nuk ka funksionuar gjithnjë si duhet.

⁴⁵ MASHT Udhëzimi Administrativ nr. 5/2011 në Standardet për Tekste Shkollore
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8050>

Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i TIK-ut dhe mjeteve të tjera të konkretizimit në shkolla

Shfrytëzimi i burimeve elektronike për zbatimin e kurrikulës së re është domosdoshmëri e kohës e cila duhet ta plotësojë përcjelljen e renditjes së njësive mësimore nga teksti shkollor dhe materialet tjera. Nga ana tjetër, kushtet teknike në shkolla për shfrytëzimin e burimeve të tilla janë të papërshtatshme, në radhë të parë për shkak të pranisë së kufizuar të pajisjeve të TIK-ut, por edhe mungesë së mirëmbajtjes së tyre. Po ashtu, shkathtësitë e mësimdhënësve për vënien e TIK-ut në funksion të mësimdhënies cilësore nuk janë në nivelin e duhur. Shkollat kanë edhe mungesë të theksuar të mjeteve të tjera të konkretizimit që nuk mund të zëvendësohen me harduer dhe softuer adekuat. Pajisjet për demonstrim praktik, si dhe laboratorët e specializuar apo tabelat ose hartat e thjeshta të cilat duhet të varen në mure, të dukshme si ekspozim afatgjatë për nxënësit, bëjnë pjesë, gjithashtu, në mjete të konkretizimit.

Objektivi

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.

Zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat është prioriteti kryesor në këtë fushë. Përveç trajnimit të mësimdhënësve kjo duhet të përgatitet edhe me hartimin e teksteve shkollore dhe të materialeve mësimore që janë në harmoni me kurrikulën e re, duke

përfshirë edhe materialet mësimore elektronike. Kjo nënkupton që kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pajisjes së shkollave me mjete të TIK-ut, por edhe me mjete të tjera të konkretizimit.

Rezultatet e pritshme

- 5.1. Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë;
- 5.2. Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët;
- 5.3. Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit të nevojshme për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re.

Çështje të ndërlidhura

Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re në të gjitha shkollat, në masë të madhe, varet nga aranzhimet për sigurimin e cilësisë (fusha 3), në veçanti lidhur me organizimin e punës së aktiveve (departamenteve) shkollore, si dhe me ofrimin e mbështetjes shkollave nga niveli komunal. Po ashtu, aktivitetet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (fusha 4) ndihmojnë zbatimin e kurrikulës së re, pasi që ky proces varet, thellësisht, nga përgatitja e mësimdhënësve. Zbatimi i kurrikulës në arsimin profesional (fusha 6) kërkon një qasje specifike e cila është sqaruar në kapitullin vijues. Nga shkollat kërkohet që qasjen kurrikulare t'ia përshtatin fëmijëve me nevoja të veçanta, ndërsa qasje specifike duhet të kenë shkollat në numër domethënës të nxënësve nga grupe të marginalizuara (fusha 1). Gjithsesi, kurrikula e re duhet të promovojë barazinë gjinore dhe në përgjithësi, barazinë në mes të njerëzve që duhet të reflektohet në përmbajtje mësimore, tekste shkollore dhe në materiale mësimore.

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 5.1: Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë

5.1.1. Zhvillimi i kurrikulave dhe planprogrameve sipas klasës dhe lëndës.

Për të mbështetur implementimin e kurrikulës së re, MASHT do të zhvillojë kurrikulën dhe planprogramin për çdo klasë dhe lëndë. Në këtë proces, integrimi i lëndëve konsiderohet kurdo që të jetë e mundshme dhe duhet të merret parasysh materiali i zhvilluar nga mësimdhënësit në shkollat pilote të kurrikulit. Kurrikulat dhe planet mësimore do të përfshijnë tema për historinë, kulturat dhe traditat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Kjo duhet standardizuar si pjesë e kurrikulës së përgjithshme të detyrueshme, por edhe në module specifike për pjesëtarët e komuniteteve, në përkrahje dhe ruajtje të identitetit, gjuhës dhe kulturës së tyre.

5.1.2. Hartimi i programeve të trajnimit dhe materialeve trajnuese përcjellëse.

Këto programe shërbejnë për përgatitjen e mësimdhënësve, drejtorëve dhe administratorëve të arsimit për zbatimin e kurrikulës së re.

5.1.3. Trajnimi i mësimdhënësve nga të gjitha shkollat për zbatimin e kurrikulës së re.

Ky lloj trajnimi duhet të organizohet përmes p.sh. aktiviteteve të zhvillimit profesional të planifikuara në kuadër të objektivit 4 (aktivitetet 4.1.13-4.1.15). Aktivitet profesional / departamentet mund të marrin një rol të rëndësishëm si forum për shkëmbim dhe planifikim të përbashkët.

5.1.4. Trajnime për drejtorë, zyrtarë komunalë të arsimit dhe inspektorë për zbatimin e kurrikulës së re.

5.1.5. Informimi i prindërve me procesin e zbatimit të kurrikulës së re dhe konsultimet e vazhdueshme me ta.

Fushatë informimi mund të organizohet në nivel vendi ose komune, por edhe shkollat duhet aftësuar që të organizojnë informim të tilla dhe të zhvillojnë konsultime të vazhdueshme me prindër.

5.1.6. Monitorimi sistematik i zbatimit të kurrikulës së re nga niveli i shkollës, i komunës dhe niveli qendror.

Për këtë qëllim duhet të ketë aranzhime të veçanta të monitorimit që nënkupton zhvillimin e një kornize të monitorimit, përmbledhjen dhe analizën e rezultateve dhe dërgimi i rezultateve mbrapa tek niveli i politikave për vendim-marrje.

5.1.7. Rishikimi i vazhdueshëm i kurrikulës së re.

Procesi i rishikimit është i lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kurrikulës dhe drejtohet nga MASHT-i.

5.1.8. Organizimi i vlerësimit për shkallët kurrikulare.

Kjo është një qasje krejtësisht e re për sistemin e arsimit në Kosovë, pasi vlerësohet arritja e kompetencave në nivel të shkallës kurrikulare. Prandaj, duhet të ndërtohet sistemi i vlerësimit të jashtëm që bën të mundur marrjen e një hapi të tillë. Preferohet që intervalet

të përputhen me vlerësimin e jashtëm të dakorduar nga Qeveria e Kosovës në Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm, treguesit që lidhen me objektivin 4⁴⁶.

Rezultati 5.2: Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët

5.2.1. Përcaktimi i procesit të hartimit të teksteve të reja shkollore.

Për të siguruar cilësinë e teksteve shkollore duhet definuar procesin e hartimit të tyre ku përcaktohen modalitetet përkatëse. Kjo duhet të përcillet me aktivitete informuese për autorët e teksteve. Procesi duhet të parasheh mekanizma për përmirësimin e gabimeve. Hartimi i të gjitha teksteve të reja shkollore dhe materialeve të tjera mësimore duhet të sigurojë promovimin e vlerave të diversitetit dhe tolerancës mes kulturave, si dhe promovimin e barazisë gjinore.

5.2.2. Përgatitja e teksteve shkollore për të gjitha lëndët dhe për të gjitha klasat në arsimin e përgjithshëm.

Ky proces duhet të kryhet duke nxitur publikimin e teksteve alternative dhe duke ofruar mundësinë e përzgjedhjes së tyre nga shkollat. Po ashtu, do të kërkohen rrugë se si mund të përmirësohet sigurimi i teksteve shkollore cilësore për komunitetet.

5.2.3. Trajnimi i mësimitdhënësve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike.

Mësimitdhënësit duhet të aftësohen për përgatitjen e materialeve elektronike nga fusha e tyre, por edhe për kërkimin, adaptimin dhe shfrytëzimin efektiv të materialeve të tjera që janë në dispozicion përmes platformave elektronike. Po ashtu, duhet nxitur mësimitdhënësit që të materiale elektronike të zhvilluara t'i ndajnë ato me të tjerët, duke stimuluar kështu krijimin dhe pasurimin e platformave elektronike.

Rezultati 5.3: Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit, të nevojshme për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re

5.3.1. Sigurimi i qasjes në Internet me brez të gjerë për të gjitha shkollat.

Secili objekt shkollos në Kosovë duhet të ketë qasje në Internet me brez të mjaftueshëm për shfrytëzimin efektiv të burimeve nga Interneti. Po ashtu, shkollat duhet të kenë rrjet lokal që mbulon hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor.

5.3.2. Furnizimi i shkollave me kompjuterë dhe me infrastrukturë të TIK-ut dhe mjeteve të tjera të nevojshme.

Ideja është që shkollat të pajisjen me numër të mjaftueshëm të kompjuterëve, projektorëve ose televizorëve të tipit SMART që mundësojnë shfrytëzimin e TIK-ut në klasa. Pajisjet e tilla, në masë të madhe, plotësojnë mjetet e tjera të konkretizimit, si hartat, posterët, madje edhe disa pajisje laboratorike.

5.3.3. Hartimi i planeve për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të TIK-ut.

Në kushtet e Kosovës, mirëmbajtja e pajisjeve të TIK-ut duhet të organizohet nga shkollat dhe komunat. Shkollat duhet të jenë përgjegjëse për evitimin e defekteve në softuer dhe harduer deri në masën kur nuk kërkohet ndërhyrja e profesionistit, ndërsa komunat për kontraktimin e shërbimeve të riparimit.

⁴⁶ <http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

5.3.4. Promovimi i shfrytëzimit të pajisjeve personale të TIK-ut.

Duke marrë parasysh se një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe mësimeve kanë pajisje personale si laptopë ose telefona SMART, duhet të inkurajohet shfrytëzimi i tyre në mjedisin shkollor. Në mënyrë që të mos rrezikohet parimi i gjithëpërfshirjes, kjo masë duhet të përcillet nga një skemë e subvencionimit për blerjen e tabletave funksionale me çmim të ultë, për nxënësit nga familjet e sfiduara ekonomikisht.

5.3.5. Subvencionimi i laptopëve për mësimeve.

Shteti do të punojë për lidhjen e marrëveshjeve me distributorë të kompjuterëve që t'u bëhet e mundur mësimeve t'i blejnë laptopët me çmime të subvencionuara nga shteti ose me kushte të volitshme të kreditimit.

5.3.6. Furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi të nevojshme për zbatimin e kurrikulës së re.

Secila shkollë do të pajiset me pako standarde të mjeteve të konkretizimit të nevojshme për zbatimin efektiv të kurrikulës në shkollë.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Përfundimi i suksesshëm i pilotimit të Kurrikulës në 92 shkolla dhe zbatimi i rekomandimeve për evitimin e lëshimeve që janë vërejtur gjatë këtij procesi.
- Gatishmëria e komunave për të mbështetur procesin e zbatimit të Kurrikulës së re në shkolla.
- Kapaciteti i botuesve në Kosovë për të siguruar tekste mësimore cilësore, duke ndjekur dinamikën e shtrirjes së kurrikulës në shkolla.
- Motivimi i mësimeve që të kontribuojnë në zhvillimin e materialeve mësimore elektronike, duke i ndarë ato me të tjerët.
- Gatishmëria dhe kapacitetet e komunave që të marrin mbi vete mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut dhe të kujdesen për zëvendësimin e kohëpaskohshëm të tyre.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Kapacitetet e kufizuara për trajnimin e mësimeve për zbatimin e Kurrikulës së re.
- Mungesa e kapacitetit për t'i ofruar përkrahje shkollave në zbatimin e Kurrikulës së re.
- Vonesa e teksteve mësimore të reja dhe krijimi i situatave kur duhet të punohet me tekste ekzistuese që mund të rezultojë me kthimin në qasjen e vjetër – të bazuar në përmbajtje.
- Mungesa e buxhetit në nivelin komunal për mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut.
- Cilësia jo e mirë e materialeve elektronike të hartuara nga mësimeve dhe e atyre komerciale.
- Kufizime në shfrytëzimin e materialeve elektronike nga platforma ndërkombëtare për shkak të mosnjohjes së gjuhës angleze.
- Mungesa e teksteve dhe materialeve mësimore në gjuhët e komuniteteve.
- Dështimi për të siguruar ekspertizë të mjaftueshme gjinore për të zhvilluar rishikim të nevojshëm dhe analizë në procesin e hartimit të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore për të siguruar promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipave gjinorë dhe paragjyqimeve.

11. Objektivi strategjik 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi i të Rriturve

Qëllimi i arsimit dhe aftësimit profesional është t'i pajisë vijuesit me kompetenca dhe shkathtësi të nevojshme për të qenë më konkurrues dhe për t'u pozicionuar në tregun e punës. Mungesa e aftësive, në shumicën e fushave përkatëse profesionale, kufizon zhvillimin ekonomik të vendit. Cilësia e arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe harmonizimi i kërkesave të sistemit arsimor me tregun e punës, ndikojnë në ngritjen profesionale të individëve, në mirëqenien sociale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit, përkatësisht, në rritjen e vetëpunësimit dhe të punësueshmërisë.

Rezultatet e hulumtimeve të tregut të punës janë baza esenciale për zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve të profesioneve dhe programeve të AAP-së. Për zbatimin e tyre është e nevojshme që të bëhet trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve dhe instruktorëve. Zhvillimi i materialeve mësimore, si dhe pajisja e punëtorive të shkollave profesionale për të mundësuar zbatimin e kurrikulave të AAP dhe mësimin praktik me bazë në shkollë, janë ende sfida, prandaj duhet gjetur forma dhe mundësi të bashkëpunimit me biznese për realizimin e mësimin praktik në vendin e punës.

Është e rëndësishme që të punohet në vetëdijësimin e prindërve dhe të shoqërisë, në përgjithësi, lidhur me orientimin e të rinjve në karrierën e tyre profesionale. Nxënësit që nuk kanë interesim për studime akademike duhet të kenë mbështetjen e prindërve dhe të mësimdhënësve për arsimim dhe aftësim në shkollat profesionale. Me kombinimin e mençur të shkathtësive njohëse (kognitive) dhe atyre teknike, mund të ngrihen kompetencat e përgjithshme dhe profesionale duke kontribuar në zhvillimin e profesioneve të kërkuara nga tregu i punës.

Arsimi dhe aftësimi profesional është pjesë e arsimit parauniversitar, dhe kualifikimet e AAP-së duhet të jenë të bazuara në kërkesat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulës bërthamë të AAP-së dhe të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është komponentë e rëndësishme në kuadër të reformave të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional në Kosovë. KKK është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas llojeve të kualifikimeve dhe përshkruesve të nivelit. KKK synon të përmirësojë qasjen në punësim dhe në të mësuarit e mëtutjeshëm, duke u siguruar që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat e tregut të punës, t'i përmbushin kërkesat e kandidatëve, të ekonomisë dhe të institucioneve të arsimit dhe aftësimit. Struktura themelore e KKK përbëhet prej tetë niveleve në të cilat mund të vendosen kualifikimet. Secili nivel i KKK është i përcaktuar me përshkrimin e rezultateve të të nxënës, në formë të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave më të gjëra.

AAP shtrihet në disa nivele të sistemit arsimor, mbulon nevojat e të rinjve dhe të rriturve për ngritje të vazhdueshme profesionale dhe punësim, duke përfshirë partnerët socialë, si odat ekonomike, sindikatat dhe ministritë e ndryshme, në procesin e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të politikave të AAP-së. Kjo e bën nën-sektorin e AAP-së shumë kompleks për t'u menaxhuar, prandaj është e domosdoshme të qartësohen dhe të ndahen detyrat dhe përgjegjësitë në mes të palëve të interesit, si dhe të vendoset bashkëpunim efikas në mes tyre.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është themeluar me Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare në Kosovë dhe është element thelbësor i sistemit kombëtar të kualifikimeve në Kosovë. AKK është përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kualifikimeve kombëtare dhe zhvillimin e

politikave dhe strategjive për zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve. AKK definojnë llojet dhe nivelet e certifikatave dhe diplomave, që do të përfshihen në KKK, si dhe aprovon kualifikimet e propozuara për përfshirje në KKK. AKK kryen sigurimin e jashtëm të cilësisë, që çon në dhënien e kualifikimeve në KKK dhe realizon procesin e akreditimit për institucionet për vlerësimin e kandidatëve dhe lëshimin e certifikatave për kualifikimet në KKK. Po ashtu, AKK është përgjegjëse për verifikimin e standardeve të profesionit.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur është themeluar në bazë të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, dhe ka për qëllim mbikëqyrjen dhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe për të rritur në Kosovë. AAAPRr është përgjegjëse për administrimin dhe udhëheqjen e institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional dhe për të rritur (IAAPRr) lidhur me burimet financiare, njerëzore, objekteve ndërtimore dhe infrastrukturës të të gjitha institucioneve publike të AAP dhe të mbikëqyrë bartjen graduale të përgjegjësisë relevante të shkollat profesionale duke u bazuar në kapacitetet e tyre. Po ashtu, AAAPRr mbikëqyrë dhe koordinon zhvillimin e standardeve të profesionit. Bazuar në vlerësimin e periudhës së pilotimit do të duhej të përcaktohen saktë fushat e veprimit të Agjencisë të cilat mund të rezultojnë edhe me ndryshime legislative.

Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur i themeluar në bazë të Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional është organ këshillëdhënës për politikën e AAP dhe arsimin e të rriturve në Kosovë. KAAPRr ofron këshilla dhe rekomandon për aprovim profilet, në të cilat duhet të bazohen programet e arsimit dhe aftësimin profesional, standardet për çdo profil, përmbajtjen profesionale të plan programit për këto profile dhe kualifikimet profesionale, që duhet të përfshihen brenda kornizës së kualifikimeve, si dhe rekomandon librat shkollore dhe materialet mësimore për shfrytëzim në programet e tilla. KAAPRr është përgjegjëse për miratimin e standardeve të profesionit.

Sfidat

Mospërshtatja e programeve të AAP-së me kërkesat e tregut të punës

Aktualisht, në IAAP ofrohen rreth 140 profile nga sektorë të ndryshëm ekonomikë, relevanca e të cilëve vazhdimisht duhet të rishikohet dhe të përshtatet me kërkesat e tregut të punës, përfshirë optimizimin gradual të rrjetit të IAAP. Sfida mbeten zhvillimi i kapaciteteve për analizën e nevojave për shkathtësi dhe kapaciteteve për parashikim, numri i kufizuar i standardeve të profesionit, rishikimi dhe zhvillimi i kurrikulave sipas standardeve të profesionit, trajnimi i mësimdhënësve dhe instruktorëve, pajisja e punëtorive, materialet mësimore dhe mbështetëse dhe realizimi i praktikës profesionale. Shkollat profesionale duhet të plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe të përgatiten për procesin e akreditimit që do të bëhet nga AKK, në përputhje me legjislacionin.

Vështirësi në sigurimin e materialeve mësimore për AAP

Përvoja tregon se materialet e zhvilluara nga mësimdhënësit, në mungesë të teksteve mësimore në AAP, mund të mblidhen, të redaktohen dhe të publikohen në platforma elektronike ku mund të shfrytëzohen nga të gjithë mësimdhënësit dhe të gjitha shkollat. Megjithatë, ka nevojë që të ngrihet kapaciteti i mësimdhënësve për zhvillimin e materialeve mësimore dhe mbështetëse sipas kërkesave të kurrikulit, dhe duke u bazuar në nevojat e sektorëve ekonomikë.

Mungesa e Kurrikulës Bërthamë për AAP

Procedurat e akreditimit të programeve në AAP e definojnë qartë se të gjitha kurrikulat duhet të jenë modulare, të bazuara në kompetenca dhe me kritere të qarta vlerësimi. Të gjitha këto do të

zhvillohen në Kurrikulën bërthamë për AAP, e cila do të jetë në përputhje me parimet e Kornizës së kurrikulit për arsim parauniversitar, dhe me kërkesat e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Kurrikula bërthamë për AAP duhet të përmbushë nevojat e sektorëve ekonomikë, dhe të shërbejë si udhërrëfyes për zhvillimin e standardeve të profesioneve dhe kornizave kurrikulare të profileve profesionale. Kurrikuli bërthamë për AAP duhet të ofrojë më shumë orë të praktikës profesionale, si dhe më shumë përmbajtje specifike të profesionit. Gjatë procesit kalimtar është me rëndësi që kurrikuli bërthamë për AAP të mundësojë fleksibilitet për disa profile, bazuar në kapacitetet përkatëse të shkollave, për të zhvilluar më tutje qasjen e të mësuarit me bazë në vendin e punës.

Mangësi serioze në punën praktike dhe praktikën profesionale

Koncepti i AAP është i ndërtuar mbi praktikën profesionale në shkollë dhe në ndërmarrje. Sfidë mbetet mungesa e pajisjeve të punëtorive për realizimin e mësimit praktik në shkollë. IAAP kanë mungesë të bashkëpunimit me sektorin e biznesit, në ofrimin e përgatitjes adekuate profesionale dhe realizim të punës praktike të kandidatëve gjatë aftësimit profesional. Praktikatat profesionale të cilësisë së lartë do të rrisin mundësitë e kandidatëve për vetëpunësim, punësim, por edhe mundësitë për punësim në ato ndërmarrje ku përfundojnë praktikën.

Mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë

Këshillimi dhe orientimi në karrierë është një shërbim i domosdoshëm për një sistem funksional të AAP-së në vend. Ky shërbim, përmes këshilltarëve të karrierës, do të sigurohet për të gjitha shkollat e AAP-së.

Problemi i qëndrueshmërisë së qendrave të kompetencës dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre

Me ndihmën e partnerëve zhvillimorë është investuar në infrastrukturën dhe burimet njerëzore të këtyre institucioneve, por sfida mbetet qëndrueshmëria e tyre financiare dhe menaxheriale, si dhe shndërrimi i tyre në qendra që ofrojnë shumëllojshmëri të shërbimeve. Formula për financimin e AAP-së duhet të rishikohet dhe të adaptohet me nevojat e arsimit dhe aftësimit profesional, dhe, në veçanti, të qendrave të kompetencës. Duhet të avancohen rregulloret për mundësitë e gjenerimit dhe shfrytëzimit të mjeteve vetanake. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm duhet të bëhet për menaxherët dhe personelin mësimor të IAAPRr.

Mungesa e sistemit efikas të arsimit për të rriturit

Edhe pse statistikat tregojnë se struktura e popullsisë në Kosovë është e moshës së re, duhet të tregohet gatishmëri në ofrimin e mundësisë për arsimim gjatë gjithë jetës për personat që nuk e kanë përfunduar shkollimin bazik, nuk kanë ndonjë kualifikim apo dëshirojnë që të ri kualifikohen për qëllim të punësimit apo ndërtimit të karrierës. Përgjegjësia për arsimin dhe aftësimin e të rriturve në Kosovë është e ndarë ndërmjet të disa ministrive, por aktivitete zhvillohen edhe nga OJQ-të, sektori privat dhe të tjerë. MASHT do të kontribuojë që kjo fushë të jetë e hapur për të gjithë ofruesit, dhe të ngritë kapacitetet e saja njerëzore dhe fizike për menaxhim të arsimit për të rriturit përmes masave konkrete.

Objekti

Harmonizimi i arsimit dhe aftësisht profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

Prioriteti kryesor i kësaj fushe qëndron në bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet shkollës dhe tregut të punës. Arsimi dhe aftësimi profesional në të dy nivelet, atë të mesëm të lartë dhe post sekondar, duhet të financohet mirë dhe të zbatohet në mënyrë efektive.

Rezultatet e pritshme:

- 6.1. Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP-së janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës;
- 6.2. Është rritur për 30% regjistrimi i nxënësve në drejtimet deficitare dhe për 20% numri i femrave në drejtimet teknike;
- 6.3. Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare;
- 6.4. Kurrikulat e AAP-së dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- 6.5. Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë dhe praktikën profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor;
- 6.6. Këshillimi dhe orientimi në karrierë është funksional në sistemin e shkollimit për nxënësit dhe të rriturit;
- 6.7. Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese;
- 6.8. Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rriturit;
- 6.9. Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve.

Çështjet e ndërlidhura

Promovimi i barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes në AAP-së zë vend të veçantë, prandaj këto çështje janë të ndërlidhura ngushtë me objektivin e parë (Fusha 1) të kësaj strategjie. Financimi i kësaj fushe mbetet çështje e rëndësishme në të gjitha nivelet ku ofrohet, prandaj edhe është propozuar rishikimi i formulës së financimit në shkollat e AAP dhe QK, të cilën e trajton më në hollësi menaxhimi i sistemit arsimor (Fusha 2) i këtij dokumenti. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në AAP ka specifikat e veta, prandaj disa aspekte specifike mbeten të trajtohen këtu. Ndërsa pjesa më e madhe e zhvillimit profesional, ku përfshihet aspekti metodik-didaktik, didaktika profesionale dhe praktika profesionale trajtohen më në hollësi në fushën e zhvillimit profesional të mësimdhënësve (Fusha 4).

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 6.1: Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP-së janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës

6.1.1. Përmirësimi i sistemit të informatave të tregut të punës për të analizuar dhe përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave të tregut për shkathtësi dhe planifikim në sistemin e AAP-së.

Këtu duhet të parashihen aktivitete për ndërlidhjen e SMIA-së me sistemin e informatave prej regjistrimit civil, ASK-së, shërbimet e punësimit, e të tjera.

6.1.2. Rishikimi i profileve që ofrohen në shkollat e AAP-së dhe përshtatja me nevojat e tregut.

Ky rishikim bazohet në rezultatet e hulumtimeve të tregut të punës të cilat bëhen nga institucionet përgjegjëse. Hulumtimi i tregut të punës duhet, po ashtu, të merr parasysh, nevojat specifike, shqetësimet dhe prioritetet e komuniteteve me qëllim të dhënies së kontributit për përfaqësim dhe pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe femrave në tregun e punës. Hulumtimi i tregut të punës që zhvillohet dhe vlerësohet për këtë masë duhet po ashtu të përfshin të dhënat e ndara sipas gjinisë, për të mundësuar analiza nga pikëpamja gjinore. Me qëllim të dhënies së kontributit për përfaqësim dhe pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe femrave në tregun e punës, nevojat specifike, shqetësimet dhe prioritetet e tyre duhet të integrohen në dhënien e mbështetjes për profile të caktuara profesionale.

6.1.3. Zhvillimi i standardeve të profesioneve të ofruara.

Standardet mund të zhvillohen nga organizata të ndryshme përgjegjëse për AAP, nga industria apo grupet e tjera profesionale.

6.1.4. Analiza e nevojave në nivel qendror dhe lokal për plotësimin e kushteve për ofrimin e profileve nga lista e rishikuar.

Këto nevoja janë të lidhura me burimet njerëzore, mësimore, pajisje dhe infrastrukturë. Kjo analizë duhet të bazohet në një vlerësim të gjendjes të ofruesve të AAP-së.

6.1.5. Ngritja e kapaciteteve të shkollave të AAP-së për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurave për akreditim.

AKK ka kërkesa të qarta për sigurim të cilësisë në AAP-së dhe ato kërkohen në procesin e akreditimit.

Rezultati 6.2: Është rritur për 30% regjistrimi i nxënësve në drejtimet deficitare dhe për 20% numri i femrave në drejtimet teknike

6.2.1. Organizimi i fushatave vetëdijesuese dhe prezantimeve të rregullta në shkollat e AAP-së nga industria, për nxënësit e klasave 8 dhe 9.

Inicimi i këtyre aktiviteteve mund të bëhet nga cilado palë, shkolla apo punëdhënësi por bashkërenditja bëhet nga shkollat përmes informimit, këshillimit dhe orientimit.

6.2.2. Krijimi i një strukture stimuluese (fondi të përbashkët) nga qeveria dhe bizneset, për mbështetjen e shkollimit në drejtimet deficitare dhe për femrat në drejtimet teknike.

Nga ky fond mund të ndahen bursa apo shpërblime tjera për nxënësit në drejtimet e caktuara dhe nxënëset të cilat tregojnë sukses të dalluar në drejtimet teknike, si dhe për të nxitur regjistrimin fillestar në drejtime të caktuara ku femrat janë të nënpërfaqësuar. Aktivitetet të veçanta duhet të zhvillohen për të mbështetur dhe promovuar në mënyrë aktive përfshirjen e femrave në drejtimet teknike.

6.2.3. Realizimi i emisioneve televizive dhe shkrimeve me storie të suksesshme të femrave në profesionet teknike.

Emisione të tilla mund të tërheqin femrat të regjistrohen në ato drejtime.

Rezultati 6.3: Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare

6.3.1. Mbledhja e modeleve të mira të materialeve mësimore ekzistuese të përgatitura nga mësimdhënësit e profileve të ndryshme.

Këto paraprakisht përzgjidhen nga aktivet profesionale, dhe pastaj publikohen në platforma elektronike për shfrytëzim nga mësimdhënësit tjerë të lëmive të njëjta.

6.3.2. Trajnimi i mësimdhënësve për shfrytëzimin e platformave elektronike.

6.3.3. Ngritja e kapacitetit të mësimdhënësve për zhvillim të materialeve mësimore të cilat mbulojnë së paku dy lëndë profesionale nga secili sektor ekonomik.

Meqenëse numri i profileve që ofrohen është i madh, do të përzgjidhen nga dy lëndë prej profileve prioritare duke pasur kujdes që të përfaqësohen të gjithë sektorët ekonomikë.

6.3.4. Zhvillimi i materialeve mësimore për së paku dy lëndë profesionale të përgjedhura nga secili sektor ekonomik që ofrohet në shkollat e AAP.

Këto materiale do të zhvillohen nga mësimdhënësit e trajnuar sipas përshkrimit në pikën më lartë.

6.3.5. Ngritja e kapacitetit të mësimdhënësve të lëndëve të përgjithshme në AAP për zhvillimin e materialeve mësimore të aplikuara në profesion.

Mësimdhënësit e lëndëve do të grupohen sipas fushave mësimore përkatëse, dhe do të trajnohen që të zhvillojnë materiale mësimore të aplikuara në profesione.

6.3.6. Zhvillimi i materialeve mësimore nga fushat/lëndët mësimore e përgjithshme të aplikuara në profesion.

Lëndët e përgjithshme në AAP mund të zhvillohen për secilin sektor të ekonomisë. Ekipet për hartimin e këtyre materialeve duhet të përmbajnë mësimdhënësit e fushës përkatëse të përgjithshme, por edhe mësimdhënës të lëndëve profesionale të sektorit të caktuar.

Rezultati 6.4: Kurrikulat e AAP-së dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve

6.4.1. Trajnimi i zhvilluesve të kurrikulit në AAP për kurrikula modulare.

Mësimdhënësit përzgjidhen ashtu që të mbulojnë të gjithë sektorët ekonomikë që ofrohen në AAP.

6.4.2. Zhvillimi i Kurrikulës Bërthamë për AAP.

Kurrikula Bërthamë për AAP duhet të respektojë kërkesat e Kornizës së Kurrikulit për Arsimit Parauniversitar dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

6.4.3. Zhvillimi i testeve të provimit përfundimtar të profesioneve të ofruara në AAP.

Këto teste mund të zhvillohen duke u grupuar në bazë të sektorëve ekonomike.

6.4.4. Rishikimi i udhëzimit administrativ për provimin përfundimtar të profesionit.

Rezultati 6.5: Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë dhe një praktikë profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor

6.5.1. Zhvillimi i instrumenteve për stimulimin e kompanive për pranimin e nxënësve në praktikë.

Këtu nënkuptohet edhe përfshirja e aktorëve të tjerë.

6.5.2. Zhvillimi i rregullores për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve gjatë praktikës.

6.5.3. Trajnimi i personelit të zyrave për bashkëpunim me ekonominë.

Pjesë e këtij trajnimi duhet të jetë edhe hartimi i planeve dinamike trevjeçare për praktikën e nxënësve në ndërmarrje.

6.5.4. Pajisja e punëtorive të 15 shkollave profesionale.

Përzgjedhja e shkollave për tu pajisur do të mbulojë sektorët prioritarë të ekonomisë.

6.5.5. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë për praktikën e nxënësve dhe zbatimin e tyre.

6.5.6. Hartimi i akteve nënligjore që përcaktojnë kriteret për themelimin e partneritetit publiko-privat (PPP) në fushën e arsimit.

Kjo do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe institucionet tjera përkatëse. Po ashtu, duhet të hartohen udhëzues për menaxherët e shkollave për zbatimin e PPP.

Rezultati 6.6: Këshillimi dhe orientimi në karrierë është funksional në sistemin e shkollimit për nxënësit dhe të rriturit

6.6.1. Trajnimi i mësimdhënësve të AAP për zhvillimin e kurrikulave të këshillimit dhe orientimit në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit.

6.6.2. Zhvillimi i standardit dhe kualifikimit të profesionit të këshilltarit të karrierës.

Grupet punuese të standardit do të përfshijnë ekspertë dhe aktorë relevant.

6.6.3. Zhvillimi i kurrikulit për edukim dhe këshillim në karrierë për shkollat profesionale.

Ky proces do të ketë për bazë standardin e aprovuar paraprakisht. Këtu parashihen edhe mekanizmat e tjerë për vlerësim të nxënësve si instrument për orientim të mëtejshëm në karrierë.

6.6.4. Zhvillimi i programit trajnues për mësimdhënësit e këshillimit dhe orientimit në karrierë.

6.6.5. Trajnimi dhe certifikimi i mësimdhënësve të këshillimit dhe orientimit në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit.

6.6.6. Caktimi i këshilltarëve të karrierës në shkolla.

Mësimdhënësit do të caktohen në këtë detyrë në kuadër të fondit të rregullt të orëve.

6.6.7. Zhvillimi i mekanizmave për përcjelljen e të diplomuarve në shkollat e AAP.

Ndërlidhja me mekanizmat ekzistues si EMIS, SMIAL, Qendrat për Shërbimet e Nxënësve dhe mekanizmat e tjerë ekzistues të të dhënave.

Rezultati 6.7: Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese

- 6.7.1. Rishikimi i rregullores për gjenerimin dhe shfrytëzimin e të hyrave vetanake në shkollë.**
Këtu nënkuptohet rishikimi i akteve nënligjore që rregullojnë këtë çështje, në bashkëpunim me palët tjera të interesit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 6.7.2. Trajnimi i stafit të institucioneve të AP për hartim të projekteve që gjenerojnë të hyra.**
- 6.7.3. Rishikimi i programeve të institucioneve të AAP që ofrojnë arsimim për të rritur.**
Në rrjetin ekzistues ka shumë raste të dyfishimit të profileve, prandaj duhet të evitohen rastet e tilla. Po ashtu, duhet evitohen rastet e dallimeve të profileve të ngjashme me emërtime të ndryshe.
- 6.7.4. Rritja e pjesëmarrjes së nxënësve nga komunat tjera në Qendrat e Kompetencës.**
Rritja e regjistrimit të nxënësve në Qendrat e Kompetencës nga komunat tjera përmes promovimit të mundësive të shkollimit në këto qendra, në nivel vendi. Këtu përfshihen masa për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë kandidatët nga komuna tjera.
- 6.7.5. Rishikimi i formulës së financimit të institucioneve të AAP-së.**
Formula e re duhet të mundësojë burime financimi nga niveli qendror, lokal dhe shkollor, si dhe duhet të mbështet në një sistem të vlerësimit periodik të shpenzimeve.
- 6.7.6. Promovimi i një modeli të biznesit në IAAP të caktuara, që siguron qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe menaxhuese.**
Ky model përfshin ndërtimin e mekanizmave të rinj që mbulojnë tri shtylla menaxhuese: Ndërlidhja me biznesin dhe ofrimi i shërbimeve këshilluese për karrierë, promovimin e aktiviteteve për gjenerimin e të hyrave, dhe përpunimi i të dhënave, monitorimi dhe vlerësimi. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të sistemit adekuat për monitorim dhe vlerësim.

Rezultati 6.8. Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rriturit

- 6.8.1. Mbledhja, përpunimi dhe mirëmbajtja e të dhënave mbi arsimimin e të rriturve në SMIA.**
- 6.8.2. Ofrimi i mundësive të aftësimit për stafin menaxhues në nivelin qendror, lokal dhe shkollor.**
- 6.8.3. Trajnimi i personelit shkollor për zbatim të ARr.**
Me këtë rast përfshihet edhe menaxhmenti i shkollës, koordinatorët, mësimdhënësit, monitoruesit, etj.

Rezultati 6.9. Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve

- 6.9.1. Identifikimi i nevojave për kualifikime të nivelit 5.**
Analiza e legjislacionit në fuqi dhe identifikimi si dhe përshtatja e nivelit të 5 në sistemin arsimor dhe në tregun e punës.
- 6.9.2. Zhvillimi i programeve të reja për arritjen e kualifikimeve në nivelin 5 post-sekondar sipas KKK-së.**
- 6.9.3. Ofrimi i programeve të reja të nivelit 5 post-sekondar në IAAP, veçanërisht në Qendrat e Kompetencës.**

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Ndërmarrjet tregojnë gatishmëri për organizimin e praktikës profesionale.
- Mundësia e bashkëpunimit me donatorë të jashtëm.
- Përfshirja e organizatave të biznesit për ndërmjetësim të praktikës profesionale.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm.
- Mungesa e interesimit të bizneseve për bashkëpunim.
- Formula e financimit të AAP-së e papërshtatshme.
- Mungesa e mësimdhënësve të me shkathtësi teknike.
- Zhvillimi i ulët ekonomik në vend dhe paqëndrueshmëria e NVM.
- Degradimi i imazhit të shkollave të AAP-së.
- Mungesa e përfaqësuesve të ekonomisë në vlerësimin e brendshëm të nxënësve të AAP-së.
- Zvogëlimi i fondeve nga donatorët.
- Mungesa e programeve të përshtatura për arsimin e të rriturve.
- Mungesa e fondeve për arsim të të rriturve.

12. Objektivi strategjik 7: Arsimi i lartë

Arsimi i lartë është përgjegjësi esenciale publike, me rëndësi të veçantë për zhvillimin e shoqërisë. Përmes krijimit të dijes dhe aftësive, si dhe duke nxitur inovacionin, mendimin kritik, tolerancën dhe mendjen e hapur, institucionet e arsimit të lartë i përgatisin qytetarët për rolin e tyre në shoqëri dhe në ekonomi. Në shekullin XXI, arsimi i lartë është një nga shtytësit kyç të konsolidimit demokratik dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Aftësimi profesional dhe dituria e fituar përmes arsimit të lartë janë faktorë të rëndësishëm për krijimin e vendeve të punës dhe të mirëqenies në shoqëri. Veçanërisht, në shoqëritë në transicion, arsimi i lartë është një ndër komponentët thelbësorë të transformimeve sociale dhe politike, të cilat, gjithashtu, ndikojnë drejtpërdrejt në institucione të qëndrueshme shtetërore dhe në krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik. Siç është treguar nga përvojat e shumë vendeve tjera, arsimi i lartë ndikon, në shkallë të konsiderueshme, në sigurimin e kuadrove cilësore dhe konkurruese në tregun e punës.

Standardet e cilësisë në arsimin e lartë janë parakusht kyç për zhvillimin e institucioneve moderne të arsimit të lartë. Në kontekstin e zbatimit të këtyre standardeve, përpjesëtimi mësimdhënës-student është një tregues kuantitativ i cilësisë. Standardet e cilësisë përqendrohen në zhvillimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë dhe krijimin e kushteve adekuate të infrastrukturës për punë akademike dhe kërkim shkencor. Arsimi i lartë duhet të ju përgjigjet, të ju përshtatet dhe të ju paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me përfaqësuesit e ekonomisë ka rëndësi esenciale për arsimin e lartë. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm, veçanërisht në procesin e zhvillimit të standardeve dhe programeve të reja të studimit dhe në garantimin e kushteve të duhura për aftësim praktik.

Kërkimi shkencor renditet në mesin e dhjetë prioritetëve të Kartës së Bolonjës. Lidhja e integruar mes arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është veti dalluese e universiteteve moderne.

Financimi i qëndrueshëm i arsimit të lartë është qenësor për funksionimin normal dhe zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë. Financimi i institucioneve të arsimit të lartë bëhet në bazë të performancës së tyre, me anë të modeleve që marrin parasysh mësimdhënien, punën kërkimore-shkencore dhe zhvillimin institucional. Rritja dhe diversifikimi i të hyrave përmes sigurimit të hyrave vetanake është një aspekt tjetër me rëndësi për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë për shkëmbim akademik dhe ndërtim të rrjeteve të partneriteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar janë një mundësi e mirë për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Sfidat

Mosrespektimi i standardeve të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë

Në dekadën e fundit, arsimi i lartë në Kosovë ka pësuar një masivizim të jashtëzakonshëm për kapacitetet që ka dhe mundësitë që ofron. Ky masivizim, përkundër rëndësisë që ka si politikë arsimore për rritjen e pjesëmarrjes në arsim të lartë, megjithatë ka ndikuar në rënien, ndonjëherë drastike, të cilësisë së arsimit të lartë. Ndërkohë që numri i studentëve dhe programeve të studimit është shtuar, përpjesëtimi mësimdhënës-student është përkeqësuar ndjeshëm. Përmirësimi i raportit të disfavorshëm mësimdhënës-student në institucionet publike kërkon investime në krijimin e kuadrit, por edhe mjete financiare shtesë. Nga ana tjetër, ndërtimi i mekanizmave të brendshëm për sigurimin e cilësisë mbetet detyrë me rëndësi e institucioneve të arsimit të lartë. Po ashtu,

kushtet e infrastrukturës për punë kërkimore shkencore mbasin mjaft të kufizuara. Çështje që, po ashtu, kërkojnë kujdes të veçantë, janë ngritja e nivelit të etikës, transparencës dhe integritetit në arsimin e lartë.

Mospërshtatja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës

Një mangësi strukturore e arsimit të lartë në Kosovë është zhvillimi i programeve të studimit të cilat nuk reflektojnë nevojat reale të tregut të punës. Njëkohësisht, këtyre programeve u mungon edhe ndërdisiplinariteti, pjesa e mësimi praktik, si dhe ndërlidhja me kërkimin shkencor. Mospërputhja e nevojave të tregut të punës me njohuritë e fituara në arsimin e lartë është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Komuniteti afarist ankohet se fuqia punëtore ka shkathtësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Nga ana tjetër, bashkëpunimi i institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin afarist është shumë i ulët, ndërsa, institucionet e arsimit të lartë kanë shërbime joefikase dhe ende të pazhvilluara për orientim dhe këshillim në karrierë të studentëve. Kështu, sfida mbetet rishikimi i programeve të studimit për të reflektuar nevojat e tregut të punës dhe orientimi i studentëve kah studimi i fushave deficitare dhe strategjike për zhvillimin e vendit më qëllim të përmirësimit të punësueshmërisë.

Prania e pamjaftueshme e punës kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë

Edhe pse njihet si aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të arsimit të lartë, puna kërkimore-shkencore nuk është plotësisht e integruar në aktivitetet e zakonshme të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare të stafit të institucioneve të arsimit të lartë mbetet jashtëzakonisht i vogël. Rritja e numrit të publikimeve shkencore të stafit të institucioneve të arsimit të lartë në revista të indeksuara ndërkombëtare kërkon mbështetjen e hulumtuesve në publikimin e punimeve dhe prezantimin e rezultateve shkencore në konferenca ndërkombëtare. Krahas kësaj, nevojitet të përmirësohet mjedisi jo i përshtatshëm për punë kërkimore shkencore duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës së përshtatshme fizike, laboratorëve dhe pajisjeve jofunksionale dhe mungesën e qasjes në burime shkencore në biblioteka elektronike.

Moskompletimi i kornizës ligjore në arsimin e lartë

Me hyrjen të fuqi të Ligjit të ri për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovë nevojitet të rishikohen dhe plotësohen të gjitha aktet nënligjore në mënyrë që të ofrojnë një mjedis sa më efektiv për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë në përputhje me legjislacionin e ri. Po ashtu, Ligji i ri, pashmangshëm, implikon ndryshimin dhe harmonizimin e statuteve dhe rregulloreve të gjitha institucioneve të arsimit të lartë brenda një periudhe të caktuar kohore.

Financimi i arsimit të lartë pavarësisht performancës

Ligji për Arsimin e Lartë parasheh ndërtimin e mekanizmave efektivë për financim transparent që nxitë llogaridhënie. Ky financim bëhet mbi bazën e planeve trevjeçare që negocohen në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe MASHT-it, ndërsa raportimi duhet të bëhet në bazë të treguesve të dakorduar. Zbatimi i një formule të financimit të institucioneve të arsimit të lartë të bazuar në performancë duhet të shoqërohet me ndërtimin e mekanizmave efektivë për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve zhvillimore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Në anën tjetër, sigurimi i të hyrave vetanake është një aspekt me rëndësi i funksionimit të formulës së financimit përmes marrëveshjes së performancës. Për këtë nevojitet zhvillimi i mekanizmave për gjenerimin e fondeve shtesë përmes angazhimit në projekte dhe aktivitete të tjera këshilluese e zhvillimore që mund të jenë fitimprurëse për institucionet e arsimit të lartë.

Bashkëpunimi joefektiv ndërkombëtar në arsimin e lartë

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mobiliteti akademik janë instrumente me rëndësi për lehtësimin e integritit të Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Pengesë kryesore për mobilitet ndërkombëtar të stafit akademik dhe studentëve mbetet mosnjohja e mjaftueshme e gjuhës angleze. Për këtë qëllim, nevojitet të zhvillohen programe të veçanta për mësimin e gjuhëve të huaja dhe shkathtësive të studimit. Në anën tjetër, institucionet e arsimit të lartë duhet të themelojnë zyrat për zhvillimin e projekteve dhe ofrimin e shërbimeve profesionale me qëllim të informimit lidhur me mundësitë për aplikim në programet kornizë të BE-së.

Objekti

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Ngritja e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë është prioriteti kryesor në këtë fushë. Përveç përshtatjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës kjo duhet të përcillet me nxitjen e punës kërkimore-shkencore e artistike dhe

inovacionit në institucionet e arsimit të lartë. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet harmonizimit dhe kompletimit të kornizës ligjore në arsimin e lartë, si dhe financimit të arsimit të lartë të bazuar në performancë. Po ashtu, në funksion të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, prioritet është rritja e mobilitetit akademik të stafit akademik dhe studentëve, si dhe pjesëmarrja në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Rezultatet e pritshme:

- 7.1. Raporti staf akademik - student në IAL është të paktën 1:40;
- 7.2. Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksional;
- 7.3. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional;
- 7.4. Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike;
- 7.5. Deri në vitin 2019, Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim të lartë (SMIAL) është plotësisht funksional;
- 7.6. Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë janë funksionale në IAL;
- 7.7. Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% në çdo vit;
- 7.8. Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsim të lartë;
- 7.9. Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performancës;
- 7.10. Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL;
- 7.11. Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

Çështje të ndërlidhura

Arsimi i lartë është i lidhur ngushtë me nën-sektorin e arsimit parauniversitar, si në aspektin e pjesëmarrjes, ashtu edhe në atë të cilësisë dhe të përmbajtjes. Kështu, përfshirja diverse e studentëve në arsimin e lartë mund të arrihet, nëse në nivelet më të ulëta të shkollimit përfshihen në shkallë të kënaqshme personat nga grupe të marginalizuara (fusha 1). Nga ana tjetër, cilësia e arsimit parauniversitar (fusha 3) dhe përmbajtjet që zhvillohen në këtë nivel (fusha 5), në masë të madhe ndikojnë në suksesin e të rinjve si studentë në institucionet e arsimit të lartë. Zhvillimet në arsimin dhe aftësimin profesional (fusha 6) ndikojnë në ofrimin e programeve studimore të përshtatshme për të diplomuarit nga këto fusha. Dhe, së fundi, përgatitja e mësimdhënësve të arsimit parauniversitar është detyrë e institucioneve të specializuara të arsimit të lartë dhe duhet të zhvillohet në përputhje me kërkesat për mësimdhënie cilësore (fusha 4).

Aktivitetet e mundshme

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme, veç e veç, bashkë me një përshkrim të shkurtër të tyre.

Rezultati 7.1: Raporti staf akademik - student në IAL është të paktën 1:40

7.1.1. Zhvillimi i programeve të reja të studimeve të doktoratës.

Me qëllim të krijimit të kuadrit në institucionet publike të arsimit të lartë zhvillohen 10 programe të reja të doktoratës në fusha të ndryshme të studimit, përfshirë programe ndërdisiplinore të doktoratës, në bazë të vlerësimit të nevojave për zhvillim të kuadrit. Për të siguruar përmbushjen e nevojave të institucioneve publike të arsimit të lartë për krijimin e kuadrove, ndahen fonde për mbështetjen e pjesëmarrjes së profesorëve/mentorëve ndërkombëtar në programet e studimeve të doktoratës.

7.1.2. Mbështetja e studentëve në studimet e doktoratës në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Për të plotësuar nevojat e institucioneve publike të arsimit të lartë për krijimin e kuadrove, ndahen fonde për mbështetjen e 100 studentëve (20 çdo vit) në studime të doktoratës në drejtime deficitare/strategjike në 500 universitetet më të mira botërore, në fushat përkatëse. Me qëllim të përkrahjes së mëtejme të përfaqësimit të barabartë të meshkujve dhe femrave në programet e doktoratës, duhet të vendosen e kritere për të siguruar që meshkujt dhe femrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga skema e bursave.

7.1.3. Zhvillimi i mekanizmave për planifikim të pranimit të studentëve në IAL.

Me qëllim të sigurimit të cilësisë, IAL zhvillojnë politika për pranim të studentëve që marrin për bazë kapacitetet kadrovike të tyre, si dhe zbatojnë kritere të njohjes së gjuhës angleze si kriter për pranim në programe të doktoratës përmes testeve të standardizuara ndërkombëtare. Këto mekanizma duhet të marrin parasysh nevojën për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të të gjitha komuniteteve në arsim dhe zbatim të kornizës së ndërlidhur ligjore.

Rezultati 7.2: Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksional

7.2.1. Themelimi dhe funksionalizimi i zyrave për përsosmëri të mësimdhënies.

Synohet themelimi i zyrave të reja për përsosmëri të mësimdhënies në të gjitha IAL, të cilat do t'i ofrojnë stafit akademik shërbime të zhvillimit akademik, përkatësisht programe të ndryshme të trajnimit lidhur me metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

7.2.2. Vlerësimi i nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional.

Të gjitha IAL duhet të identifikojnë nevojat për zhvillim profesional të stafit akademik në bazë të prioritetëve zhvillimore të institucioneve. Vlerësimi i nevojave mendohet të realizohet përmes mjeteve të vetëvlerësimit dhe duhet të rezultojë me analizën e nevojave për zhvillim profesional në secilin institucion të arsimit të lartë.

7.2.3. Hartimi i planit për zhvillim profesional të stafit akademik.

Plani për ndërtimin e kapaciteteve të stafit akademik të IAL duhet të bazohet në analizën e nevojave për ndërtim të kapaciteteve të stafit akademik të secilit institucion. Plani mund të përfshijë zhvillimin dhe zbatimin e programeve të ndryshme të trajnimit për avancim të mësimdhënies dhe mentorim. Stafi akademik duhet të njihet me udhëzimet për parimet etike dhe sjelljen etike, bazuar në rekomandimet relevante evropiane.

7.2.4. Zhvillimi i mekanizmit për monitorimin dhe vlerësimin e punës së stafit akademik.

Për këtë qëllim duhet të ketë aranzhime të veçanta të monitorimit që nënkupton zhvillimin e një kornize të monitorimit dhe vlerësimit të punës së stafit akademik në IAL.

Rezultati 7.3: Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional

7.3.1. Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të AKA-së për t'i zbatuar standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

7.3.2. Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore të Departamentit të Arsimit të Lartë në MASHT.

7.3.3. Mbështetja e IAL në zbatimin e politikave për sigurimin të cilësisë.

IAL do të mbështeten në zhvillimin dhe zbatimin e politikave që ndërlidhen me procesin e hartimit dhe miratimit të programeve duke i përfshirë studentët dhe palët tjera; inkurajimin e studentëve të kenë rol aktiv gjatë procesit mësimor; zbatimin e proceseve të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e stafit; inkurajimin e inovacionit në metodat mësimore dhe përdorimin e teknologjive të reja; dhe në vlerësimin ciklik të efektshmërisë së procedurave të vlerësimit për studentët. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë dhe masat rregulluese duhet të përplotësohen me qasje të bazuar në parimet e etikës, transparencës dhe integritetit në arsim.

7.3.4. Plotësimi i akreditimit me një proces të rankimit të programeve dhe institucioneve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane.

7.3.5. Themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet e Rregulluara.

Rezultati 7.4: Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike

7.4.1. Vlerësimi i nevojave të infrastrukturës për mësim dhe punë kërkimore-shkencore.

Të gjitha IAL identifikojnë nevojat e njësive akademike për infrastrukturë, përkatësisht nevojat për avancimin e laboratorëve ekzistues dhe blerjen e laboratorëve me pajisje të reja.

7.4.2. Mbështetje institucionale për zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore.

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës të institucioneve publike të arsimit të lartë për punë kërkimore-shkencore përmes mbështetjes së hapjes së pesë laboratorëve të rinj.

7.4.3. Hartimi i planeve për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të laboratorëve.

Planet për mirëmbajtjen e pajisjeve të laboratorëve në institucionet publike të arsimit të lartë do të përfshijnë hartimin e rregulloreve dhe trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për shfrytëzimin e laboratorëve.

Rezultati 7.5: Deri në vitin 2019, Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim të lartë (SMIAL) është plotësisht funksional

7.5.1. Zhvillimi i SMIAL me mundësi të mbledhjes dhe përpunimit të informatave relevante në nivel të IAL.

Zhvillimi i softuerit dhe kompletimi i infrastrukturës adekuate të teknologjisë informative në institucionet e arsimit të lartë për përdorimin e SMIAL.

7.5.2. Hartimi i udhëzuesve dhe aftësimi i stafit për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.

Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe hartimi i udhëzuesve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, për personelin e institucioneve të arsimit të lartë.

7.5.3. Zhvillimi i treguesve kombëtarë të arsimit të lartë.

Rezultati 7.6: Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë janë funksionale në IAL

7.6.1. Themelimi dhe funksionalizimi i këshillave industriale.

Këshillat industriale për fushat përkatëse janë mekanizma të IAL të funksionalizuara në nivel të njëjësive akademike si forume të bashkëpunimit me biznese. Këto këshilla duhet të angazhohen edhe në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me IAL, të përcaktuara me Strategjinë e Inovacionit të Kosovës.

7.6.2. Inkurajimi i partneriteteve me biznese.

Me këtë qëllim do të mbështeten të pakën 50 iniciativa të partneriteteve ndërmjet IAL dhe ndërmarrjeve publike/private në sektorë të ndryshëm të ekonomisë që përfshijnë edhe komponentin e praktikës profesionale të studentëve.

7.6.3. Realizimi i një studimi të mirëfilltë për ndërlidhjen e programeve të arsimit të lartë me tregun e punës, i cili duhet shërbejë si bazë për planin për profilizimin e universiteteve publike, bazuar në potencialin zhvillimor të vendit dhe rajoneve të ndryshme në Kosovë.

7.6.4. Rishikimi i programeve ekzistuese të studimit.

Do të bëhet rishikimi i programeve ekzistuese të studimit në IAL për të reflektuar kërkesat e tregut të punës. IAL do të themelojnë grupe të specializuara për hulumtimin dhe vlerësimin e kërkesave të tregut të punës sipas fushave përkatëse. Po ashtu, të gjitha programet e reja të studimit do të duhet të dëshmojnë përshtatjen me nevojat e tregut të punës si parakusht ligjor për akreditimin e tyre, përmes studimeve të realizuara sipas standardeve të përcaktuara nga AKA.

7.6.5. Mbështetja e programeve të reja në shkencat e aplikuara dhe programeve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Zhvillimi dhe zbatimi i të paktën 10 programeve të reja profesionale të studimit në fushat përkatëse në institucionet publike të arsimit të lartë.

7.6.6. Ofrimi i shërbimeve profesionale për biznese.

IAL duhet të hartojnë katalogun e shërbimeve profesionale për biznese. Ofrimi i këtyre shërbimeve duhet të rregullohet me rregullore të institucioneve.

7.6.7. Krijimi i sistemit për analizën e tregut të punës në nivel nacional, rajonal dhe lokal.

Sistemi duhet të mbledhë, përpunojë dhe ofrojë të dhëna për analizën e tregut të punës me qëllim të parashikimit të nevojave për shkathtësi në sektorët e ekonomisë nëpërmjet zhvillimit të një qasjeje koherente. Fokusi kryesor i masës është që të sigurojë krijimin e mekanizmave për një parashikim të shkathtësive sektoriale, në bazë të sondazheve të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për tu plotësuar kërkesën aktuale për ofrues të arsimit të lartë, për ata që diplomojnë dhe për pjesëmarrësit në tregun e punës që kërkojnë rikualifikim. Kjo do të përfshijë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të kryer dhe përdorur parashikimet sektoriale dhe për të zhvilluar politika efektive për të reduktuar shpërputhjen e

aftësive. Informatat e mbledhura për tregun e punës duhet të përfshijnë mekanizmat për të vlerësuar qasjen, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në tregun e punës, si dhe masat e mundshme që mund të ndërmerren për të zbutur çfarëdo mospërputhje.

7.6.8. Themelimi i Qendrave për Zhvillim të Karrierës në IAL.

Qendrat për zhvillim të karrierës në IAL duhet të zhvillojnë programe për zhvillim të karrierës dhe përkrahjes për studentë.

7.6.9. Zhvillimi i standardeve të profesionit në arsim të lartë.

Këto përfshihet edhe zhvillimi i udhëzuesve për standardet e profesionit të arsimit të lartë.

Rezultati 7.7: Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare nga stafi akademik rritet për 25% në çdo vit

7.7.1. Analiza e aktiviteteve hulumtuese të stafit akademik.

Realizimi i një studimi për angazhimin e stafit akademik të IAL në punë kërkimore-shkencore, bazuar në kapacitetet ekzistuese dhe prioritetet e kërkimit shkencor të përcaktuara në Programin Kombëtar të Shkencës.

7.7.2. Zhvillimi i planeve të veprimit për veprimtari kërkimore shkencore.

IAL duhet të zhvillojnë planet e veprimit për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore. Këto plane duhet jenë në përputhje me Programin Kombëtar të Shkencës dhe duhet të përfshijnë edhe zhvillimin e kornizave për monitorimin e zbatimit të tyre.

7.7.3. Funksionalizimi i këshillave të etikës në IAL.

7.7.4. Mbështetja e publikimit të punimeve shkencore në revista të indeksuara dhe prezantimi i rezultateve në konferenca ndërkombëtare.

Mbështetja e stafit akademik të IAL për publikim të punës shkencore në revista të indeksuara shkencore dhe pjesëmarrje e tyre në konferenca ndërkombëtare me qëllim të prezantimit të rezultateve shkencore.

7.7.5. Sigurimi i qasjes në biblioteka elektronike dhe inkurajimi për shfrytëzimin e tyre.

Për këtë qëllim do të sigurohet qasja e stafit akademik në të paktën 5 biblioteka elektronike ndërkombëtare të burimeve akademike dhe shkencore.

7.7.6. Krijimi i regjistrit kombëtar i hulumtuesve shkencor.

Regjistri do të shërbejë si mekanizëm për evidentimin dhe menaxhimin e informatave për punën kërkimore-shkencore të stafit akademik të IAL dhe instituteve kërkimore-shkencore.

Rezultati 7.8: Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsim të lartë

7.8.1. Rishikimi dhe hartimi i akteve nënligjore në përputhje me legjislacionin e ri.

7.8.2. Harmonizimi i statuteve dhe akteve tjera nënligjore të IAL me legjislacionin e ri.

7.8.3. Zhvillimi i kornizës ligjore për SMIAL.

Rezultati 7.9: Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performancës

7.9.1. Hartimi i aktit nënligjor për formulën e financimit të arsimit të lartë.

7.9.2. Zhvillimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të performancës në arsimin e lartë.

7.9.3. Zhvillimi i planeve strategjike të zhvillimit të IAL.

7.9.4. Zhvillimi i kornizës për monitorim dhe vlerësim të marrëveshjeve të performancës.

7.9.5. Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e kategorive të cënueshme sociale dhe komunitetet e nën përfaqësuar.

Me qëllim të pranimit të studentëve të kategorive të cënueshme sociale në IAL do të mbështetet zhvillimi i programeve të veçanta përgatitore. Shembuj praktikë të masave të tilla janë sigurimi i kurseve intensive për kandidatët nga komunitetet për t'i përgatitur ata për provimin pranues, ofrimi i kushteve për kandidatët nga komunitetet për ta mbajtur provimin pranues në gjuhën e tyre amtare dhe një politikë e vendeve të rezervuara në IAL derisa të arrihet pjesëmarrja e barabartë. Njëlloj, programet për mbështetjen e studentëve duhet të zhvillohen për t'i mbajtur në arsimin e lartë studentët nga komunitetet dhe grupet e marginalizuara përmes kurseve intensive të gjuhës për të përmirësuar njohurinë për gjuhën e mësimdhënies, ose përmes programeve të mentorimit, sigurimit të transportit dhe konvikteve.

Rezultati 7.10: Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL

7.10.1. Zbatimi i programeve të përbashkëta të studimit me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Me qëllim të rritjes së mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, do të mbështetet zhvillimi dhe zbatimi i 2 programeve të përbashkëta të studimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë me institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

7.10.2. Pjesëmarrja në programet rajonale dhe ndërkombëtare të mobilitetit akademik.

Në kuadër të programeve të shkëmbimit akademik do të mbështeten të paktën 300 muaj qëndrim studimor të stafit akademik të IAL në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe institutet shkencore. Po ashtu, do të mbështeten të paktën 300 mobilitete të studentëve në IAL.

Rezultati 7.11: Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore

7.11.1. Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve.

Mbështetja e IAL për themelimin dhe funksionalizimin e zyrave për zhvillim dhe koordinim të projekteve, si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale.

7.11.2. Ndërtimi i kapaciteteve të IAL për menaxhim të projekteve bazuar në vlerësim.

Për këtë qëllim bëhet vlerësimi i nevojave të stafit akademik dhe administrativ në institucionet publike të arsimit të lartë për ndërtim të kapaciteteve për menaxhim të projekteve. Në bazë të raporteve të vlerësimit hartohen planet për ndërtim të kapaciteteve bazuar në nevojat e stafit akademik për menaxhim të projekteve. Plani për ndërtimin e kapaciteteve do të përfshijë ofrimin e programeve të trajnimit për menaxhim të ciklit të projekteve për 30% të stafit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë.

7.11.3.Mbështetja për aplikim në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor.

Me qëllim të mbështetjes së IAL do të krijohet fondi për mbështetjen e 50 projekt propozime për aplikim në programet evropiane Erasmus+ dhe Horizon 2020. Mbështetja mund të përfshijë të gjitha aspektet e përgatitjes së projekt propozimit, përfshirë ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare.

7.11.4.Promovimi i programeve evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor.

Për këtë qëllim do të organizohen 50 seancave informative për stafin akademik dhe studentët lidhur me informimin mbi mundësitë, kushtet dhe aspektet financiare të aplikimit në programet kornizës të BE-së.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Institucionet publike të arsimit të lartë janë të gatshme për ofrimin e programeve të doktoratës.
- Interesimi i kandidatëve për studime të doktoratës.
- Gatishmëria e komunitetit të biznesit për bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë.
- Interesimi dhe përkushtimi i stafit akademik të institucioneve të arsimit të lartë për publikim të punimeve shkencore.
- Aprovimi i legjislacionit për arsimin e lartë.
- Interesimi i stafit akademik të IAL për pjesëmarrje në programe ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Refuzimi i akreditimit të programeve të reja të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë.
- Mungesa e kapaciteteve për zbatimin e programeve të përbashkëta të doktoratës.
- Mungesa e gatishmërisë së institucioneve publike të arsimit të lartë për rekrutimin e doktorantëve të mbështetur në institucionet publike të arsimit të lartë me qëllim të plotësimit të nevojave për kuadro.
- Mospunësueshmëria e të diplomuarve për shkak të problemeve strukturore ekonomike të sektorit publik dhe privat në Kosovë.
- Mungesa e interesimit të stafit akademik për të ndjekur programet e trajnimit për ndërtim të kapaciteteve.
- Mungesa e kapaciteteve të institucioneve publike të arsimit të lartë për gjenerimin e të hyrave vetanake.
- Kufizime në pjesëmarrjen në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë për shkak të mosnjohjes së gjuhës angleze.
- Dështimi i integritetit të Universitetit të Mitrovicës Veriore në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës.

13. Zbatimi i PSAK

13.1. Mekanizmat për zbatim

MASHT do të krijojë Grupin për Zbatimin e PSAK-ut i cili drejtohet nga Ministri (ose Zëvendës Ministri në emër të tij/saj); i koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe në përbërje të të cilit janë drejtorët e departamenteve kryesore të MASHT. Detyrat kryesore të këtij trupi janë:

- Hartimi i planeve vjetore të veprimit në përputhje me PSAK-un, SKZH-në dhe agjendën e integritetit Evropian;
- Hartimi i buxhetit vjetor për zbatimin e PSAK-ut në kuadër të kufijve buxhetorë të përcaktuar me KASH dhe me qarkoret buxhetore përkatëse;
- Analiza e progresit në zbatimin e PSAK-ut, në bazë të informatave të mbledhura nga MASHT dhe burimet e tjera;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e PSAK-ut;
- Hartimi i kërkesave për mbështetje nga programet e donatorëve me qëllim të sigurimit të zbatimit të PSAK-ut.

Grupi për Zbatimin e PSAK-ut do të bashkëpunojë me ministritë e tjera, komunat, partnerët zhvillimorë dhe organizatat e shoqërisë civile në ndërtimin e një mekanizmi efektiv për monitorimin e zbatimit të PSAK-ut. Sipas nevojës, në punën e Grupit për Zbatimin e PSAK-ut do të përfshihen edhe zyrtarë të tjerë të MASHT-it, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

13.2. Udhërrëfyshi për zbatim

Udhërrëfyshi i cili është zhvilluar për PSAK-un 2017-2021 kombinon elementet e “hartës së transformimit”, me një qasje më konvencionale të hartës rrugore, dhe lejon mundësinë e shtimit të rezultateve në hartë duke i lidhur në versionin elektronik të PSAK-ut. Kjo qasje mund të përshtatet shumë lehtë për të krijuar një faqe interneti e cila do të siguronte informacionet kryesore për PSAK-un, në radhë të parë për MASHT-in, DKA-të dhe për personelin e shkollave. Kjo qasje, gjithashtu mund të shërbejë si një mekanizëm për komunikim me aktorët kryesorë (përfshirë nxënësit dhe ofruesit) dhe për shpërndarjen e informatave në shoqëri.


Harta e transformimit e ka përparësinë se i lejon përdoruesit që të marrë parasysh, në të njëjtën kohë, të gjitha komponentët e ndryshme të çdo zhvillimi të propozuar, në këtë rast të tërë PSAK-ut 2017-2021, me të shtatë objektivat strategjike, si dhe të paraqes në formë vizuale ndërlidhjen ndërmjet elementeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, e ndihmon përdoruesin që të kuptoj kontekstin e zhvillimit të çdo komponenti të caktuar, dhe për t'i harmonizuar aktivitetet drejt objektivit të përbashkët përfundimtar. Sa më shumë që ka elemente afatgjata të një harte të transformimit aq më efektiv është “parashikimi” i aktiviteteve, që shpesh janë të vendosura në një format, për shembull, teksti është paraqitur në një “re” në vend të një kutie - e cila reflekton këtë.

Harta e përfshirë këtu është vetëm një shembull. Harta të ngjashme, mund të zhvillohen për çdo objektiv strategjik në kuadër të PSAK-ut, me një seksion të veçantë për secilin nga rezultatet e synuara. Kjo do të mundësonte që harta të përmbajë më shumë detaje se sa që është e mundur të përshkruhet në një hartë të plotë të PSAK-ut.

Harta efektive e transformimit zakonisht nuk është veprim që ndodh njëherë. Është e dobishme që të përsëritet veprimi përdërisa idetë fillestare ri-mendohen, merren parasysh implikimet e afateve kohore dhe të ndërlidhjeve, dhe aktorët institucionalë fillojnë të “marrin pronësinë” e planit. Po ashtu është e mundshme që hartat do të duhet të rishikohen, me ndryshimin e rrethanave të jashtme ose të brendshme.

Shkurtesat kryesore të përdorura në hartë:

- AAP – Arsimi dhe Aftësimi Profesional
- AD – Arsimi në diasporë
- AL – Arsimi i Lartë
- ANV – Arsimi me nevoja të veçanta
- ARr – Arsimi për të Rritur
- ASVPRr – Agjencia për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet e Rregulluara
- DKA-të – Drejtoritë Komunale për Arsim
- Dh&T – Dhunti dhe Talente
- EPMPB – Ekipet për reagim ndaj mosregjistrimit dhe parandalim të braktisjes
- FE – Fakulteti i Edukimit
- GIS – Sistemi i Informatave Gjeografike
- IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë
- KE – Këshillat e Etikës
- KI – Këshillat Industrial
- KKK – Korniza e Kurrikulit të Kosovës
- KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
- KSh – Kërkimi Shkencor
- M&E – Monitorimi dhe Vlerësimi
- MC – Menaxhimi i Cilësisë
- MH – Moshat e hershme
- MM – Materialet mësimore
- MP – Marrëveshjet e Performancës
- PIA – Plani Individual për Arsim
- PKSh – Programi Kombëtar i Shkencës
- QeK – Qendrat e Kompetencës
- QZhK – Qendra për Zhvillim të Karrierës
- SA – Stafi akademik
- SC – Sigurimi i Cilësisë
- SMIA – Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
- SMIAL – Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim të Lartë
- SP – Standardet e Profesionit
- ShITP – Shërbimi për Informatat e Tregut të Punës
- TP – Treguesit e Performancës
- TP – Tregu i Punës
- UA – Udhëzim Administrativ
- ZHPM – Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve



14. Buxheti për zbatimin e PSAK-ut

Kalkulimi i buxhetit për zbatimin e PSAK-ut është bërë me këto qëllime:

- Të përcaktohet korniza financiare për zbatimin e PSAK-ut;
 - të përkufizohet vëllimi i fondeve të nevojshme për zbatimin e Strategjisë në periudhën 2017-2021;
 - të identifikohet boshllëku ndërmjet kapacitetit financiar për përballimin e nevojave të arsimit dhe kostos reale të tij sipas PSAK-ut;
- Të vlerësohet kostoja zhvillimore gjatë periudhës 2017-2021, që nënkupton investime të reja në fushën e arsimit, si dhe investimet kapitale në këtë fushë. Krahas kësaj është vlerësuar edhe kostoja operative që buron nga ajo zhvillimore, pra shpenzimet që shkaktohen në vazhdimësi si rezultat i investimeve të reja.
- Të prezantohet alokimi i burimeve të financimit dhe shpenzimeve në vitet e ardhshme:
 - a. nga Buxheti i Kosovës -MASHT;
 - b. nga Buxheti i Kosovës – agjencitë e tjera shpenzuese;
 - c. nga buxhetet komunale;
 - d. nga donacionet dhe asistenca financiare;
 - e. nga burimet tjera, ku bëjnë pjesë edhe kreditë nga institucionet ndërkombëtare.
- Të prezantohen shpenzimet sipas kategorive ekonomike:
 - 1. Paga dhe mëditje,
 - 2. Mallra dhe shërbime
 - 3. Subvencione dhe transfere
 - 4. Shpenzime kapitale

Vlerësimi i kostos së PSAK-ut është rezultat i një procesi të gjerë të konsultimeve brenda institucioneve të Kosovës, por edhe me partnerë zhvillimorë dhe me shoqërinë civile. Me këtë rast janë marrë parasysh nevojat e vendit për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të arsimit që burojnë nga fakti se Kosova ende ka popullsinë më të re në Evropë, përkundër “plakjes” graduale demografike të saj. Përveç kësaj, Kosova ka shkallë të lartë të varfërisë dhe nevojë imediate për zhvillim ekonomik të përshpejtuar që, po ashtu, adresohet përmes zhvillimit të arsimit. Janë marrë parasysh edhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019, si dhe gatishmëria dhe planet e donatorëve për të mbështetur arsimin në Kosovë. Me këtë rast nuk ka qenë e mundur që buxheti të jetë në suaza të planifikimeve aktuale financiare të Qeverisë, pasi këto planifikime janë bërë para se të hartohet PSAK 2017-2021. Prandaj, sigurimi i fondeve për zbatimin e PSAK-ut nënkupton një rishikim të mundësive buxhetore të Qeverisë dhe konsultime plotësuese me donatorë dhe komuna, të cilët mendohet se mund ta sigurojnë një pjesë të fondeve.

Kostoja totale e zbatimit të PSAK-ut në periudhën 2017-2021 është vlerësuar në €176.94 mil. që është, pothuajse, trefish më pak sesa vlerësimi financiar i PSAK-ut 2011-16 që arrinte shumën prej €480.42 mil. Nuk do të thotë se nevojat nuk janë më të mëdha sesa vlerësimi financiar i tyre, por MASHT ka bërë kujdes që të përcaktojë prioritetet, duke pasur parasysh interesin më të mirë

të vendit, si dhe kufizimet buxhetore. Tabela 2 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e PSAK-ut sipas prioriteteve dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilin aktivitet të planifikuar, i cili është në dispozicion të MASHT-it.

Tabela 2. Përmbledhja e buxhetit të PSAK-ut sipas viteve

Fusha prioritare	Shpenzime totale					
	2017	2018	2019	2020	2021	Gjithsej
1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	€ 442,243	€ 565,705	€ 571,950	€ 561,890	€ 550,140	€ 2,691,927
2. Menaxhimi i sistemit arsimor	€ 15,129,350	€ 22,520,540	€ 22,052,225	€ 19,664,695	€ 18,663,950	€ 98,030,760
3. Sigurimi i cilësisë	€ 605,646	€ 526,698	€ 458,640	€ 328,400	€ 314,400	€ 2,233,784
4. Zhvillimi i mësimdhënësve	€ 1,057,900	€ 1,989,950	€ 2,896,900	€ 3,822,500	€ 4,783,500	€ 14,550,750
5. Mësimdhënia dhe të nxënit	€ 2,970,990	€ 6,240,790	€ 6,614,840	€ 6,961,690	€ 7,640,560	€ 30,428,870
6. Arsimi profesional dhe arsimi i të rriturve	€ 1,699,959	€ 1,567,035	€ 1,238,225	€ 1,143,707	€ 1,124,020	€ 6,772,946
7. Arsimi i lartë	€ 2,647,960	€ 3,478,880	€ 3,648,980	€ 5,099,120	€ 7,357,560	€ 22,232,500
	€ 24,554,048	€ 36,889,598	€ 37,481,760	€ 37,582,002	€ 40,434,130	€ 176,941,537

Tabela përfshin koston zhvillimore në lartësi prej €168,757,777 dhe koston rrjedhëse prej €8,193,960. Buxheti për vitin 2017 është diç më i vogël dhe, në masë të madhe, bazohet në mjetet që tanimë janë në dispozicion.

Tabela 3. Përmbledhja e buxhetit të PSAK-ut sipas kategorive ekonomike

Fusha prioritare	Shpenzime totale				
	Pagat dhe mëditjet	Mallra dhe shërbime	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej
1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	€ 864,000	€ 591,927	€ 1,236,000		€ 2,691,927
2. Menaxhimi i sistemit arsimor	€ 100,000	€ 4,646,760		€ 93,284,000	€ 98,030,760
3. Sigurimi i cilësisë	€ 556,500	€ 1,677,284			€ 2,233,784
4. Zhvillimi i mësimdhënësve	€ 9,663,000	€ 4,801,350		€ 86,400	€ 14,550,750
5. Mësimdhënia dhe të nxënit		€ 30,428,870			€ 30,428,870
6. Arsimi profesional dhe arsimi i të rriturve	€ 288,000	€ 6,144,146	€ 91,000	€ 260,000	€ 6,783,146
7. Arsimi i lartë	€ 9,478,680	€ 5,153,820	€ 7,600,000		€ 22,232,500
	€ 20,950,180	€ 53,444,157	€ 8,927,000	€ 93,630,400	€ 176,951,737

Tabela 3 tregon se investimet kapitale përbëjnë rreth 53% të buxhetit të përgjithshëm për zbatimin e PSAK-ut dhe kjo bën që fusha prioritare 2 të ketë buxhetin më të madh. Ndërkaq, pagat dhe mëditjet janë më të mëdha në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve, ku është paraparë shuma prej €9.6 mil. për rritjen e pagave në kuadër të procesit të licencimit të

mësimdhënësve, si dhe shuma prej €9.48 mil. për angazhimin e personelit në arsimin e lartë. Arsimi i lartë prin në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ku parashihen € 7.6 mil. për mbështetjen e mobilitetit akademik dhe punës kërkimore-shkencore. Ndërkaq, pjesën më të madhe të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve e përbën furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut dhe mjete të konkretizimit, në mbështetje të zbatimit të Kornizës së Re të Kurrikulit (fusha 5).

Tabela 4. Shpenzimet më të mëdha për zbatimin e PSAK-ut sipas kategorive ekonomike

1. Pagat dhe mëditjet

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i shpenzimit	Shuma
4.3.4	Shpenzimet për paga lidhur me licencimin e mësimdhënësve sipas niveleve	€ 9,600,000
7.1.1	Angazhimi i mësimdhënësve të rinj në universitete publike, si dhe angazhimi i profesorëve në studime të doktoratës	€ 7,677,000
Subtotali 1		€ 17,277,000

2. Mallrat dhe shërbimet

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i shpenzimit	Shuma
5.3.1	instalimi i infrastrukturës wireless në 1000 shkolla	€ 5,000,000
5.3.1	Kostoja e sigurimit të qasjes në Internet për qëllime mësimore për 5 vjet	€ 1,750,000
5.3.2	Sigurimi i 11,000 kompjuterëve të rinj për nxënës	€ 5,720,000
5.3.2	Furnizimi i 9000 klasave me Smart TV	€ 5,175,000
5.3.6	Furnizimi i shkollave me pako minimale të mjeteve mësimore për 330,000 nxënës	€ 9,900,000
Subtotali 2		€ 27,545,000

3. Subvencionet dhe transferet

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i shpenzimit	Shuma
7.1.2, 7.6.2, 7.7.4, 7.9.5, 7.10.2, 7.11.3	Subvencione të ndryshme për arsimin e lartë	€ 7,600,000
Subtotali 3		€ 7,600,000

4. Shpenzimet kapitale

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i shpenzimit	Shuma
2.8.1	Ndërtimi i 25 objekteve shkollore (85,000m2)	€ 35,880,000
2.8.2	Ndërtimi i 18 kopshteve	€ 11,904,000
2.8.3	Rinovohen 250 objekte shkollore (100,000m2)	€ 20,000,000
2.8.4	Pajisja e 40 shkollave me pako sportive	€ 1,600,000
2.8.5	Blerja e inventarit adekuat për grup moshat e shkollave të zgjedhura (60 shkolla x 50,000 Euro)	€ 3,000,000
2.8.6	Blerja e dollapëve individual (30% e shkollave = 50,000 nxënës x 100 euro) për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	€ 5,000,000
2.8.7	Ndërtimi i tri objekteve për institucionet e arsimit të lartë (3 objekte x 5 milion euro)	€ 15,900,000
Subtotali 4		€ 93,284,000
Gjithsej		€ 145,706,000

Tabela 4 jep një përmbledhje të pozicioneve buxhetore që paraqesin shpenzimeve më të mëdha të PSAK-ut dhe arrin shumën prej €145.7 mil, ose 82% e kostos së vlerësuar. Pikërisht kjo pasqyrë mund të shërbej për përcaktimin e prioritetëve shpenzuesë dhe ri planifikimin eventuale të aktiviteteve. Ndërkaq, tabela 5 prezanton strukturën e shpenzimeve sipas fushave prioritare dhe burimit të financimit, ndërsa tabela 6 rrjedhën e dëshiruar të parasë sipas viteve nga burime të ndryshme të financimit.

Tabela 5. Struktura e shpenzimeve sipas fushave prioritare dhe burimit të financimit

Fusha prioritare	Shpenzime totale					
	BK-MASHT	Buxheti komunal	BK-Agjencitë tjera	Donatorët	Të tjera	Gjithsej
1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	€ 715,896	€ 570,000	€ 6,950	€ 1,399,081	€ 0	€ 2,691,927
2. Menaxhimi i sistemit arsimor	€ 88,441,960	€ 1,673,600	€ 0	€ 6,746,150	€ 1,169,050	€ 98,030,760
3. Sigurimi i cilësisë	€ 881,324	€ 773,760	€ 0	€ 161,500	€ 417,200	€ 2,233,784
4. Zhvillimi i mësimdhënësve	€ 11,134,000	€ 391,700	€ 26,900	€ 2,460,400	€ 537,750	€ 14,550,750
5. Mësimdhënia dhe të nxënit	€ 6,087,870	€ 23,870,000	€ 0	€ 471,000	€ 0	€ 30,428,870
6. Arsimi profesional dhe arsimi i të rriturve	€ 3,967,180	€ 639,100	€ 41,250	€ 1,933,116	€ 192,300	€ 6,772,946
7. Arsimi i lartë	€ 7,636,020	€ 0	€ 10,488,040	€ 4,108,440	€ 0	€ 22,232,500
	€ 118,864,250	€ 27,918,160	€ 10,563,140	€ 17,279,687	€ 2,316,300	€ 176,941,537

Nga tabela shihet se rreth 80% të fondeve të nevojshme për zbatimin e PSAK-ut burojnë nga Buxheti i Kosovës ose buxhetet komunale.

Tabela 6. Rrjedha e dëshiruar e parasë sipas viteve dhe burimit të financimit

Burimi i financimit	Shpenzime totale					
	2017	2018	2019	2020	2021	Gjithsej
BK-MASHT	€ 17,095,146	€ 24,186,664	€ 25,217,210	€ 26,056,090	€ 26,309,140	€ 118,864,250
Buxheti komunal	€ 2,675,165	€ 5,729,645	€ 6,194,745	€ 6,442,560	€ 6,876,045	€ 27,918,160
BK-Agjencitë tjera	€ 257,570	€ 571,890	€ 888,780	€ 3,286,760	€ 5,558,140	€ 10,563,140
Donatorët	€ 3,544,257	€ 5,814,489	€ 4,752,665	€ 1,622,832	€ 1,545,445	€ 17,279,687
Të tjera	€ 981,910	€ 586,910	€ 428,360	€ 173,760	€ 145,360	€ 2,316,300
	€ 24,554,048	€ 36,889,598	€ 37,481,760	€ 37,582,002	€ 40,434,130	€ 176,941,537

Nga tabela vërehet rritja graduale e shpenzimeve duke filluar nga viti 2018, ndërsa shpenzimet për vitin 2017 janë dukshëm më të vogla, për shkak të përshtatjes së planit të veprimtimit me ciklin e planifikimit buxhetor.

Për të përcaktuar boshllëkun në mes të mjeteve financiare të nevojshme dhe atyre që janë në dispozicion jemi bazuar në KASH 2017-2019, por edhe në informata të mbledhura nga burime të tjera. Tabela 7 jep një projeksion të të hyrave që mund të shfrytëzohen për zbatimin e PSAK-ut, e që mund të plotësohet me informata të tjera.

Tabela 7. Vlerësimi i të hyrave për zbatimin e PSAK-ut

Kategoria e të hyrave	Shpenzime totale					
	2017	2018	2019	2020	2021	Gjithsej
Shpenzimet kapitale - BK	€ 10,145,000	€ 11,090,000	€ 10,690,000	€ 10,690,000	€ 10,690,000	€ 53,305,000
Shpenzimet kapitale - EU	€ 640,000	€ 2,560,000	€ 1,920,000	€ 0	€ 0	€ 5,120,000
Kredia e Bankës Botërore	€ 2,200,000	€ 2,000,000	€ 2,861,036	€ 0	€ 0	€ 7,061,036
Trajnimi i mësimdhënësve - BK	€ 705,291	€ 705,291	€ 705,291	€ 705,291	€ 705,291	€ 3,526,455
Zhvillimi i plan programeve - BK	€ 200,000	€ 200,000	€ 200,000	€ 200,000	€ 200,000	€ 1,000,000
Të hyra nga donatorë të ndryshëm (vlerësim)	€ 3,544,257	€ 5,814,489	€ 4,752,665	€ 1,622,832	€ 1,545,445	€ 17,279,687
	€ 17,434,548	€ 22,369,780	€ 21,128,992	€ 13,218,123	€ 13,140,736	€ 87,292,178

Duke krahasuar shpenzimet me të hyrat vërehet boshllëku prej €89.6 mil. për një periudhë 5-vjeçare, mjetet që mund të sigurohen nga burimet e brendshme dhe ato të donatorëve nëse specifikohen qartë kërkesat dhe e gjithë veprimtaria zhvillimore në fushën e arsimit bazohet në PSAK.